



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 06
Dhjetor | 2014

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 6

BOTUES © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org

Adresa elektronike economic.analysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Arben MUSTAFA

REDAKTOR Albulena XHELILI

AUTORË Krenare MALOKU
Zana GJOCAJ
Hana GAFURRI
Taulant SYLA

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ASK	Agjencia e Statististikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl.: Capital Adequacy Ratio</i>)
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (<i>angl.: European Bank for Reconstruction and Development</i>)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (<i>anglisht: European Central Bank</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
NIM	Margjina Neto e Interesit (<i>angl.: Net Interest Margin</i>)
NPL	Kreditë joperformuese (<i>angl.: Non-Performing Loans</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim (<i>anglisht: Organization for Economic Cooperation and Development</i>)
OJSHEF	Organizatrat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl.: Return on Average Assets</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
ROE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl.: Risk Weighted Assets</i>)
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit (<i>angl.: Special Drawing Rights</i>)
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2014),
 Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 6, Prishtinë: BQK.
 Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	11
2. Përmbledhje -----	13
3. Ekonomia e Eurozonës -----	16
3.1. Ballkani Perëndimor -----	18
4. Ekonomia e Kosovës -----	24
5. Sistemi Financiar i Kosovës -----	26
5.1. Karakteristikat e Përgjithshme -----	26
5.2. Ekspozimi ndaj jo-rezidentëve -----	27
6. Sektori Bankar i Kosovës -----	29
6.1. Aktiviteti i Sektorit Bankar -----	30
6.2. Performanca e Sektorit Bankar -----	42
6.3. Rreziqet e Sektorit Bankar -----	46
6.4. Analiza Stres-Test -----	60
6.5. Ngarkesa me borxh dhe performanca e kredive të klientëve -----	65
6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë -----	72
7. Sektori Pensional -----	75
7.1. Performanca e Sektorit Pensional -----	76
8. Sektori i Sigurimeve -----	77
8.1. Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve -----	78
8.2. Performanca e Sektorit të Sigurimeve -----	79
9. Sektori i Institucioneve Mikrofinanciare dhe Ndihmësve Financiar -----	81
9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar -----	81
9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar -----	83
9.3. Ndihmësit Financiar -----	84
10. Shtojca Statistikore -----	85
11. Referencat -----	105

LISTA E FIGURAVE	16
Figura 1. Rritja reale e PBB-së	16
Figura 2. Klima e biznesit në Gjermani dhe rritja ekonomike	17
Figura 3. Inflacioni vjetor	17
Figura 4. Papunësia	17
Figura 5. Llogaria rrjedhëse si pjesëmarrje e PBB-së	18
Figura 6. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL	19
Figura 7. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL	19
Figura 8. Norma e kredive joperformuese në EJL	20
Figura 9. Trendi i rritjes së kredive	21
Figura 10. Trendi i rritjes së depozitave	21
Figura 11. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave	21
Figura 12. Kthimi në kapital (ROE)	21
Figura 13. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR)	22
Figura 14. Rritja reale e PBB-së	24
Figura 15. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tijë	24
Figura 16. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar	25
Figura 17. Ndryshimi vjetor i asetëve të sistemit financiar dhe sektorëve përkatës	26
Figura 18. Struktura e asetëve të sistemit financiar	26
Figura 19. Struktura e kërkesave të jashtme	27
Figura 20. Struktura e detyrimeve të jashtme	27
Figura 21. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve	28
Figura 22. Ekspozimi në kuadër të asetëve dhe detyrimeve	28
Figura 23. Struktura e asetëve të bankave komerciale	29
Figura 24. HHI për asete, kredi dhe depozita	29
Figura 25. Struktura e asetëve të sektorit bankar	30
Figura 26. Rritja vjetore e asetëve të sektorit bankar sipas vendeve	30
Figura 27. Struktura e letrave me vlerë	31
Figura 28. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve	31
Figura 29. Standardet kreditore për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare	32
Figura 30. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare	32
Figura 31. Pritjet e bankave mbi standardet kreditore për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare	33
Figura 32. Pritjet e bankave mbi kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare	33
Figura 33. Rritja vjetore e kredive të reja dhe gjithsej kredive	34
Figura 34. Kreditë e reja sipas sektorëve	34
Figura 35. Rritja vjetore e kredive të reja	34
Figura 36. Kategoritë kryesore të kredive të reja	34
Figura 37. Kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyera	35
Figura 38. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike	36
Figura 39. Ndryshimi vjetor në kredi sipas sektorëve ekonomik	36

Figura 40. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	36
Figura 41. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit -----	37
Figura 42. Struktura e maturimit të kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	47
Figura 43. Struktura e depozitave dhe rritja vjetore -----	38
Figura 44. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve sipas sektorëve -----	38
Figura 45. Depozitat e jorezidentëve dhe norma e interesit në depozita -----	39
Figura 46. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	39
Figura 47. Struktura e depozitave të afatizuara -----	40
Figura 48. Mesatarja e normave të interesit -----	40
Figura 49. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve-----	41
Figura 50. Normat mesatare të interesit në kreditë për ekonomitë familjare-----	41
Figura 51. Normat mesatare të interesit në kredi sipas veprimtarisë ekonomike -----	41
Figura 52. Profiti neto, të hyrat dhe shpenzimet -----	42
Figura 53. Struktura e përgjithshme e të hyrave -----	43
Figura 54. Struktura e të hyrave sipas kategorive -----	43
Figura 55. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive-----	43
Figura 56. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive-----	44
Figura 57. Rritja vjetore e shpenzimeve sipas kategorive kryesore-----	44
Figura 58. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive -----	44
Figura 59. Rritja vjetore e provizioneve për humbjet e kredive dhe kredive joperformuese-----	45
Figura 60. Treguesit e profitabilitetit -----	45
Figura 61. Raporti shpenzime/të hyra -----	45
Figura 62. Harta e rreziqeve të sektorit bankar -----	46
Figura 63. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar-----	48
Figura 64. Raporti mjete likuide 'gjithëpërfshirëse'/detyrime afatshkurtëra-----	48
Figura 65. Rezervat e sektorit bankar -----	48
Figura 66. Hendeku i likuiditetit -----	49
Figura 67. Raporti NPL/gjithsej kreditë -----	50
Figura 68. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve-----	50
Figura 69. NPL-të sipas sektorëve -----	50
Figura 70. Struktura e kredive sipas klasifikimit-----	51
Figura 71. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditore-----	51
Figura 72. NPL-të dhe provizionet-----	51
Figura 73. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	52
Figura 74. Kapitalizimi i sistemit bankar -----	53
Figura 75. Kapitali rregullativ dhe RWA-të -----	53
Figura 76. Struktura e kapitalit rregullativ dhe RWA-të-----	53
Figura 77. Struktura e kapitalit të klasit të parë -----	54
Figura 78. Struktura e kapitalit të klasit të dytë-----	54
Figura 79. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut-----	55

Figura 80. Raporti i RWA-ve ndaj gjithsej mjeteve të sektorit -----	55
Figura 81. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	56
Figura 82. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	57
Figura 83. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	57
Figura 84. Hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit-----	57
Figura 85. Shpërndarja e humarrësve sipas llojit të kredisë -----	66
Figura 86. Shpërndarja e humarrësve sipas kohës së vonesës së kontratave-----	66
Figura 87. Përformanca e pagesës sipas llojit të huamarrësve -----	6
Figura 88. Përformanca e pagesës së ndërmarrjeve sipas vjetërsisë së ndërmarrjes -----	67
Figura 89. Përformanca e huamarrësve sipas llojit të kontratës aktive kreditore -----	67
Figura 90. Shpërndarja e kontratave kreditore të vonuara në pagësë sipas llojit të kontratës --	68
Figura 91. Pjesëmarrja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë sipas qëllimit -----	68
Figura 92. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesë në gjithsej pagesat-----	68
Figura 93. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesë sipas vitit të lëshimit të kredive	69
Figura 94. Shpërndarja e e huamarrësve individual sipas indeksit të ngarkueshmërisë-----	69
Figura 95. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas indeksit të ngarkueshmërisë -----	70
Figura 96. Niveli i ngarkesës së huamarrësve individual dhe numri i instit. kredihënëse -----	70
Figura 97. Niveli i ngarkesës së ndërmarrjeve dhe numri i institucioneve kredihënëse -----	71
Figura 98. Niveli i ngarkesës së ndërmarrjeve dhe posedimi i kreditkartelave dhe/apo mbitë- rheqjeve -----	71
Figura 99. Niveli i ngarkesës me borxh dhe marrja e kontratave të reja kreditore pas kontratës	71
Figura 100. Struktura e investimeve të fondeve pensionale -----	75
Figura 101. Mjetet nën menaxhimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-----	76
Figura 102. Mjetet nën menaxhimin e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	76
Figura 103. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit-----	77
Figura 104. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit-----	78
Figura 105. Detyrimet dhe ekuiteti i kompanive të sigurimit -----	78
Figura 106. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	79
Figura 107. HHI për asete dhe kreditë e IMF-ve-----	81
Figura 108. Asetet e institucioneve mikrofinanciare -----	81
Figura 109. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve -----	81
Figura 110. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve ekonomik-----	82
Figura 111. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit-----	82
Figura 112. Struktura e lizingut të IMF-ve sipas sektorëve-----	82
Figura 113. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve -----	83

LISTA E TABELAVE ----- 19

Tabela 1. Norma e rritjes së PBB-së reale në vendet e Ballkanit Perëndimor-----	19
Tabela 2. Norma e rritjes së kredive dhe depozitave në vendet e Ballkanit Perëndimor -----	20
Tabela 3. Numri i institucioneve financiare -----	27

Tabela 4. Struktura e asetëve të sektorit bankar -----	30
Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	38
Tabela 6. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit-----	46
Tabela 7. Treguesit të kapacitetit të sektorit bankar-----	46
Tabela 8. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë -	59
Tabela 9. Përmbledhja e rezultateve të stres-testit: Rreziku kreditor -----	63
Tabela 10. Përmbledhja e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit -----	64
Tabela 11. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së ----	73
Tabela 12. Rrjeti i sektorit bankar -----	74
Tabela 13. Struktura e fondeve pensional-----	75
Tabela 14. Depërtimi dhe densiteti i sektorit të sigurimeve -----	77
Tabela 15. Bruto primet e arkëtuara bruto -----	79
Tabela 16. Dëmet e paguara -----	79
Tabela 17. Treguesit shtesë të efikasitetit të sektorit -----	84

LISTA E KUTIVE ----- 21

Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë-----	21
Kutia 2. Anketa e kreditimit bankar-----	32
Kutia 3. Kreditë e reja dhe efekti i tyre në rritje të gjithsej stokut të kredive-----	34
Kutia 4. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë-----	58

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Aktiviteti ekonomik në Kosovë ka vazhduar të rritet edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 dhe treguesit kryesor makroekonomik kanë vazhduar të jenë të qëndrueshëm. Parashikimet makroekonomike për vitin 2014 sugjerojnë se norma e rritjes ekonomike do të vazhdojë të jetë pozitive, ku kontributin kryesor në rritje pritet ta ketë konsumi i sektorit privat. Zhvillimet kryesore që mundësojnë rritjen e konsumit privat gjatë kësaj periudhe ishin kryesisht zgjerimi i aktivitetit kredidhënës nga sektori bankar, rritja e dërgesave të emigrantëve si dhe rritja e pagave për shërbyesit civil. Ekonomia e Kosovës vazhdon të ketë pozicion të qëndrueshëm fiskal si në kontekst të deficitit buxhetor ashtu edhe në kontekst të borxhit publik, përderisa shkalla e inflacionit në Kosovë vazhdon të reflektojë zhvillimet ndërkombëtare të çmimeve duke qëndruar në nivel të ulët.

Stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik, i bashkërenduar me sjelljen prudente të sektorit financiar, ka bërë që treguesit e shëndetit financiar të mbeten në nivel të kënaqshëm, duke mundësuar rritjen e qëndrueshme të rolit të sistemit financiar në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë së vendit. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, sektori bankar ka lehtësuar standardet dhe kushtet e kreditimit, duke bërë që, për herë të parë në dy vitet e fundit, kreditë të përshpejtojnë ritmin e rritjes dhe të kenë kushte më të favorshme për shfrytëzuesit e tyre. Sidoqoftë, përveç rritjes së vëllimit të kreditimit, është i nevojshëm edhe një diversifikim më i madh i strukturës së kredive, duke bërë që t'u lehtësohet qasja në financimin bankar sektorëve më pak të kredituar të ekonomisë, të cilët mund të kenë rol shumë rëndësishëm për zhvillimin më të shpejtë ekonomik të vendit. Zgjerimi i vazhdueshëm i kreditimit nga sektori bankar vazhdon të mbështetet në bazën e qëndrueshme të depozitave të mbledhura brenda vendit, të cilat vazhdojnë të rriten. Aktiviteti ndërmjetësues financiar i sektorit bankar gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 u karakterizua me rënie të theksuar të normës së interesit në depozita, e cila u shoqërua me një rënie më të lehtë në normën e interesit në kredi.

Për sa i përket komponentëve tjerë të sistemit financiar të Kosovës, vlen të theksohet rritja e lehtë e aseteve të sektorit të institucioneve financiare pas një periudhe me trend rënës, përderisa edhe performanca financiare e këtij sektori u përmirësua. Rritje e aktivitetit dhe përmirësim i performancës financiare u regjistrua edhe në sektorin e sigurimeve, mirëpo vazhdon të ketë hapësirë për rritje të mëtejme të shkallës së depërtimit të shërbimeve të sigurimit në ekonominë e vendit. Sektori pensional ka vazhduar të jetë sektori me ritmin më të lartë të rritjes së aseteve brenda sistemit financiar të vendit dhe poashtu ka regjistruar përmirësim të mëtutjeshëm të performancës financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) vazhdon të shqyrtojë në baza të rregullta zhvillimet rreth aktivitetit dhe stabilitetit të sektorit financiar në vend, duke mundësuar kështu identifikimin me kohë të nevojave të mundshme për ndërmarrjen e masave që sigurojnë mirëmbajtjen e një sistemi financiar stabil dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Në drejtim të avancimit të mëtejme të rolit të këtij institucioni, mes tjerash, BQK në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane ka filluar projektin gjashtëmujor të identifikimit të nevojave të BQK-së për avancimin sa më të shpejtë drejtë standardeve të aplikuara nga bankat qendrore të Eurozonës.

Bedri HAMZA

Guvernator

2. Përmbledhje

Ekonomia globale gjatë vitit 2014, sipas vlerësimeve të FMN-së, pritet të shënojë rritje për 3.3 përqind. Eurozona shënoi normë pozitive të rritjes ekonomike, por për dallim nga fillimi i vitit kur shenjat e rikuperimit ishin mjaft të forta, në tremujorin e dytë dhe të tretë rimëkëmbja u ngadalësua. Viti 2014 është karakterizuar me rënie të normës së inflacionit, gjë që ka ngritur shqetësimet rreth mundësisë së hyrjes në një periudhë deflacioni. Përkundër uljes së vazhdueshme të normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane, aktiviteti kreditor i sektorëve bankar të këtyre vendeve ka vazhduar të ketë rol të zbehtë në nxitjen e aktivitetit ekonomik, përderisa performanca jo e kënaqshme e ekonomive ka vazhduar të reflektohet në përkeqësimin e cilësisë së kredive në këto vende.

Rajoni i Ballkanit Përendimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me rritje ekonomike, por se rritja prej rreth 1.8 është më e ulët se rritja e vitit paraprak. Përkundër përmirësimit të bilancit buxhetor, borxhi publik i vendeve të EJT-së ka vazhduar të mbetet i lartë, mirëpo vazhdon të mbetet nën nivelin e Eurozonës. Si karakteristikë e përbashkët e vendeve të Ballkanit Përendimor mbetet deficiti i llogarisë rrjedhëse i cili gjatë vitit 2014 shënoi rritje të mëtutjeshme. Sa i përket aktivitetit kreditues, disa nga vendet e Ballkanit Përendimor janë karakterizuar me rënie të kreditimit, kryesisht si pasojë e dobësimit të aktivitetit ekonomik, përderisa vendet tjera në këtë rajon janë karakterizuar me zgjerim të portfolios kreditorë. Depozitat në sektorin bankar, si një ndër burimet kryesore të financimit të aktivitetit kreditues në vendet e rajonit, u karakterizuan me rritje të vlerës së përgjithshme në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014. Vendet në Ballkanin përendimor raportuan rritje të kredive jo-performuese gjatë periudhës raportuese, megjithëse kreditë jo-performuese mbesin mirë të mbuluara nga provizionet. Gjithashtu, sektori bankar në vendet e rajonit vazhdon të ketë nivel të kënaqshëm të kapitalizimit.

Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë për vitin 2014 pritet të jetë 3.0 përqind, që vazhdon të mbajë Kosovën ndër vendet me normën më të lartë të rritjes ekonomike në rajon. Vazhdimi i rritjes ekonomike i ka mundësuar vendit ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, mirëpo adresimi i sfidave kryesore për ekonominë e Kosovës, siç është zvogëlimi i mëtejme i normës së papunësisë, kërkon norma edhe më të larta të rritjes ekonomike. Rritja e ekonomisë së Kosovës gjatë kësaj periudhe vlerësohet të jetë kryesisht rezultat i rritjes së konsumit, përderisa neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar negativisht në normën reale të rritjes ekonomike. Në anën tjetër, efekti i investimeve në normën reale të rritjes mund të konsiderohet të ketë qenë negativ për vitin 2014. Zhvillimet globale të çmimeve janë reflektuar edhe në Kosovë, ku norma e inflacionit në qershor 2014 qëndroi në 0.3 përqind, që paraqet nivelin më të ulët të inflacionit në vitet e fundit.

Sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Aktiviteti ndërmjetësues financiar gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 përshpejtoi trendin e rritjes duke ndryshuar trajektoren e ngadalsimit që e karakterizoi në dy vitet e fundit. Vlera e gjithsej kredive deri në qershor 2014 arriti në arriti në 1.89 miliard euro, që paraqet rritje vjetore prej 3.5 përqind. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, bankat në përgjithësi kanë lehtësuar standardet e kreditimit si dhe kanë ofruar kushte më të favorshme për klientët kreditor. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Pjesa më e madhe e kredive të ndërmarrjeve vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat në qershor 2014 kishin një pjesëmarrje prej 52.2 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet.

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhura brenda vendit, rritja e vazhdueshme e të cilave i bënë ato një burim të qëndrueshëm financimi. Në qershor 2014, gjithsej depozitat arritën vlerën prej 2.42 miliardë euro,

që paraqet rritje vjetore prej 10 përqind, rritje kjo më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Burimi kryesor i depozitave në sektorin bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë ekonomitë familjare, depozitat e të cilave konsiderohen të jenë më stabile në raport me burimet tjera të financimit. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të ulët të ekspozimit ndaj sektorit të jashtëm si në kuadër të asetëve ashtu edhe të depozitave, duke bërë që ndjeshmëria e sektorit ndaj zhvillimeve në tregjet e jashtme të jetë e ulët.

Aktiviteti ndërmjetësues financiar i bankave në Kosovë u karakterizua me rënie të normave të interesit si në kredi ashtu edhe në depozita. Në qershor 2014, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 10.6 përqind nga 12.0 përqind sa ishte në qershor 2013. Për sa i përket depozitave, rënia e normës së interesit ishte më e theksuar pasi që zbriti në 0.6 përqind krahasuar me 3.5 përqind sa ishte në qershor 2013. Sidoqoftë, dallimi ndërmjet normave të interesit në kredi dhe depozita u rritë në 10.0 pp nga 8.5 pp sa ishte në qershor 2013.

Sektori bankar i Kosovës deri në qershor 2014 shënoi rritje të konsiderueshme të fitimit. Fitimi neto i realizuar deri në qershor 2014 arriti vlerën prej 26.9 milionë euro, krahasuar me 15.2 milionë euro sa ishte deri në qershor 2013. Kjo rritje i fitimit është kryesisht rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për provizione dhe atyre të interesit në depozita, përderisa të hyrat e sektorit bankar shënuan rënie të lehtë gjatë kësaj periudhe.

Rreziqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar i Kosovës nuk kanë shënuar ndonjë ndryshim të konsiderueshëm gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Disa nga indikatorët e rrezikut kanë shënuar rritje të lehtë, por që në përgjithësi, vazhdimësia e menaxhimit të mirë të rreziqeve bankare ka rezultuar në performancë të mirë dhe pozicion të mirë likuiditetit, cilësi të mirë të portofolit kreditor dhe nivel të lartë të kapitalizimit.

Pozita e likuiditetit të sistemit bankar është përforcuar edhe më tutje. Raporti ndërmjet mjeteve likuide dhe detyrimeve afatshkurtra, që me rregulloren përkatëse të Bankës Qendrore kërkohet të mbahet në një nivel minimal prej 25 përqind, në qershor 2014 qëndroi në 43.7 përqind. Gjithashtu, rezervat e detyrueshme të bankave komerciale të mbajtura në BQK vazhdojnë të jenë në nivel më të lartë se sa minimumi i kërkuar rregullativ. Rritja më e shpejtë e depozitave në krahasim me rritjen e kredisë ka bërë që raporti kredi-depozita të jetë më i ulët se mesatarja e viteve të fundit. Rezultatet e stres-testit për sektorin bankar, të bazuar në skenarë mjaft konzervativ për sa i përket disponueshmërisë së asetëve likuide dhe normës së mundshme të tërheqjes së depozitave, poashtu paraqesin rezultate mjaft të favorshme për sa i përket aftësisë së sektorit bankar për të plotësuar kërkesat për tërheqje më të mëdha të depozitave.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor me një pjesëmarrje të kredive joperformuese në gjithsej kreditë prej 8.2 përqind në qershor 2014, që paraqet nivelin më të ulët në kuadër të vendeve të rajonit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vërehet një rritje e raportit të kredive joperformuese për 0.4 pp, mirëpo krahasuar me fillimin e vitit 2014 vërehet se raporti i kredive joperformuese ka shënuar rënie. Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbje nga kreditë. Në qershor 2014, shkalla e mbulueshmërisë me provizione ishte 116.4 përqind, gjë që tregon se bankat kanë ndarë nivel të kënaqshëm të provizioneve për t'u ballafaquar me humbjet e mundshme nga kreditë. Në kuadër të strukturës së kredive të sektorit bankar është evidentuar rritje relativisht e shpejtë e vlerës së ekspozimeve të mëdha kreditore, që paraqet rritje të ekspozimit të bankave ndaj rrezikut kreditor. Megjithatë, duhet pasur parasysh faktin se rritja e vlerës së ekspozimeve është ndikuar pjesërisht nga ndryshimet në rregulloren e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit, si rezultat i së cilës është ndryshuar mënyra e klasifikimit të kapitalit të klasit të parë.

Niveli i kapitalizimit në sektorin bankar të Kosovës vazhdon të jetë i lartë. Në qershor 2014, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndroi në 17.4 përqind, që tejkalon nivelin minimal prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Niveli i mjaftueshëm i kapitalizimit të sektorit

bankar tregohet edhe nga rezultatet e stres-testit të cilat sugjerojnë se niveli aktual i kapitalizimit i mundëson bankat të përballojnë edhe norma më të theksuara të rritjes së kredive joperformuese ose rreziqe të tjera bankare siç është rreziku i tregut. Bankat të cilat operojnë në Kosovë mund të konsiderohen se kanë shkallë të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të tregut si rezultat i faktit që pjesa më e madhe e kredive dhe depozitave kanë normë fikse të interesit si dhe faktit që pjesa dërmuese e aseteve dhe detyrimeve janë në valutën euro.

Përderisa infrastruktura bankare gjatë kësaj periudhe u karakterizua me zvogëlim të numrit të nëndegëve, numrit të punësuarve dhe bankomatëve, rritja e vazhdueshme e rrjetit të pajisjeve POS nga sektori bankar ndikoi në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare. Rritja e sigurisë në sistemin e pagesave ka ndikuar në rritjen e mëtejme të numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera përmes sistemit të vetëm ndërbankar të pagesave në Kosovë (SEKN). Rritje e theksuar është shënuar edhe në numrin e llogarive dhe transaksioneve nëpërmjet E-banking. Vlera e transaksioneve nëpërmjet E-banking deri në qershor ka arritur në 1.7 miliardë euro krahasuar me 1.1 miliardë euro sa ishin në qershor 2013

Për sa i përket institucioneve tjera financiare, asetet e sistemit pensional vazhduan të rriten, duke arritur vlerën prej mbi 1 miliard euro në qershor 2014, që paraqet një rritje vjetore prej 24 përqind. Pjesa më e madhe e aseteve të sistemit pensional vazhdon të menaxhohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, asetet e të cilit shënuan përmirësim të performancës e cila u shpreh si në rritje të çmimit të aksionit ashtu edhe në kthimin pozitiv nga investimet. Me rritje të veprimtarisë u karakterizua edhe sektori i sigurimeve, asetet e të cilit arritën vlerën prej 135.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.2 përqind. Sektori i sigurimeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 realizoi fitim prej 113 mijë euro, që reflekton përmirësim në krahasim me humbjet e vitit të kaluar. Sektori i institucioneve mikrofinanciare gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 kishte aktivitet po thuaj se të njëjtë me vitin paraprak. Asetet e sektorit mikrofinanciar arritën në 113.1 milionë euro, që paraqet rritje prej 0.3 përqind, mirëpo që paraqet një zhvillim pozitiv kur kemi parasysh trendin rënës të aseteve që ka karakterizuar këtë sektor në vitet e fundit.

3. Ekonomia e Eurozonës

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2014 u zhvillua në një ambient më të vështirësuar makroekonomik. Rritja e dobët reale që karakterizoi disa nga rajonet e mëdha në gjysmën e parë të vitit 2014 ndikoi që FMN të revidojë projeksionet për rritjen ekonomike globale dy herë gjatë këtij viti. Parashikimet paraprake të FMN-së sugjerorin rritje ekonomike globale prej 3.6 përqind në vitin 2014, përderisa në korrik dhe përfundimisht në tetor të këtij viti, FMN uli parashikimet e saj në 3.4, përkatësisht 3.3 përqind (figura 1).


Pritjet për një aktivitet më të dobët ekonomik edhe në vitin 2015 u pasqyruan në rishikimin e normës së parashikuar paraprakisht prej 4.0 përqind në 3.8 përqind në tetor të vitit 2014. Parashikimet ekonomike ndryshojnë ndërmjet rajoneve dhe sidomos ndërmjet vendeve edhe për vitin 2014. Rritja e aktivitetit ekonomik në nivel global është nxitur kryesisht nga ekonomia e SHBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, përderisa Japonia dhe eurozona u karakterizuan me rritje modeste ekonomike gjatë kësaj periudhe.

Ekonomia e eurozonës është karakterizuar me një rritje të dobët reale gjatë vitit 2014. Aktiviteti ekonomik në eurozonë në tremujorin e parë të vitit tregoi shenja më të forta të rimëkëmbjes, përderisa tremujori i dytë dhe tretë i vitit 2014 treguan shenja të dobësimit dhe pothuajse stagnimit të rritjes. Dobësimi i aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit 2014 si dhe tensionet e ngjitur gjeopolitike në mes të Rusisë dhe Ukrainës ndikuan që FMN të revidojë projeksionet ekonomike për vitin aktual dhe vitin 2015. Nga një rritje vjetore paraprakisht e projektuar prej 1.1 përqind në korrik të vitit 2014, në muajin tetor FMN uli pritjet në 0.8 përqind. Edhe për vitin 2015, FMN rishikoi projeksionet ekonomike për eurozonën nga 1.5 përqind sa kishte parashikuar paraprakisht në 1.3 përqind.

Kjo rritje e dobët ekonomike nuk pritet se do të ndikoj në uljen e borxhit publik. Përkundrazi, sipas të dhënave të FMN-së borxhi publik pritet të arrijë në rreth 85 përqind në fund të vitit 2014 nga rreth 83 përqind sa ishte në vitin e kaluar. Pothuajse të gjitha shtete e eurozonës pritët të thellojnë nivelin e borxhit publik, veçanërisht shtetet të cilat cilësohen me nivel të lartë të borxhit publik. Në anën tjetër, Greqia e cila ka nivelin më të lartë të borxhit publik në eurozonë (174.2 përqind e PBB-së), pritët ta reduktoj atë për 1.0 pp. Borxhi publik në eurozonë pritët të thellohet edhe për faktin se pothuajse të gjitha shtet e eurozonës pritët të shënojnë deficit buxhetor i cili në nivel të eurozonës pritët të jetë 2.8 përqind e PBB-së.

Aktiviteti i brishtë dhe i paqëndrueshëm ekonomik u reflektua edhe përmes Treguesit të Sentimentit Ekonomik (TSE) të publikuar nga Komisioni Evropian. TSE përfshinë vërtetimet e besueshmërisë për sektorë të ndryshëm ekonomikë (industri, shërbime, të ndërtimit dhe të tregtisë me pakicë), dhe ekonomitë familjare (të matura përmes besimit të konsumatorëve). Pas një tendence rritëse që nga fundi i vitit 2012, TSE shënoi rënie sidomos nga muaji maj i vitit 2014. Përkeqësimi i TSE-së sidomos në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2014 ishte më i theksuar në Itali, Gjermani dhe Francë.

Figura 1. Rritja reale e PBB-së




Burimi: IMF WEO (Tetor 2014)

Një ndër indikatorët kryesor për vlerësimin e aktivitetit ekonomik në Gjermani, si ekonomia qendrore e eurozonës, është edhe indeksi i biznesit IFO që vlerëson klimën biznesore, gjendjen aktuale të bizneseve dhe pritjet e bizneseve. Sipas këtij indeksi, klima e biznesit në Gjermani në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 mbeti përgjithësisht optimiste. Megjithatë, dobësimi i aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë të vitit 2014 rezultoi në përkeqësim të klimës së biznesit në Gjermani në tremujorin e tretë të këtij viti, përderisa pritjet për gjashtë muajt e ardhshëm mbetën pesimiste (figura 2). Indeksi i klimës së biznesit në Gjermani shënoi rënie për sektorin e prodhimit, të shitjes me shumicë dhe për sektorin e ndërtimit. Ambienti ekonomik në vendet anëtare të unionit mund të pësojë në periudhat në vazhdim nga dobësimi eventual i investimeve dhe eksporteve si pasojë e rreziqeve të ngritura gjeopolitike, rritja e ngathët ekonomike dhe pasiguritë në implementimin e reformave strukturore.

Në këtë periudhë, fuqia blerëse e konsumatorëve ka qenë më e lartë, duke iu atribuar nivelit të ulët të inflacionit në eurozonë (figura 3). Presionet e ulëta inflacioniste vazhdojnë të jenë të pranishme në eurozonë, kryesisht si pasojë e kërkesës së dobët, rënies së çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare si dhe problemeve tjera strukturore siç është shkalla ende e lartë e papunësisë. Në vitin 2014, ekonomia e eurozonës pritet të karakterizohet me një normë të inflacionit prej 0.5 përqind (1.3 përqind në vitin 2013).


Reformat e vazhdueshme strukturore në eurozonë janë reflektuar në përmirësim të kushteve në tregjet e punës. Megjithatë, efekti i plotë i reformave të implementuara në tregjet e punës nga disa nga vendet e eurozonës pritet të ndjehet në një periudhë më të vonshme kohore. Norma e papunësisë në vitin 2014 pritet të shënojë një rënie të lehtë në 11.6 përqind, nga 11.9 përqind sa ishte në vitin 2013. Në kuadër të vendeve të eurozonës, tregu i punës në Gjermani rezultoi të ketë mbetur i pandryshuar dhe FMN parashikon një normë të ngjashme të papunësisë prej 5.3 përqind në vitin 2014, përderisa Italia, Holanda dhe Finlanda priten të karakterizohen me rritje të lehtë të shkallës së papunësisë.

Figura 2. Klima e biznesit në Gjermani dhe rritja ekonomike




Burimil: IFO (2014)

Figura 3. Inflacioni vjetor



Burimil: IMF, WEO (Tetor 2014)

Figura 4. Papunësia, në përqindje




Burimi: IMF, WEO (Tetor 2014)

Politikat lehtësuese monetare të ndërmarr nga bankat qendrore në vendet e zhvilluara, përfshirë eurozonën, kanë vazhduar ta mbështesin rritjen ekonomike. Aktiviteti i dobët ekonomik ka shkaktuar presion tek BQE për të ndërmarr masa shtesë në politikën tashmë të lehtësuar monetare. Gjatë vitit 2014, BQE intervenoi në norma të interesit në qershor dhe pastaj në shtator, duke i zbritur në nivel rekord, për të nxitur rritjen e kërkesës dhe normalizuar presionet e ulëta inflacioniste. Megjithatë, impulsi i politikës së lehtësuar monetare nuk është përçarur njëtrajtësisht tek ekonomitë periferike të eurozonës dhe nuk është përkthyer në rritje më të fuqishme në ekonomitë qendrore të saj. Mbështetja e sektorit privat përmes kreditimit bankar vazhdoi të mbetet e ulët edhe në vitin 2014 në eurozonë, kryesisht si pasojë e ofertës ende të shtrënguar kredituese, rrezikut kreditor dhe përshtatjeve të vazhdueshme në bilancin e gjendjes së sektorit financiar dhe jofinanciar.

Eurozona është karakterizuar me bilanc pozitiv të llogarisë rrjedhëse prej 0.8 përqind të PBB-së në vitin 2014, (2.4 përkatësisht 0.8 përqind në vitin 2013). Përmirësimi i llogarisë rrjedhëse në vendet e eurozonës pritet të nxitet nga rritja më e shpejtë e eksporteve kundrejt rritjes së importeve, përderisa zhvlerësimi i vazhdueshëm i euros kundrejt monedhave të tjera pritet të ndikojë në rritjen e mëtejme të konkurrueshmërisë së mallrave të unionit.

Figura 5. Llogaria rrjedhëse si pjesëmarrje e PBB-së, në përqindje



Burimi: IMF, WEO (Prill 2014)

3.1. Ballkani Perëndimor¹

Rikuperimi ekonomik që e karakterizoi Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2013 rezultoi të ketë qenë i brishtë, meqenëse performanca e aktivitetit ekonomik në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 në këto vende rezultoi të jetë përkeqësuar. Rritja ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2014 është vlerësuar të jetë 1.8 përqind, që paraqet një rritje më të ulët krahasuar me parashikimin fillestar. Rishikimi i rritjes ekonomike për vendet ballkanike kryesisht i është atribuar rikuperimit të dobët ekonomik në Bashkimin Evropian gjatë vitit 2014 dhe zhvillimeve jo të favorshme në disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në kuadër të vendeve të rajonit, ekonomia e Maqedonisë ishte një përjashtim, duke u karakterizuar me përforsim të ritmit të rritjes ekonomike në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Si rrjedhojë, FMN ka parashikuar rritje reale të ekonomisë së Maqedonisë prej 3.4 përqind në vitin 2014 (tabela 1). Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2014 u dobësua veçanërisht në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, vende këto që priten të karakterizohen me rënie ekonomike prej 0.5 përqind respektivisht rritje të dobët prej 0.7 përqind në vitin 2014. Aktiviteti ekonomik në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar përgjithësisht me një performancë të dobët të prodhimit industrial dhe ngadalësim të shprehur në sektorin e ndërtimitarisë. Vlenë të theksohet se reshjet e mëdha të shiut në pranverë dhe vërshimet që pasuan dëmuan rëndë aktivitetin ekonomik në Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi.

¹ Ballkani Perëndimor përfshinë: Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnje Hercegovinën, Serbinë dhe Malin e Zi.

Tabela 1. Norma e rritjes së PBB-së reale në vendet e Ballkanit Perëndimor


Vendet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kosova	7.2	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	3.0
Maqedonia	5.0	-0.9	2.9	2.8	-0.4	2.9	3.4
Serbia	3.8	-3.5	1.0	1.6	-1.5	2.5	-0.5
Shqipëria	7.5	3.4	3.5	2.3	1.1	0.4	2.1
Mali i Zi	6.9	-5.7	2.5	3.2	-2.5	3.5	2.3
Bosnja e H.	5.6	-2.7	0.8	1.0	-1.2	2.1	0.7

Burimi: FMN (WEO, 2014), për Kosovën të dhënat e ASK-së dhe vlerësimi i BQK-së për vitin 2014


Kërkesa përgjithësisht e dobët në rajon, përcjellë nga shkalla e ulët e inflacionit në nivel global si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare (veçanërisht të ushqimit), ka ndikuar që ambienti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor të karakterizohet me norma të ulëta të inflacionit. Sipas projeksioneve të fundit të FMN-së, si dhe trendit që përcollën çmimet në tetë muajt e parë të vitit 2014, Mali i Zi pritet të karakterizohet me deflacion prej 0.6 përqind. Me shkallë të ulët të inflacionit pritet të karakterizohen edhe vendet tjera, përfshirë edhe Serbinë e cila vazhdon të ketë normën më të lartë të inflacionit në rajon (2.3 përqind për vitin 2014) (figura 6).

Tregjet e punës në vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të ndajnë si karakteristikë të përbashkët shkallën e lartë të papunësisë sidomos tek të rinjtë dhe femrat, si dhe papunësinë afatgjatë. Sipas FMN-së, në vitin 2014, shkalla mesatare e papunësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të jetë rreth 24 përqind. Kosova vazhdon të karakterizohet me shkallën më të lartë të papunësisë prej 30 përqind, përdërisa Shqipëria pritet të kenë normën më të ulët të papunësisë prej 14 përqind në vitin 2014.

Sfidë e veçantë për vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet edhe shkalla e lartë e deficitit të llogarisë rrjedhëse që vazhdon ta karakterizojë sektorin e jashtëm të këtyre vendeve. Pothuajse të gjitha vendet pritet ta thellojnë deficitin e llogarisë rrjedhëse me përjashtim të Serbisë e cila pritet të ketë një përmirësim të lehtë (figura 7). Ky thellim i deficitit të llogarisë rrjedhëse është kryesisht rezultat i rritjes më të ngadalësuar të eksporteve dhe përsheptimit të rritjes së importeve. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të shënoj rritje prej mesatarisht 5.0 përqind (8.0 përqind ishte rritja në vitin e kaluar) ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve nga rritja prej mesatarisht 0.2 përqind në vitin e kaluar pritet të arrijë në 7.0 përqind.

Figura 6. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL

Burimi: FMN (2014)

Figura 7. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, në përqindje të PBB-së

Burimi: FMN (2014)

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, kryesisht si reflektim i dobësimit të aktivitetit ekonomik, vendet e rajonit si Serbia, Mali i Zi dhe Shqipëria raportuan rënie të aktivitetit kreditues (tabela 2). Në të njëjtën periudhë, lehtësimi i standardeve kreditore nga sektori bankar është përkthyer në rritje të portfolios kreditore në Maqedoni, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë.

Tabela 2. Norma e rritjes së kredive dhe depozitave në vendet e Ballkanit Perëndimor


Përshkrimi	Shqipëria		Bosnja e Hercegovina		Maqedonia		Mali i Zi		Serbia		Kosova	
	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014	Qer 2013	Qer 2014
Kreditë	0.7	-1.8	3.2	3.7	3.6	7.8	4.8	-3.3	-2.9	-5.3	2.8	3.5
Depozitat	4.8	1.0	4.4	7.7	3.2	8.7	9.0	6.8	4.4	3.3	4.4	10.0

Burimi: Komisioni Evropian - Raporti i tremujorit të tretë 2014; për Kosovën të dhënat e BQK-së.

Sa i përket depozitave në sektorin bankar, Kosova dhe Maqedonia shënuan rritjen më të lartë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, përderisa Shqipëria raportoi normën më të ulët të rritjes së depozitave gjatë kësaj periudhe. Vendet në Ballkanin perëndimor raportuan rritje të kredive jo-performuese edhe gjatë vitit 2014. Nivelin më të lartë të kredive jo-performuese deri në qershor 2014 e raportuan Serbia dhe Shqipëria, prej 23.0 përkatësisht 24.1 përqind, përderisa nivelin më të ulët të kredive jo-performuese vazhdon të raportoj Kosova prej mesatarisht 8.5 përqind (figura 8). Megjithatë, kreditë jo-performuese mbesin mirë të mbuluara nga provizionet dhe sektori bankar është mirë i kapitalizuar në vendet e Ballkanit perëndimor.

Sektori fiskal gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 është karakterizuar me përmirësim të performancës buxhetore në Shqipëri dhe Mal të Zi, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave që rezultoi nga rritja e taksave (Shqipëri) dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar mbledhjen e të hyrave buxhetore. Realizimi i shpenzimeve në Shqipëri dhe Mal të Zi mbeti nën nivelin e planifikuar. Në anën tjetër, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina u përballën me realizim më të ulët të të hyrave buxhetore, si pasojë e përkeqësimit të tregut pas vërshimeve që pësuan në fillim të vitit 2014. Në Maqedoni, zhvillimet buxhetore u karakterizuan me rritje të shpenzimeve në tremujorin e parë të vitit 2014, megjithëse realizimi i shpenzimeve kapitale ishte nën nivelin e planifikuar. Një situatë e ngjashme e karakterizoi edhe Kosovën, me rritje të pagave dhe pensione dhe me zvogëlim të shpenzimeve kapitale. Shkallën më të lartë të deficitit buxhetor e shënoi Serbia (7.6 përqind të PBB-së) dhe Maqedonia (6.0 përqind të PBB-së), ndërsa vendet tjera pritet të kenë nivele më të ulëta të deficitit buxhetor. Borxhi publik në Ballkanin Perëndimor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 ka shënuar ngritje të lehtë nga mesatarisht 42.2 përqind e PBB-së në fund të vitit 2013 në 43.0 përqind në qershor 2014. Shqipëria dhe Serbia janë vendet me shkallën më të lartë të ngarkesës me borxhe publike (rreth 64 përqind e PBB-së) ndërsa Kosova ka shkallën më të ulët (10.2 përqind e PBB-së).

Figura 8. Norma e kredive joperformuese në EJL




Burimi: Komisioni Evropian (2014)

Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë

ProCredit Holding – PCH (Gjermani)


Treguesit kryesorë financiar të Procredit Holding (PCH) janë karakterizuar me një përfomancë të kënaqshme gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2014. Vlera e gjithsej asetëve të PCH deri në qershor 2014 arriti në 5.8 miliardë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 0.7 përqind. Deri në qershor 2014, gjithsej kreditë e PCH arritën vlerën prej 4.3 miliardë euro, që tregon për një rënie vjetore prej 0.4 përqind (figura 9).

Figura 9. Trendi i rritjes së kredive, në përqindje



Burimi: Raportet gjashtëmuajore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Figura 10. Trendi i rritjes së depozitave, në përqindje




Burimi: Raportet gjashtëmuajore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Evropa Lindore përfaqëson pjesën më të rëndësishme të aktivitetit kreditues të PCH-së, për shkak se 71.6 përqind e gjithsej kredive të PCH janë të lëshuara në këtë regjion dhe u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.6 përqind në qershor 2014. Rreth 25.7 përqind e gjithsej kredive të PCH janë të lëshuara në regjionin e Amerikës Jugore dhe atë Qendrore. Kreditë e lëshuara në këtë regjion kanë shënuar rënie vjetore prej 0.7 përqind. Ndërsa, 1.9 përqind e gjithsej kredive të PCH janë të lëshuara për regjionin e Afrikës. Kreditë e lëshuara për këtë regjion kanë shënuar rënie vjetore prej 19.8 përqind në qershor 2014. Kjo rënie në masë të rëndësishme u ndikua nga shitja e Procredit bankës në Mozambik.


PCH vazhdoi të ketë si burim kryesor të financimit të aktiviteteve të saj depozitat e mbledhura nga klientët. Deri në qershor 2014, depozitat në PCH arritën vlerën 3.7 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.3 përqind (figura 10). Zvogëlimi i aktivitetit kreditues kundrejt rritjes së gjithsej depozitave ka rezultuar në zvogëlimin e raportit të kredive ndaj depozitave. Ky raport në qershor 2014 arriti në 114.3 përqind, nga 116.2 përqind në qershor 2013.

Figura 11. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave, në përqindje



Burimi: Raportet gjashtëmuajore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Figura 12. Kthimi në kapital (ROE), në përqindje



*ROE është anualizuar
Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Indikatori i përgjithshëm i efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, ka shënuar rënie vjetore prej rreth 1.6 pikë përqindje duke rënë kështu në 73.5 përqind në qershor 2014 (figura 11). Përmirësimi i treguesit të efikasitetit kryesisht i atribuohet rënies më të shpejtë të shpenzimeve operacionale (rënie vjetore prej 9.5 deri në qershor 2014), kundrejt rënies së të hyrave operacionale (rënie vjetore për 8.5 përqind). Rënia më e shpejtë e shpenzimeve operacionale ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve për personelin, që shënuar rënie vjetore prej 12.1 përqind. Po ashtu, shpenzimet

administrative që përbëjnë 50.9 përqind të gjithë shpenzimeve operacionale, shënuan rënie vjetore prej 6.7 përqind. Në kuadër të të hyrave të PCH, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore 8.9 përqind që u ndikua nga rënie e lehtë e kreditimit gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, edhe të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 4.6 përqind gjatë kësaj periudhe. Mirëpo, si rezultat i menaxhimit më të mirë të shpenzimeve, pavarësisht rënies së arkëtimit të të hyrave, profiti i PCH-së deri në qershor 2014 rezultoi të jetë për 4.3 përqind më i lartë se profiti i realizuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit të kaluar. Deri në qershor 2014, profiti i realizuar nga PCH arriti në 22.9 milionë euro (21.9 milionë euro deri në qershor 2013).

Norma e kthimit në kapital (ROE) (e anualizuar) deri në qershor 2014 arriti në 9.1 përqind krahasuar me 7.7 përqind sa ishte në dhjetor 2013 (figura 12). Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*) qëndroi në 12.4 përqind në qershor 2014 (12.8 përqind në qershor 2013), që përkundër rënies për 0.4 pikë përqindje, vazhdon t'i përmbushë kërkesat rregullative (figura 13).

Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)


Raiffeisen Bank International (RBI) gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 shënoi përmirësim të indikatorëve kyç të performancës. Pavarësisht kësaj, vlera e gjithë asetëve të RBI-së u ndikua negativisht nga tensionet gjeopolitike në Ukrainë dhe ndryshimeve në legjislacionin e sektorit bankar në Hungari. Në qershor 2014, vlera e gjithë asetëve të RBI arriti në 127.3 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.3 përqind. Kreditë, që përfaqësojnë rreth 64.0 përqind të gjithë asetëve të RBI-së, arritën vlerën në 80.8 miliard euro në qershor 2014, një rënie vjetore prej 1.4 përqind. Depozitat, që përfaqësojnë rreth 51.0 përqind të gjithë detyrimeve, njëherësh edhe burimin kryesor të financimit të RBI-së, në qershor 2014 arritën vlerën prej 64.4 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 3.3 përqind. Si rrjedhojë e rënies më të shpejtë të depozitave në krahasim me rënien e nivelit të kredive, raporti kredi/depozita u rrit për 2.5 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 125.5 përqind në qershor 2014.

Indikatori i përgjithshëm i efikasitetit, i shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, ka shënuar përmirësim duke u zvogëluar në 55.3 përqind në qershor 2014 nga 57.5 përqind sa ishte në qershor 2013. Përmirësimi i treguesit të efikasitetit kryesisht i atribuohet rënies më të shpejtë të shpenzimeve operacionale (rënie vjetore prej 6.1 përqind), krahasuar me rënien e të hyrave operacionale për 2.4 përqind deri në qershor 2014. Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet e personelit u karakterizuan me rënie vjetore prej 4.8 përqind, ndërsa shpenzimet administrative shënuan rënie vjetore prej 5.5 përqind deri në qershor 2014. Në kuadër të të hyrave operative, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 5.7 përqind, kurse të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 1.0 përqind. Gjatë kësaj periudhe, RBI ka ndarë një shumë më të lartë të shpenzimeve për provizione ndaj humbjeve të mundshme nga kreditë për shkak të vështirësive ekonomike në Ukrainë. Mirëpo, përkundër rritjes së shpenzimeve për provizione, profiti i RBI-së deri në qershor 2014 arriti në 344.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 24.4 përqind.

Kthimi në kapital (ROE) i RBI-së (i anualizuar) në qershor 2014 qëndroi në 5.4 përqind, që paraqet një përmirësim krahasuar me normën prej 4.9 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) në qershor 2014 qëndroi në 16.8 përqind, që paraqet një përmirësim krahasuar me normën prej 15.1 sa ishte në qershor 2013. Kurse, raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithë kredive në qershor 2014 u rrit në 10.7 përqind krahasuar me 9.9 sa ishte në qershor 2013. Në qershor 2014, mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione qëndroi në 65.3 përqind krahasuar me 67.3 sa ishte në qershor 2013.

RBI vazhdon të jetë e vetmja nga tri grupet bankare kryesore që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Çmimi për aksion të RBI-së në bursën e Vjenës në qershor 2014 u rrit në 23.3 euro krahasuar me 21.5 euro sa ishte në qershor 2013.

Figura 13. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit CAR, në përqindje



Burimi: Raportet gjashtëmujore të grupeve bankare përkatëse (2014)

NLB Group (Slloveni)

NLB Group gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 vazhdoi të karakterizohet me rënie të aktivitetit, mirëpo shënoi përmirësim të treguesve të shëndetit financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Asetet e NLB Group vazhdojnë të shënojnë rënie, por e cila është më e ulët krahasuar me vitin e kaluar. Deri në qershor 2014, gjithsej asetet arritën në 12.2 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 11.7 përqind. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2014, NLB Group shënoi rënie si në dhënien e kredive ashtu edhe në mbledhjen e depozitave. Vlera e gjithsej kredive në qershor 2014 arriti në 7.6 miliard euro, që paraqet një rënie prej 16.7 përqind. Rënia e kreditimit kryesisht e pranishme te kreditë ndaj korporatave, kurse kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi një rritje të lehtë. Në kuadër të detyrimeve, vlera e gjithsej depozitave në qershor 2014 arriti në 8.8 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 3.6 përqind. Rënia e gjithsej depozitave ishte rezultat i zvogëlimit të konsiderueshëm të depozitave qeveritare, kurse depozitat e korporatave dhe të ekonomive familjare shënuan rritje. Zvogëlimi më i shpejtë i kredive në raport me depozitat bankare ndikoi që raporti kredi/depozita të zvogëlohet në 87.0 përqind në qershor 2014 nga 100.6 sa ishte në qershor 2013. Pjesën tjetër të financimit, NLB Group vazhdon ta sigurojë nga huamarrjet e ndryshme dhe nga kapitali vetanak.

Indikatori i përgjithshëm i efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, ka shënuar rënie vjetore për 21.3 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin prej 59.9 përqind në qershor 2014. Ky përmirësim i treguesit të efikasitetit kryesisht i atribuohet rritjes më të shpejtë të të hyrave operacionale (rritje vjetore prej 25.8 përqind në qershor 2014), kundrejt zvogëlimit të shpenzimeve operacionale për 7.2 përqind. Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 7.7 përqind, kurse të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje vjetore prej 1.7 përqind deri në qershor 2014. Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet për personelin shënuan rënie vjetore prej 6.5 përqind deri në qershor 2014, kurse shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rënie vjetore prej 3.6 përqind. Si rrjedhojë e menaxhimit më të mirë të shpenzimeve, menaxhimit më të mirë në arkëtimin e të hyrave si dhe zvogëlimit të shpenzimeve për provizione, NLB Group arriti që në gjashtëmujorin e parë 2014 të realizojë profit për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur kishte shënuar humbje. Deri në qershor 2014, fitimi i NLB Group arriti në 34.0 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 91.2 milionë të regjistruar deri në qershor 2013.

Si rrjedhojë, norma e kthimit në kapital (e analizuar deri në qershor 2014) u përmirësua në 5.3 përqind krahasuar me -135.5 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Po ashtu, NLB Group ka përfunduar nivelin e kapitalizimit shprehur përmes treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR), që arriti në 15.7 përqind në qershor 2014, krahasuar me 10.1 përqind sa ishte në qershor 2013. Përmirësim u shënuar edhe cilësinë e portofolit kreditor, ku raporti ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive u zvogëluar në 25.8 përqind në qershor 2014 krahasuar me 31.1 përqind sa ishte në qershor 2013. Rrjedhimisht, mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione u përmirësua në 70.7 përqind krahasuar me 57.6 përqind sa ishte në qershor 2013.

4. Ekonomia e Kosovës


Zhvillimet në treguesit kryesor makroekonomik tregojnë për performancë pozitive të ekonomisë së Kosovës gjatë vitit 2014. Sipas vlerësimeve të BQK-së, norma reale e rritjes ekonomike pritet të jetë 3.0 përqind (figura 14). Rritja ekonomike gjatë vitit 2014 vlerësohet të jetë kryesisht rezultat i rritjes së konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet pritet të kontribuojnë negativisht. Komponenta kryesore në kuadër të PBB-së mbetet konsumi, me pjesëmarrje prej 105.2 përqind. Konsumi privat gjatë kësaj periudhe pritet të shënojë rritje reale prej 6.4 përqind, ndërsa konsumi publik pritet të rritet me normë prej 5.0 përqind. Rritja e konsumit privat kryesisht i atribuohet rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, përderisa rritja e konsumit publik i atribuohet kryesisht rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë.

Investimet në vitin 2014 pritet të shënojnë rënie reale për 10.0 përqind, krahasuar me vitin paraprak. Në përgjithësi, përkeqësimi i investimeve vlerësohet të jetë pasojë e rënies së konsiderueshme të investimeve publike, të shkaktuara nga vonesat në konsolidimin e institucioneve në vend, përderisa investimet private pritet të shënojnë rritje. Rritja e investimeve private pritet të gjenerohet nga rritja e konsiderueshme e kredive investuese, të cilat neutralizuan deri në një masë efektin e rënien së investimeve të huaja direkte (IHD) gjatë kësaj periudhe.

Neto eksporti për vitin 2014 pritet të karakterizohet me përkeqësim si në terma real, ashtu edhe në terma nominal. Në terma real neto eksporti pritet të thellojë deficitin për 2.2 përqind në vitin 2014, duke kontribuar negativisht në rritje ekonomike. Përkundër pritjeve se eksporti i mallrave dhe shërbimeve do të rritet me rreth 9.6 përqind, efekti i tyre neutralizohet nga pritjet për rritje të importit të mallrave dhe shërbimeve me 4.9 përqind.


Rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2014 u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës. Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë vitit 2014 është duke u karakterizuar me normë dukshëm më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Norma mesatare vjetore e inflacionit deri në qershor 2014 ishte 0.3 përqind, kundrejt inflacionit prej 2.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 15). Gjatë kësaj periudhe, çmimet e energjisë dhe pijeve alkoolike shënuan rritje, ndërsa me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht mallrat e importuara, gjegjësisht produktet ushqimore dhe pijet joalkoolike. Si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe,

Figura 14. Rritja Reale e PBB-së, në përqindje



(e) Vlerësim i BQK-së, (f) Projektion i BQK-së
Burimi: ASK (2013), (e) BQK (2014)

Figura 15. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulime të BQK-së (2014)


si dhe pjesëmarrjes relativisht të lartë të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme në shportën e konsumatorit, lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare vazhdojnë të jenë përcaktuesi kryesor i lëvizjes së çmimeve në vend. Në gjysmën e parë të vitit 2014, sikurse IÇK-ja, edhe çmimet e importit dhe çmimet e prodhimit u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.2 përkatësisht 0.6 përqind.

Sektori fiskal deri në qershor 2014 u karakterizua me rënie të lehtë të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve. Të hyrat e përgjithshme buxhetore shënuan rënie prej 0.3 përqind dhe arritën vlerën prej rreth 603.0 milionë euro. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në rreth 625.0 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 2.1 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 22.0 milionë euro apo 0.8 përqind të PBB-së krahasuar me 0.3 përqind të PBB-së sa ishte në vitin paraprak. Edhe borxhi publik deri në qershor 2014 arriti në rreth 10.2 përqind e PBB-së që është për 1.1 pikë përqindje më i lartë se sa fundi i vitit 2013.

Sektori i jashtëm u karakterizua me përkeqësim të pozicionit tregtar në gjysmën e parë të vitit 2014 (figura 16). Kategoria e transfereve rrjedhëse vazhdon të ndikojë në zvogëlimin e deficitit të komponentës së llogarisë rrjedhëse dhe kapitale të bilancit të pagesave të Kosovës. Remitencat si njëra ndër komponentët kryesore të llogarisë rrjedhëse shënuan rritje prej 6.9 përqind në gjysmën e parë të vitit 2014 dhe arritën vlerën prej 291.3 milionë euro. Pozicioni i llogarisë financiare gjithashtu u karakterizua me përkeqësim në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014, përcaktuar kryesisht nga rënia e IHD-ve në vend, bilanci i të cilave u zvogëluar në 37.5 milionë euro (141.0 milionë euro në gjashtëmuorin e parë të vitit 2013).

Sistemi financiar është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Roli i sektorit bankar në financimin e aktivitetit ekonomik në vend u përforcua gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Përsheptimi i rritjes së aktivitetit kreditues gjatë kësaj periudhe, nxitur kryesisht nga ana e ofertës, dhe zvogëlimi i vazhdueshëm i kostos së financimit kanë ndikuar në rritjen e mëtejme të konsumit dhe investimeve private.

Figura 16. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në milionë euro



Burimi: ASK (2014)

5. Sistemi Financiar i Kosovës

5.1. Karakteristikat e Përgjithshme

Sistemi financiar i Kosovës gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2014 ka vazhduar zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të tij në mënyrë të qëndrueshme. Gjithsej asetet e sistemit, deri në qershor 2014, arritën vlerën prej 4.3 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 12.2 përqind, e cila është më e lartë se sa rritja vjetore prej 8.1 përqind në vitin e kaluar (figura 17). Rritja e gjithsej asetëve të sistemit financiar kryesisht i atribuohet rritjes së asetëve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale. Sektori i sigurimeve, me gjithë zgjerimin e aktivitetit, kishte kontribut më të vogël në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit financiar, përderisa ndikimi i sektorit mikrofinanciar ishte neutral.


Sektori bankar vazhdon të jetë sektori kryesor, duke përfaqësuar 70.8 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar në qershor 2014 (figura 18). Asetet e sektorit bankar në qershor 2014 shënuan rritje vjetore prej 9.8 përqind, që paraqet një rikuperim të trendit të rritjes duke pasur parasysh ngadalësimin e rritjes të ndjekur gjatë dy viteve paraprake.

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së asetëve. Në qershor 2014, asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 24.0 përqind, duke bërë që pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sektorit financiar të arrijë në 23.2 përqind krahasuar me 21.0 përqind në qershor 2013.

Zgjerim të aktivitetit regjistroi edhe industria e sigurimeve, por ritmi i rritjes ishte më i ulët se sa në vitin paraprak. Asetet e kompanive të sigurimit në qershor 2014 shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind (8.3 përqind në qershor 2013). Rritja më e ngadalësuar ndikoi edhe në uljen e pjesëmarrjes të sektorit të sigurimeve në gjithsej asetet e sistemit financiar në 3.1 përqind në qershor 2014, nga 3.4 përqind sa ishte në qershor 2013.


Sektori i institucioneve mikrofinanciare, që gjatë tri viteve të fundit u karakterizua me zvogëlim të asetëve, në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014 ndërpreu trendin rënës. Në qershor 2014, vlera e asetëve të këtij sektori shënoi rritje vjetore prej 0.2 përqind dhe përfaqësoi 2.6 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar. Ndërsa, asetet e ndihmësve financiar në qershor 2014 shënuan rënie vjetore prej 7.3 përqind dhe përfaqësuan rreth 0.2 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar.

Figura 17. Ndryshimi vjetor i asetëve të sistemit financiar dhe sektorëve përkatës, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 18. Struktura e asetëve të sistemit financiar, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Tabela 3. Numri i institucioneve financiare²

Përshkrimi	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014
Bankat komerciale	8	8	9	10
Kompanitë e sigurimeve	11	13	13	13
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	32	39	40	41
Institucionet mikrofinanciare	17	19	18	18

Burimi: BQK(2014)


Sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë, struktura e sistemit financiar mbetet e ngjashme me periudhat e kaluara. Në qershor 2014, në Kosovë operuan gjithsej 84 institucione financiare, pjesa më e madhe e të cilave përbëhet nga institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar (tabela 3). Gjatë gjashtëmuajorit të parë të viti 2014, u licencua edhe një bankë me kapital të huaj, duke çuar numrin e bankave të licencuara në Kosovë në dhjetë.

5.2 Ekspozimi ndaj jo-rezidentëve

Asetet e sistemit financiar të Kosovës që janë të investuara jashtë vendit, në qershor 2014 shënuan rritje vjetore prej 10.2 përqind, duke arritur në 1.3 miliardë euro.³ Struktura e aseteve të jashtme përbëhet kryesisht nga asetet dhe ekuitetet tjera me pjesëmarrje prej 56.3 përqind, pasuar nga letrat me vlerë me pjesëmarrje prej 18.1 përqind dhe depozitat me pjesëmarrje prej 16.2 përqind. Pjesa e mbetur përfaqësohet nga kreditë që marrin pjesë me 8.9 përqind dhe asetet tjera me 0.4 përqind (figura 19). Në kuadër të gjithsej aseteve të jashtme, përjashtuar investimet në asete dhe ekuitete tjera që shënuan rënie krahasuar me vitin paraprak (-3.3 përqind), investimet tjera në sektorin e jashtëm shënuan rritje. Normën më të lartë të rritjes e shënuan investimet në letra me vlerë (61.2 përqind) dhe kreditë (41.5 përqind)


Vlera e gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm shënoi rritje të konsiderueshme. Në qershor 2014, vlera e detyrimeve arriti në 258.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 21.1 përqind. Struktura e detyrimeve dominohet nga kreditë me pjesëmarrje prej 62.4 përqind, pasuar

Figura 19. Struktura e kërkesave të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 20. Struktura e detyrimeve të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

² Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës.

³ Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria "paraja e gatshme". Kjo për faktin se euro në statistikat monetare dhe financiare konsiderohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve), mirëpo këto mjete janë në Kosovë.

nga depozitat me 36.0 përqind dhe detyrimet tjera me pjesëmarrje prej 1.5 përqind (figura 20). Në kuadër të gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, rritjen më të theksuar e shënuan kreditë, kryesisht të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare, të cilat shënuan rritje prej 23.2 përqind, si dhe depozitat që shënuan rritje prej 20.2 përqind.


Rrjedhimisht, deri në qershor 2014, vlera e aseteve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës arriti në 1.1 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.9 përqind. Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej AJN-të vazhdojnë ta kenë fondet pensionale që përfaqësuan rreth 70 përqind të AJN-ve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet kryesisht nga AJN-të e sektorit bankar. I vetmi segment që shënoi bilanc negativ të AJN-ve vazhdon të jetë sektori mikrofinanciar, kryesisht si rezultat i mbështetjes së lartë në financim të jashtëm, në formë të linjave kreditore (figura 21).

Ekspozimi i sistemit financiar ndaj jo rezidentëve vazhdon të mbetet më i theksuar në kuadër të aseteve, krahas ekspozimit më të ulët në kuadër të detyrimeve. Më konkretisht, asetet e jashtme ndaj gjithsej aseteve të sistemit financiar në qershor 2014 arritën në 31.0 përqind (31.5 përqind në qershor 2013), ndërsa detyrimet e jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sistemit financiar arritën në 6.0 përqind (5.5 përqind në qershor 2013) (figura 22). Sa i përket ekspozimit sektorial, sektori bankar vazhdon të ketë ekspozim më të ulët

ndaj sektorit të jashtëm, ndërsa sektori pensional vazhdon të jetë më i ekspozuar në kuadër të aseteve dhe ai mikrofinanciar në kuadër të detyrimeve të jashtme. Ekspozimi i sektorit bankar në kuadër të detyrimeve është më i ulët në krahasim me ekspozimin në kuadër të aseteve. Detyrimet e jashtme përfaqësojnë 6.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, përderisa asetet e jashtme përfaqësojnë 19.0 përqind të gjithsej aseteve. Në kuadër të sektorit bankar, bankat e mëdha janë më shumë të ekspozuara ndaj sektorit të jashtëm krahasuar me bankat e vogla, si në kuadër të aseteve ashtu edhe të detyrimeve. Kjo para se gjithash reflekton faktin se bankat më të mëdha janë banka të huaja, të cilat kanë një shkallë më të lartë të ndërveprimit me sektorin e jashtëm dhe veçanërisht me bankat e tyre amë.


Sektori i fondeve pensionale vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj sektorit të jashtëm vetëm në kuadër të aseteve. Në qershor 2014, asetet e investuara jashtë vendit 75.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit pensional. Për dallim nga sektorët tjerë, sektori mikrofinanciar është i ekspozuar vetëm në kuadër të detyrimeve dhe deri në qershor 2014 niveli i ekspozimit ishte 54.9 përqind. Niveli i theksuar i ekspozimit kryesisht bazohet në linjat kreditore të jashtme të cilat janë burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues të këtyre institucioneve, meqenëse nuk kanë të drejtë ligjore të mbledhin depozita të klientëve.

Figura 21. Asetet e jashtme neto sipas institucionieve financiare, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 22. Ekspozimi në kuadër të aseteve dhe detyrimeve, qershor 2014, në përqindje



Sistemi financiar nuk përfshinë BQK-në


Burimi: BQK (2014)

6. Sektori Bankar i Kosovës

Struktura e sektorit bankar vazhdon të dominohet nga bankat me pronësi të huaj, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara, tetë janë me pronësi të huaj të cilat menaxhojnë 90.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit dhe 92.8 përqind të gjithsej kapitalit. Bankat me origjinë nga Gjermania dhe Austria vazhdojnë të zotërojnë pjesën më të madhe të aseteve të sektorit bankar (51.3 përqind së bashku). Sllovenia vazhdon të përfaqësohet me një bankë, e cila mbetet banka e tretë në treg me pjesëmarrje prej 15.9 përqind në gjithsej asete. Turqia përfaqësohet nga tri banka, të cilat gjatë tri viteve të fundit zgjeruan pjesëmarrjen, duke arritur në 13.8 përqind në qershor 2014. Dy bankat vendore në qershor 2014 kishin një pjesëmarrje prej 9.5 përqind në gjithsej asetet e sektorit bankar, që krahasuar me vitin e kaluar paraqet rënie për 1.3 pikë përqindje. Shqipëria dhe Serbia vijojnë të përfaqësohen me nga një bankë, të cilat kanë përfaqësimin më të ulët në treg, me gjithë se u zgjeruan në krahasim me vitin paraprak (figura 23).


Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin bankar ka vazhduar të zvogëlohet edhe gjatë gjashtëmuajorit të parë 2014. Pjesëmarrja e aseteve të tri bankave më të mëdha, në qershor 2014, ka zbritur në 67.2 përqind krahasuar me 67.8 përqind në vitin paraprak. Rënia e shkallës së koncentrimit shprehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), trendi i të cilit tregon për një rënie të vazhdueshme të koncentrimit të aseteve, kredive dhe depozitave (figura 24). Rënia e shkallës së koncentrimit, ndër tjerash, reflekton rritjen më të shpejtë të aseteve, stokut të kredive dhe nivelit të depozitave në bankat më të vogla krahasuar me bankat më të mëdha. Asetet e tri bankave më të mëdha në qershor 2014 shënuan rritje vjetore prej 9.4 përqind, krahasuar me rritjen prej 12.1 përqind të aseteve të bankave tjera. Në kredi, tri bankat më të mëdha kishin rritje vjetore prej 1.2 përqind, kurse bankat tjera shënuan rritje vjetore prej 8.8 përqind. Ndërsa, depozitat e tri bankave më të mëdha shënuan rritje vjetore prej 10.2 përqind, krahasuar me rritjen prej 9.8 përqind të bankave tjera.

Figura 23. Struktura e aseteve të bankave komerciale



Burimi: BQK (2014)

Figura 24. HHI për asete, kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2014)


6.1. Aktiviteti i Sektorit Bankar

6.1.1. Asetet

Vlera e asetëve të sektorit bankar të Kosovës në qershor 2014 arriti në 3.06 miliardë euro, rritje vjetore prej 9.8 përqind, e cila paraqet rimëkëmbje të trendit të rritjes në krahasim me vitet paraprake (figura 25). Në kuadër të gjithsej asetëve, rritjen më të theksuar e shënuan investimet në letra me vlerë dhe bilanci me bankat komerciale, përderisa edhe kreditë përshpejtuan trendin e rritjes gjatë kësaj periudhe.


Në kuadër të strukturës së gjithsej asetëve të bankave komerciale në Kosovë, kategoria e bilancit me bankat komerciale, që paraqet depozitat e mbajtura në bankat jashtë vendit, arriti vlerën 318.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 22.0 përqind (figura 26). Kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në shënoi rritje vjetore prej 0.8 përqind në qershor 2014, duke arritur vlerën në 358.2 milionë euro (tabela 4). Në kuadër të kësaj kategorie, rezervat e bankave komerciale në BQK u zvogëluan për 4.4 përqind, gjë që mund të jetë indikator se bankat kanë filluar të zhvendosin tepërcën e fondeve të mbajtura në BQK drejt investimeve që sjellin fitime.

Figura 25. Struktura e asetëve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2014)

Figura 26. Rritja vjetore e asetëve të sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Tabela 4. Struktura e asetëve të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2011		Qershor 2012		Qershor 2013		Qershor 2014	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	265.3	10.6%	298.4	11.3%	355.4	12.8%	358.2	11.7%
Bilanci me bankat komerciale	319.5	12.8%	265.3	10.0%	261.4	9.4%	318.7	10.4%
Letrat me vlerë	205.6	8.2%	215.6	8.1%	246.3	8.8%	405.3	13.2%
Kreditë bruto	1,624.9	65.0%	1,776.3	67.0%	1,825.7	65.5%	1,889.9	61.8%
Asetet fikse	45.0	1.8%	49.9	1.9%	57.6	2.1%	55.2	1.8%
Asetet tjera	40.7	1.6%	46.9	1.7%	40.5	1.4%	32.2	1.1%
Gjithsej	2,501.0	100%	2,652.3	100%	2,787.0	100%	3,059.5	100%

Burimi: BQK (2014)

Vlera e gjithsej investimeve në letra me vlerë, në qershor 2014, arriti në 405.3 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 64.5 përqind. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e letrave me vlerë në gjithsej asetet e sektorit bankar arriti në 13.2 përqind nga 8.8 përqind sa ishte në qershor 2013. Në kuadër të gjithsej investimeve në letra me vlerë, investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës arritën vlerën prej 166.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 67.7 përqind. Rritja ishte nxitur kryesisht nga normat e interesit në këto investime, të cilat krahasuar me

vendet tjera ishin më të larta, afati i shkurtër i maturimit të tyre (rreth 76.1 përqind të tyre kishin maturim prej gjashtë muaj deri në 1 vit) si dhe niveli i ulët i rrezikut. Bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës në qershor 2014 përfaqësuan 41.1 përqind të gjithë investimeve të bankave në letra me vlerë (figura 27). Megjithatë, portofoli i letrave me vlerë vazhdon të dominohet nga investimet në letra me vlerë në tregjet e jashtme, vlera e të cilave arriti në 238.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 62.4 përqind. Pjesa më e madhe e investimeve në tregjet e jashtme përbëhet nga fletë-obligacionet e qeverive të huaja, të cilat karakterizohen me shkallë të ulët të rrezikshmërisë. Investimet në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jo-financiare, të cilat zakonisht konsiderohen si instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut, vazhdojnë të kenë pjesëmarrje të ulët në gjithë letrat me vlerë, gjë që tregon se bankat i janë shmangur investimeve me nivel më të lartë të rrezikut.

Aktiviteti kreditues vazhdon të dominojë strukturën e gjithë asetëve të sektorit bankar me pjesëmarrje prej 61.8 përqind, por e cila është më e ulët krahasuar me pjesëmarrjen prej 65.5 përqind që e kishin në qershor 2013. Zvogëlimi i peshës në gjithë asetet ishte kryesisht rezultat


i rritjes më të ngadalshme gjatë kësaj periudhe të aktivitetit kreditues në krahasim me rritjen më të shpejtë të kategorive tjera, me theks të veçantë rritjes së kategorisë së letrave me vlerë.

Kreditë

Pas dy viteve të karakterizuara me rritje të ngadalësuar të kreditimit, gjysma e parë e vitit 2014 tregoi shenjat e para të rikuperimit të aktivitetit kredidhënës në Kosovë. Në qershor 2014, vlera e gjithë kredive arriti në 1.89 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 3.5 përqind, e cila është më e lartë se sa norma vjetore e rritjes prej 2.8 përqind në qershor 2013 (figura 28). Rezultatet e anketës së kreditimit bankar për gjashtëmuorin e parë 2014 tregojnë për lehtësim të standardeve dhe kushteve të kreditimit, përderisa kërkesa për kredi ka qenë përgjithësisht më e ulët. Lehtësimi i standardeve u ndikua nga gjendja e kënaqshme e likuiditetit të sektorit bankar si dhe presionit nga konkurrenca (Kutia 2).


Kreditë për ndërmarrje në qershor 2014 përfaqësuan 67.3 përqind të gjithë kredive me vlerë prej 1.27 miliard, dhe shënuan rritje vjetore prej 2.9 përqind (3.1 përqind në qershor 2013). Në kuadër të kredive të ndërmarrjeve, kreditë për korporatat jo financiare shënuan rritje vjetore prej 2.9 përqind në qershor 2014 (3.2 përqind në qershor 2013). Kreditë për ekonomitë familjare, të cilat përbëjnë 31.4 përqind të gjithë kredive, dhe kishin vlerën prej 593.2 milion shënuan rritje vjetore prej 5.6 përqind, e cila është më e lartë se sa rritja prej 4.4 përqind që ishte shënuar në qershor 2013.

Figura 27. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 28. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve, në pikë përqindje




Burimi: BQK (2014)

Kutia 2. Anketa mbi Kreditimin Bankar

Rezultatet e fundit të Anketës mbi Kreditimin Bankar pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014, krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit paraprak, si dhe pritjet mbi ndryshimet në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014.


Aktiviteti kreditues në vend në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 vlerësohet të jetë rikuperuar, kundrejt trendit negativ të shfaqur në gjashtëmujorin e dytë të vitit paraprak. Rënia e përgjithshme e aktivitetit kreditues në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013 peshoi kryesisht mbi ndërmarrjet, përderisa ekonomitë familjare u karakterizuan me një rritje të dobët të kreditimit. Rënia e kreditimit në gjysmën e dytë të vitit i'u atribuua ofertës më të shtrënguar kredituese të bankave për ndërmarrjet, por edhe kërkesës më të ulët për kredi nga ndërmarrjet. Megjithatë, gjashtëmujori i parë i vitit 2014 u karakterizua me një kthesë pozitive në aktivitetin kreditues, gjegjësisht me rritje të kreditimit për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Rritja e kreditimit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 është nxitur kryesisht nga ana e ofertës, përderisa kërkesa për kredi ka qenë përgjithësisht më e ulët.

Figura 29. Standardet kreditore për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare



*Që nga viti 2014, anketa realizohet për periudhën gjashtë mujore.
Burimi: BQK (2014)

Figura 30. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare



*Që nga viti 2014, anketa realizohet për periudhën gjashtë mujore.
Burimi: BQK (2014)


Rezultatet e përmbledhura të anketës tregojnë se, në përgjithësi, bankat kanë lehtësuar deri në një masë standardet kreditore për ndërmarrjet (figura 29). Oferta e lehtësuar kredituese në përgjithësi për ndërmarrjet kryesisht i atribuohet lehtësimit të standardeve të kredihënies për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), për kreditë afatgjata dhe kreditë afatshkurtra. Megjithatë, anketa e fundit rikonfirmon qasjen më konservatore të bankave për kreditimin e ndërmarrjeve të mëdha. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2013, standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha janë shtrënguar deri në një masë, qasje kjo e aplikuar nga bankat që nga qershori i vitit 2012 (figura 30). Standardet për kreditë e ekonomive familjare u lehtësuan deri në një masë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013. Standardet kreditore janë lehtësuar për të dy kategoritë, kreditë për blerje të shtëpive dhe kreditë konsumuese. Nëse analizojmë standardet e kredihënies sipas qëllimit të përdorimit, vërehet se bankat vazhdojnë të deklarojnë standarde më të lehtësuara kredituese për kreditë konsumuese krahasuar me kreditë për blerje të shtëpive.

Politika më e lehtësuar e bankave për kreditimin e ndërmarrjeve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, në përgjithësi, është realizuar kryesisht përmes uljes së normave mesatare të interesit për kreditë, ofrimit të kredive me afat më të gjatë maturimi dhe rritjes së shumës së kredisë. Sa i përket NVM-ve, bankat lehtësuan kredihënien kryesisht përmes ofrimit të kredive me afat më të gjatë maturimi, zvogëlimit të ngarkesave tjera përveç normës së interesit dhe rritjes së shumës së kredisë. Ndërkaq, shtrëngimi deri në një masë i standardeve kreditore të ndërmarrjeve të mëdha nga bankat kryesisht është realizuar përmes rritjes së normave mesatare të interesit, veçanërisht për kreditë me rrezikshmëri më të lartë, si dhe kërkesës më të lartë për kolateral. Vlen të theksohet se përkundër standardeve ende të shtrënguara kreditore për ndërmarrjet e mëdha, për dallim nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2013, bankat në Kosovë deklaruan zvogëlim të ngarkesave tjera përveç normës së interesit, ofrim të kredive me afat më të gjatë maturimi dhe rritje të shumës së kredisë për ndërmarrjet e mëdha. Politikat e lehtësuara kredituese për ekonomitë familjare gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 u realizuan kryesisht përmes zvogëlimit të kërkesës për kolateral, zvogëlimit të ngarkesave tjera përveç normës së interesit dhe ofrimit të kredive me afat më të gjatë maturimi.

Faktorët kryesorë që shpjegojnë politikat më të lehtësuara bankare të kreditimit për ndërmarrjet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit paraprak ishin pozita e kënaqshme e likuiditetit të bankave komerciale dhe konkurrenca në sistemin financiar si nga bankat tjera ashtu edhe nga institucionet mikrofinanciare. Megjithatë, faktorët si pritjet e bankave në lidhje me aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, problemet specifike të sektorit ku zhvillojnë aktivitetin ndërmarrjet, rreziku nga mosrealizimi i kolateralit dhe kostot lidhur me pozitën e kapitalizimit të bankës vazhduan të ndikojnë negativisht kreditimin bankar për ndërmarrjet. Sa i përket ekonomive familjare, politikat kredituese gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 u ndikuan pozitivisht nga konkurrenca në tregun kreditor në vend, zvogëlimi i rrezikut nga mosrealizimi i kolateralit si dhe zhvillimet pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme.


Rezultatet e anketës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 tregojnë se, në përgjithësi, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet ka rënë deri në një masë (figura 30). Kërkesa për kredi ka qenë më e ulët në gjysmën e parë të vitit 2014 sidomos për kreditë afatgjata, përderisa për të njëjtën periudhë, bankat raportuan kërkesë më të lartë për kreditë me afat më të shkurtër maturimi. Rënia e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet është vlerësuar nga bankat të jetë ndikuar negativisht nga konkurrenca sa i përket kredive nga bankat e tjera. Vlen të theksohet se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, ndërlidhur edhe me kërkesën më të lartë për kredi me maturitet më të shkurtër, ishin financimi i kapitalit punues dhe ristrukturimi i borxhit që ndikoi në rritjen e kërkesës për kredi nga disa kategori të ndërmarrjeve.

Figura 31. Pritjet e bankave mbi standardet kreditore për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare



*Që nga viti 2014, anketa realizohet për periudhën gjashtë mujore.
Burimi: BQK (2014)

Figura 32. Pritjet e bankave mbi kërkesen për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare



*Që nga viti 2014, anketa realizohet për periudhën gjashtë mujore.
Burimi: BQK (2014)

Sa i përket kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit paraprak, bankat potencuan një zvogëlim të kërkesës për kredi për blerje të shtëpive dhe rritje të kërkesës për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera. Kërkesa më e ulët për kredi për blerje të shtëpive kryesisht i atribuohet zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme dhe konkurrencës. Ndërkaq, rritja e shpenzimeve për mallra me qëndrueshmëri më të gjatë, rritja e besueshmërisë së konsumatorëve, oferta më e lehtësuar kredituese përmes normave më të ulëta të interesit si dhe, deri në një masë, rritja e pagave nga sektori publik ndikuan në rritjen e kërkesës për kredi konsumuese dhe kredi tjera nga ekonomitë familjare gjatë gjysmës së parë të vitit 2014.

Lidhur me pritjet e bankave për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, standardet kreditore të aplikuara nga bankat pritet të lehtësohen deri në një masë (për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare), me një theks të veçantë për kreditë për NVM-të dhe kreditë afatshkurtra (figura 31). Për dallim nga gjashtëmujori paraprak, standardet kreditore që do të aplikohen për ndërmarrjet e mëdha priten të lehtësohen deri në një masë në gjysmën e dytë të vitit 2014. Gjithashtu, bankat presin një rritje të kërkesës për kredi gjatë gjashtëmujorit të ardhshëm për ndërmarrjet, veçanërisht për NVM-të dhe kreditë afatgjata. Sa i përket ekonomive familjare, bankat presin lehtësim të standardeve si për kreditë për blerje të shtëpive, ashtu edhe për kreditë konsumuese, ndërkohë që edhe kërkesa për kredi për të dy këto kategori pritet të rritet në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014 (figura 32).


Pjesa e mbetur e kredive përfaqësohet nga kreditë ndaj jo rezidentëve, në valutë jo euro, dhe kreditë ndaj organizatave jo qeveritare. Në qershor 2014, kreditë ndaj jo rezidentëve (kryesisht kredi të lëshuara për ndërmarrjet e huaja) regjistruan rënie vjetore prej 8.9 përqind, duke shënuar vlerën 18.8 milionë euro dhe përfaqësuan 1.0 përqind të gjithsej kredive. Ndërsa, kreditë

në valutën e huaj, deri në qershor 2014, arritën vlerën prej 5.9 milionë euro (0.3 përqind e gjithsej kredive), duke shënuar rënie vjetore prej 14.3 përqind. Vlera e kredive të lëshuara për organizatat jo qeveritare në qershor 2014 arriti në 0.8 milion euro, njëherit duke përfaqësuar edhe kategorinë më të vogël të gjithsej kreditimit bankar.

Kutia 3. Kreditë e reja dhe efekti i tyre në rritje të gjithsej stokut të kredive


Pas dy viteve të njëpasnjëshme të karakterizuara me zvogëlim të kredive të reja, gjysma e parë e vitit 2014 u karakterizua me rritje të theksuar të kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar. Në periudhën janar-qershor 2014, sektori bankar lëshoi kredi të reja në vlerën prej 512.2 milionë euro, e cila është për 39.4 përqind më e lartë se sa vlera e kredive të reja të lëshuara gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak (figura 33).

Figura 33. Rritja vjetore e kredive të reja dhe gjithsej kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


Figura 34. Kreditë e reja sipas sektorëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Sa i përket destinimit të kredive të reja, edhe gjatë gjashtëmuorit të parë 2014, dominuan kreditë për ndërmarrje, të cilat përfaqësuan 65.0 përqind të gjithsej kredive të reja (58.9 përqind në qershor 2013). Ndërsa, kreditë e destinuar për ekonomitë familjare përfaqësuan 35.0 përqind të gjithsej kredive të reja (41.1 përqind në qershor 2013) (figura 34). Kreditë e reja të destinuar për ndërmarrje shënuan rritje vjetore prej 53.9 përqind, ndërsa ato për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 18.7 përqind (figura 35).

Figura 35. Rritja vjetore e kredive të reja, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 36. Kategoritë kryesore të kredive të reja, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


Struktura e kredive të reja të ndërmarrjeve përbëhet nga kreditë investuese, jo-investuese si dhe ato me kushte favorizuese. Kreditë investuese vazhdojnë të dominojnë me pjesëmarrje prej 63.6 përqind ndaj gjithsej kredive të reja të ndërmarrjeve (53.0 përqind në qershor 2013). Kreditë jo-investuese dhe ato me kushte favorizuese deri në qershor 2014, kanë zvogëluar pjesëmarrjen ndaj gjithsej kredive të reja të ndërmarrjeve në 27.8 përqind përkatësisht 8.7 përqind (figura 36).

Kurse, struktura e kredive të reja për ekonomitë familjare përbëhet nga kreditë konsumuese, hipotekare dhe ato me kushte favorizuese. Kreditë konsumuese kishin pjesëmarrje prej 76.3 përqind ndaj gjithsej kredive të reja të ekonomive familjare, dhe u karakterizuan me një rritje të pjesëmarrjes nga viti paraprak (71.4 përqind në qershor 2013). Ngjashëm me kreditë konsumuese, rritje në pjesëmarrje në kreditë e reja për ekonomi familjare shënuan edhe kreditë hipotekare që arritën pjesëmarrje prej 12.9 përqind në qershor

2014. Ndërsa, kreditë me kushte favorizuese për ekonomitë familjare u karakterizuan me zvogëlim të pjesëmarrjes ndaj kredive të reja për ekonomi familjare, të cilat deri në qershor 2014 përfaqësuan 7.6 përqind.

Me qëllim që të identifikohet efekti i kredive të reja, kredive të kthyera si dhe kredive të shlyera (angl. write-offs) në rritjen e gjithsej kredive aktive, në figurën 5 janë analizuar trendet e zhvillimit të këtyre tri kategorive. Këto tri kategori kanë ndikim në ndryshimin e vlerës së gjithsej kredive aktive, ku kreditë e reja ndikojnë në rritjen e kësaj vlere, ndërsa kthimi i kredive si dhe kreditë e shlyera kanë efekt zvogëluës në vlerën e gjithsej kredive aktive. Andaj, diferenca në mes të vlerës së kredive të reja gjatë një periudhe si dhe vlerës së kredive të kthyera dhe atyre të shlyera paraqet neto efektin në gjithsej kreditë aktive.

Figura 37. Kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyer, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Në figurën 37 vërehet se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014, kreditë e reja shënuan rritje të theksuar krahasuar me rënien gjatë periudhës së njëjtë të dy viteve paraprake. Me rritje vjetore u karakterizuan gjithashtu edhe kreditë e kthyera dhe ato të shlyera. Në qershor 2014, norma vjetore e rritjes së kredive të kthyera ishte 41.8 përqind (44.4 përqind në qershor 2013), ndërsa kreditë e shlyera shënuan rritje vjetore prej 5.4 përqind (-11.9 përqind në qershor 2013).

Në qershor 2014, raporti i shumës së kredive të kthyera dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja ishte 87.5 përqind krahasuar me 86.5 përqind në qershor 2013, që nënkupton që përkundër rritjes së lartë të kredive të reja në këtë periudhë, efekti i tyre në rritjen e gjithsej stokut të kredive është më i ulët për shkak të normës më të lartë të kredive të kthyera dhe atyre të shlyera.

Raporti i kredive të shlyera ndaj gjithsej kredive të reja u zvogëluar në 1.5 përqind nga 2.0 përqind në qershor 2013, kurse raporti ndërmjet kredive të kthyera ndaj gjithsej kredive të reja u rrit në 86.0 përqind nga 84.6 përqind sa ishte në qershor 2013. Kjo sugjeron që efekti i kredive të shlyera në 'mënjanimin' e rritjes së gjithsej kredive nga rritja e kredive të reja është duke u zvogëluar, ndërsa efekti i maturimit të kredive të lëshuara më herët në 'mënjanimin' e rritjes së stokut të kredive nga rritja e kredive të reja është në rritje.

Edhe nëse analizohen kreditë e reja, të paguara dhe të pakthyer për të dy sektorët ekonomik, atë të ndërmarrjeve dhe të ekonomive familjare, vërehet trend rritës i kredive të kthyera dhe atyre të shlyera, por që është më e theksuar për sektorin e ndërmarrjeve.

Struktura e kredive sipas aktivitetit ekonomik

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Pjesa më e madhe e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë të cilat, në qershor 2014, përbënë 52.2 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet. Kreditë për sektorin e industrisë (minierat, prodhimtarinë, energjetikën dhe ndërtimtarinë) kishin pjesëmarrje prej 23.9 përqind, ndërsa pjesëmarrjen më të ulët vazhdon ta ketë sektori i bujqësisë me 3.6 përqind (figura 38).

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, kreditë për sektorin e prodhimtarisë dhe shërbimeve tjera (hoteliere dhe restorante, patundshmëri dhe qera, etj.) shënuan rritje më të lartë krahasuar me vitin e kaluar, përderisa kreditë për sektorët e energjetikës dhe tregtisë u karakterizuan me ngadalësim të rritjes. Ndërsa, kreditimi për sektorët e ndërtimtarisë, bujqësisë dhe minierave shënoi rënie gjatë kësaj periudhe.

Bankat komerciale në vend gjatë gjashtëmujorit të parë të viti 2014 kanë rritur përkrahjen për sektorin e industrisë dhe veçanërisht për prodhimtarinë. Kreditë për sektorin e prodhimtarisë kanë shënuar rritje vjetore prej 16.9 përqind në qershor 2014, për dallim nga viti paraprak kur këto kredi kishin shënuar rënie prej 5.1 përqind. Kreditë për sektorin e energjetikës dhe të shërbimeve tjera shënuan rritje vjetore prej 12.7 përqind përkatësisht 8.8 përqind në qershor 2014. Kreditë për sektorin e tregtisë kanë shënuar rritje vjetore prej 1.0 përqind në qershor 2014 (figura 39). Kreditimi për sektorin e ndërtimtarisë, ngjashëm me vitin e kaluar, u karakterizua me rënie. Vlera e kredive të lëshuara për këtë sektor shënoi rënie vjetore prej 10.3 përqind në qershor 2014. Me rënie u karakterizuan edhe kreditë për sektorin e bujqësisë dhe të minierave. Kreditë për sektorin e bujqësisë shënuan rënie vjetore prej 5.6 përqind në qershor 2014 (rritje prej 11.9 përqind në qershor 2013), ndërsa kreditë për sektorin e minierave shënuan rënie vjetore prej 4.8 përqind (rritje prej 23.2 përqind në qershor 2013). Rënia e kreditimit për sektorin e bujqësisë mund të jetë edhe si rezultat i përfundimit të pjesës më të madhe të projektit të USAID-it për garantimin e kredive për sektorin e bujqësisë. Kjo tregon se bankat vazhdojnë të hezitojnë zgjerimin e kreditimit për sektorin e bujqësisë dhe se paraqitja e skemave të ngjashme të garantimit të kredive mund të jetë e nevojshme për të zvogëluar ekspozimin e bankave ndaj rrezikut që rrjedhë nga kreditimi i këtij sektori, por edhe për të mundësuar zvogëlimin e normës së interesit në kreditë për këtë sektor. Normat e interesit në kreditë për bujqësi vazhdojnë të jenë mjaft të larta në krahasim me kreditë për sektorët tjerë dhe, si të tilla, dekurajojnë kërkesën për kredi nga ky sektor.

Struktura kredive sipas afatit të maturimit

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit vazhdon të mbetet e ngjashme me periudhat paraprake (figura 40). Pjesa më e madhe e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë me afat më të gjatë maturimi, Kreditë me afat

Figura 38. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje




Figura 39. Ndryshimi vjetor në kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje





Figura 40. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



maturimi 'mbi 2 vite' në qershor 2014 përfaqësuan 67.6 përqind të gjithsej kredive (68.0 përqind në qershor 2013).

Kreditë me afat të mesëm maturimi ('1 deri në 2 vite') vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të ulët në kuadër të kredive, duke u përfaqësuar me 7.3 përqind në qershor 2014 (7.8 përqind në qershor 2013). Ndërsa, kreditë me afat më të shkurtër maturimi ('deri në 1 vit') shënuan zgjerim të lehtë në pjesëmarrje, duke përfaqësuar 25.1 përqind të gjithsej kredive në qershor 2014 (24.2 përqind në qershor 2013).

Sipas afatit të maturimit, normën më të lartë të rritjes e shënuan kredive me maturitet 'deri në 1 vit', vlera e të cilave shënoi rritje vjetore prej 7.2 përqind (figura 41). Kreditë me afat maturimi 'mbi 2 vite' u rritën më ngadal krahasuar me kreditë me afat maturimi 'deri në 1 vit', por përshpejtuan trendin e rritjes në krahasim me vitin paraprak duke u rritur për 3.1 përqind. Kurse, kreditë me maturim 'nga 1 deri në 2 vite' shënuan rënie vjetore prej 3.0 përqind.


Rritja e kredimit afatshkurtër është shprehur si te kreditë për ndërmarrje ashtu edhe te kreditë për ekonomi familjare. Në kuadër të kredive për ndërmarrje, rritja e kreditimit afatshkurtër është më e theksuar për sektorët e prodhimit, shërbimeve tjera dhe tregtisë. Një faktor që mund të ketë ndikuar në rritjen e kreditimit afatshkurtër mund të jetë zvogëlimi më i theksuar i normave të interesit për kreditë afatshkurtra, krahasuar me ato afatgjata për sektorin e ndërmarrjeve. Megjithatë, kreditë e sektorit të ndërmarrjeve vazhdojnë të kenë kryesisht maturim afatgjatë, që është më i theksuar te sektori i bujqësisë, shërbimeve tjera dhe prodhimit (figura 42).

6.1.2. Detyrimet

Struktura e detyrimeve e sektorit bankar të Kosovës vazhdoi të dominohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale. Mbështetja e lartë në depozitat vendore si burim financimi ka bërë që bankat të përfitojnë nga një burim më i qëndrueshëm i financimit dhe të evitojnë ekspozimin ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme. Në qershor 2014, depozitat përfaqësuan 79.1 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar (tabela 5).


Burim tjetër i financimit për bankat komerciale në vend janë mjetet vetanake, të cilat përfaqësojnë 9.5 përqind të gjithsej detyrimeve. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vlera e mjeteve vetanake shënoi rritje vjetore prej 6.2 përqind. Në kuadër të detyrimeve, rritje më të theksuar shënuan borxhi i ndërruar (angl. subordinated debt) dhe bilanci nga bankat tjera, të cilat u rritën për 57.8 përkatësisht 47.8 përqind. Rritja e theksuar e

Figura 41. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 42. Struktura e maturimit të kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

borxhit të ndërvarur ka ndodhur gjatë periudhës qershor-korrik 2013, duke vazhduar me trend të ngadalësuar të rritjes gjatë muajve në vijim.

Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2011		Qershor 2012		Qershor 2013		Qershor 2014	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	74.3	3.0%	21.3	0.8%	20.2	0.7%	29.9	1.0%
Depozitat	1,957.8	78.3%	2,108.5	79.5%	2,201.3	79.0%	2,421.0	79.1%
Huatë tjera	12.3	0.5%	26.8	1.0%	14.8	0.5%	17.9	0.6%
Detyrimet tjera	183.2	7.3%	208.9	7.9%	241.3	8.7%	243.4	8.0%
Borxhi i ndërvarur	33.5	1.3%	31.0	1.2%	36.3	1.3%	57.3	1.9%
Mjetet vetanake	239.9	9.6%	255.8	9.6%	272.9	9.8%	289.9	9.5%
Gjithsej detyrimet	2,501.0	100%	2,652.3	100%	2,787.0	100%	3,059.5	100%

Burimi: BQK (2014)


Rritja e borxhit të ndërvarur i atribuohet kryesisht nevojës së bankave për të siguruar kapitalin e mjaftueshëm për të qenë në pajtueshmëri me ndryshimin e rregullores së BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Depozitat

Në qershor 2014, vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës arriti në 2.42 miliardë euro, rritje vjetore prej 10 përqind që është dukshëm më e lartë krahasuar me dy vitet paraprake. Përshpejtimi i rritjes së depozitave në sektorin bankar ka ndodhur përkundër rënies së theksuar të normës së interesit në depozita gjatë kësaj periudhe, gjë që flet për një stabilitet të lartë të depozitave në sektorin bankar të Kosovës. Depozitat e ekonomive familjare, të cilat konsiderohen të jenë më stabile në raport me burimet tjera të financimit, vazhdojnë ta dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar duke përfaqësuar 74.2 përqind të gjithsej depozitave (figura 43). Vlera e depozitave të ekonomive familjare, deri në qershor 2014, arriti në 1.79 miliardë euro dhe shënoi rritje vjetore prej 9.1 përqind, duke paraqitur kështu kontribuuesin kryesor në rritjen e gjithsej depozitave. Depozitat e ndërmarrjeve përbëjnë 20.8 përqind të gjithsej depozitave, me një vlerë të përgjithshme prej 502.7 milionë euro (rritje vjetore prej 11.9 përqind).


Në kuadër të depozitave të ndërmarrjeve, pjesa më e madhe përfaqësohet nga depozitat e korporatave jo-financiare (ndërmarrjet private), të cilat përbëjnë 64.4 përqind të gjithsej depozitave të ndërmarrjeve (figura 44). Krahasuar me vitin paraprak, vlera e depozitave të

Figura 43. Struktura e depozitave dhe rritja vjetore, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 44. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

korporatave jo-financiare shënoi rritje vjetore prej 5.4 përqind. Gjithashtu, vlera e depozitave të korporatave tjera financiare dhe të ndërmarrjeve publike shënoi rritje vjetore prej 41.6 përqind përkatësisht 6.8 përqind. Rritja e depozitave të korporatave tjera financiare në këtë periudhë ishte kryesisht rezultat i rritjes së depozitave të fondeve pensionale dhe kompanive të sigurimit.

Në pjesën e mbetur të gjithsej depozitave përfshihen depozitat e jorezidentëve me pjesëmarrje prej 3.8 përqind (91.4 milionë euro) dhe depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) me pjesëmarrje prej


1.9 përqind në gjithsej depozitat. Depozitat e jorezidentëve, deri në qershor 2014, shënuan rritje vjetore prej 19.7 përqind, që është dukshëm më e lartë krahasuar me vitin paraprak (0.6 përqind) (figura 45). Ndërsa, depozitat tjera u karakterizuan me rritje vjetore prej 2.9 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të qeverive lokale në bankat komerciale.

Sipas afatit të maturimit, struktura e depozitave vazhdoi të dominohet nga depozitat e afatizuara (41.6 përqind të gjithsej depozitave), pasuar nga depozitat e transferueshme (39.6 përqind) dhe depozitat në formë të kursimeve (18.9 përqind). Krahasuar me vitin paraprak, depozitat e afatizuara kanë shënuar rënie të pjesëmarrjes në gjithsej depozitat, ndërsa depozitat e transferueshme dhe ato të kursimit janë karakterizuar me rritje (figura 46). Zvogëlimi i depozitave të afatizuara, në njërin anë dhe, në anën tjetër, rritja e depozitave të transferueshme dhe të kursimeve mund të reflektojë faktin se rënia e theksuar e normës së interesit në depozita gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 mund të ketë dekurajuar afatizimin e depozitave nga depozitorët. Përveç ndryshimeve në strukturën e maturitetit të depozitave, niveli i ulët i normës së interesit mund të jetë shqetësues edhe për atraktivitetin në përgjithësi të depozitave si instrument financiar në sektorin bankar të Kosovës.

Depozitat e afatizuara shënuan rënie vjetore prej 7.4 përqind në qershor 2014. Në kuadër të depozitave të afatizuara, kontribuues kryesor në rënie kanë qenë depozitat e afatizuara të ekonomive familjare të cilat shënuan rënie prej 12.0 përqind (rritje prej 4.9 përqind në qershor 2013). Në anën tjetër, depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve kanë shënuar rritje prej 14.4 përqind (rënie prej 17.7 përqind në qershor 2013) duke bërë kështu që rënia e depozitave të afatizuara të mos jetë edhe më e madhe. Në kuadër të depozitave të afatizuara, vazhdojnë të dominojnë depozitat me afat më të shkurtër maturimi. Deri në qershor 2014, depozitat me afat maturimi 'deri 1 vit' përfaqësuan 59.3 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara (figura 47).


Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, depozitat me afat maturimi '1 deri 2 vite' dhe 'mbi 2 vite' kanë zgjeruar pjesëmarrjen e tyre në strukturën e gjithsej depozitave e afatizuara.

Figura 45. Depozitat e jo-rezidentëve dhe norma e interesit në depozita



Burimi: BQK (2014)

Figura 46. Struktura e depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Kjo mund të ketë rezultuar nga riafatizimi i një pjese të depozitave ‘deri 1 vit’ në depozita me afat maturimi ‘1 deri 2 vite’ dhe ‘mbi 2 vite’. Trendi i zhvendosjes së depozitave me afat më të shkurtër të maturimit drejt atyre me afat më të gjatë të maturimit mund të jetë refleksion i normave të interesit më të larta që bartin depozitat me afat më të gjatë maturimi në krahasim me depozitat me afat më të shkurtër maturimi.


Deri në qershor 2014, depozitat e tansferueshme kanë përsheptuar rritjen duke shënuar një normë vjetore të rritjes prej 28.5 përqind (8.4 përqind në qershor 2013). Në kuadër të tyre, depozitat e ekonomive familjare kanë qenë kontribuues kryesor, duke shënuar rritje vjetore prej 41.7 përqind (12.0 përqind në qershor 2013), përderisa depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) janë karakterizuar me rritje më të ulët prej 1.9 përqind. Përsheptim të rritjes shënuan edhe depozitat në formë të kursimeve, duke regjistruar një normë vjetore të rritjes prej 23.7 përqind (8.0 përqind qershor 2013). Në kuadër të tyre, depozitat e jorezidentëve kanë shënuar rritje të theksuar prej 45.1 përqind, në krahasim me rënien prej 18.9 përqind që pësuan në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

6.1.2. Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi dhe depozita u karakterizuan me trend rënës gjatë gjashtëmuajorit të parë 2014. Norma e interesit në kredi u zvogëluar në 10.6 përqind në qershor 2014 (12.0 përqind në qershor 2013), ndërkaq ajo në depozita u zvogëluar në 0.6 përqind (3.5 përqind në qershor 2013). Rënia e theksuar e normave të interesit në depozita, ndër tjerash, u ndikua nga oferta e kënaqshme e depozitave, përderisa kreditë vazhduan të rriten me normë dukshëm më të ulët se depozitat. Rënia e normës së interesit në depozita u shoqërua me rënie edhe të normës së interesit në kredi, por që nuk ishte aq e theksuar sa zvogëlimi i interesit në depozita. Zvogëlimi i normës së interesit në kredi mund të jetë edhe refleksion i zvogëlimit të kërkesës për kredi sidomos nga ndërmarrjet. Si rrjedhojë e zvogëlimit më të theksuar të normës së interesit në depozita në krahasim me interesin në kredi, dallimi i normës së interesit ndërmjet kredive dhe depozitave është rritur në 10.0 pp në qershor 2014 nga 8.5 pp sa ishte në qershor 2013. Kjo periudhë paraqet herën e parë që nga viti 2011 kur dallimi i normës së interesit ndërmjet kredive dhe depozitave ka shënuar rritje (figura 48).


Në kuadër të normave të interesit për kredi, trendi rënës vërehet si te kreditë për ndërmarrje ashtu dhe te kreditë për ekonomitë familjare. Norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve zbriti në 10.5 përqind në qershor 2014, nga 12.1 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të kredive për ndërmarrje, kreditë investuese u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit, ku norma mesatare për muajin qershor 2014 ishte 11.0 përqind (11.3 përqind në qershor 2013), përderisa kreditë tjera të biznesit kishin normë mesatare

Figura 47. Struktura e depozitave të afatizuara, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 48. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

të interesit prej 11.6 përqind (12.1 përqind në qershor 2013) (figura 49). Sa i përket kredive për ndërmarrje, sipas maturitetit, norma më e lartë e interesit në qershor 2014 u regjistrua te kreditë tjera të biznesit me maturim ‘mbi 1 deri në 5 vite’ (12.2 përqind), ndërsa më e ulëta u shënuar te kreditë investuese me maturim ‘mbi 1 deri 5 vite’ (9.9 përqind).

Norma mesatare e interesit në kreditë për ekonomitë familjare u zvogëlua në 10.8 përqind në qershor 2014 nga 11.9 përqind sa ishte në qershor 2013. Në kuadër të kredive të ekonomive familjare, norma e interesit për kreditë konsumuese ishte 10.9 përqind në qershor 2014 (12.2 përqind në qershor 2013), ndërsa norma mesatare e kredive hipotekare qëndroi në 9.5 përqind (11.5 përqind në qershor 2013) (figura 50). Tek kreditë hipotekare, me ulje më të theksuar të normave të interesit u karakterizuan kreditë me maturim ‘deri në 5 vite’ (9.8 përqind në qershor 2014 nga 13.6 përqind në qershor 2013) dhe ato me maturim ‘mbi 5 deri në 10 vite’ (9.5 përqind në qershor 2014 nga 11.2 përqind në qershor 2013), përderisa kreditë me maturim ‘mbi 10 vite’ kishin normën më të ulët të interesit prej 9.1 përqind në qershor 2014 (9.8 në qershor 2013).


Sa i përket sektorëve ekonomik, sektori i bujqësisë vijon të karakterizohet me normën më të lartë të interesit në kredi, ku norma mesatare në qershor 2014 qëndroi në 14.2 përqind. Megjithatë, krahasuar me qershor 2013, kur norma mesatare e interesit për kreditë e bujqësisë qëndroi në 17.6 përqind, vërehet se ka pasur rënie të konsiderueshme të interesit për këto kredi (figura 51). Pra, përkundër faktit se kreditë për sektorin e bujqësisë vazhdojnë të bartin normat më të larta të interesit, në periudhën e fundit, sektori i bujqësisë ka paraqitur sektorin me zvogëlimin më të theksuar të normës së interesit ë kredi. Norma mesatare e interesit në kredi për sektorin e industrisë në qershor 2014 ishte 11.3 përqind (12.0 përqind në qershor 2013), ndërsa për sektorin e shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë) ishte 10.2 përqind (11.6 përqind në qershor 2013). Norma më e lartë e interesit vazhdon të vërehet te kreditë bujqësore me afat maturimi ‘mbi 5 vite’ (16.5 përqind), ndërsa norma më e ulët ishte tek kreditë për shërbime me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 5 vite’ (10.1 përqind).

Figura 49. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 50. Normat mesatare të interesit në kreditë për ekonomitë familjare, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 51. Normat mesatare të interesit në kredi sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Normat mesatare të interesit në depozita gjithashtu shënuan rënie gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2014 dhe atë kryesisht gjatë periudhës prill-qershor 2014. Normat mesatare të interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëluan në 0.3 përqind në qershor 2014 (3.6 përqind në qershor 2013), ndërsa për depozitat e ekonomive familjare u zvogëluan në 0.6 përqind (3.5 përqind në qershor 2013).

Tek depozitat e ndërmarrjeve, sipas maturitetit, rënie shënuan të gjitha kategoritë. Norma më e lartë e interesit (0.6 përqind), në qershor 2014, u has tek depozitat e ndërmarrjeve me afat maturimi 'mbi 1 muaj deri në 3 muaj' për shumat më pak se 250 mijë euro. Ndërsa, norma më e ulët e interesit në depozitat e ndërmarrjeve ishte (0.01 përqind) për shumat mbi 250 mijë euro me maturim 'deri në 1 muaj'. Tek depozitat e ekonomive familjare, sipas maturitetit, norma më e lartë e interesit në qershor 2014 (1.4 përqind) u regjistrua tek depozitat me afat maturimi 'mbi 2 vite', ndërsa më e ulëta (0.2 përqind) u has tek depozitat me afat maturimi 'mbi 1 muaj deri në 3 muaj'.

Vlen të theksohet se normat e interesit në depozitat e kursimeve si për ekonomitë familjare ashtu edhe për ndërmarrjet në qershor 2014 kanë shënuar rënie, përderisa vlera e depozitave të kursimit ka vazhduar të rritet. Norma mesatare e interesit në depozitat e kursimit të klientëve në bankat komerciale, në qershor 2014, ishte 0.6 përqind (1.8 përqind në qershor 2013), përderisa vlera e depozitave të kursimit gjatë së njëjtës periudhë shënoi rritje vjetore prej 23.7 përqind.

6.2. Performanca e Sektorit Bankar


Sektorit bankar i Kosovës, në gjysmën e parë të vitit 2014, ka shënuar rritje të theksuar të profitit. Deri në qershor 2014, profiti i sektorit arriti vlerën 26.9 milionë euro, vlerë kjo që është ndjeshëm më e lartë se profiti i gjeneruar gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak që kishte vlerën prej 15.2 milionë euro (figura 52). Rritja e profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe nuk është rezultat i një performace më të mirë të të hyrave, por para se gjithash reflekton zvogëlimin e shpenzimeve, veçanërisht shpenzimeve

për provizione për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë dhe shpenzimeve të interesit në depozita. Si i tillë, niveli aktual i profitit paraqitet mjaft i ndjeshëm ndaj ndonjë përkeqësimi të mundshëm të cilësisë së portofolit kreditor, që nënkupton nevojë për rritje të provizioneve, si dhe rritjes së mundshme të normës së interesit në depozita që mund të vije në rast të përshpejtimit të rritjes së aktivitetit kredidhënës në vend. Andaj, për të siguruar një rritje më të qëndrueshme të profitit, nevojitet që bankat të sigurojnë rritje të qëndrueshme të të hyrave si dhe të ndërmarrin masa për zvogëlimin e shpenzimeve operacionale përmes rritjes së efikasitetit.

Të hyrat

Deri në qershor 2014, të hyrat e sektorit bankar arritën vlerën prej 121.6 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.6 përqind. Struktura e të hyrave të sektorit bankar dominohet prej të hyrave nga interesi, të pasuara prej të hyrave nga jo-interesi, dhe të hyrave nga rivlerësimi. Të hyrat nga interesi, që përfshijnë të hyrat nga interesi në kredi, letrat me vlerë, dhe plasmanet me bankat tjera, përfaqësojnë 79.9 përqind të gjithsej të hyrave (figura 53). Deri

Figura 52. Profiti neto, të hyrat dhe shpenzimet, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


në qershor 2014, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 2.0 përqind, duke u bërë kontribuuesi kryesor në rënie e gjithsej të hyrave të sektorit bankar.

Në kuadër të të hyrave nga interesi, kontribut kryesor në rënie patën të hyrat nga interesi në kredi, të cilat përbëjnë 77.0 përqind të gjithsej të hyrave, gjë që tregon se kjo kategori është përcaktues i trendit të të hyrave, duke pasur parasysh se kategoritë tjera kanë peshë më të vogël (figura 54). Deri në qershor 2014, të hyrat nga interesi në kredi shënuan rënie vjetore prej 2.8 përqind, e cila përkon me rënie e normës së interesit në kredi (figura 55).

Të hyrat nga interesi në letra me vlerë, deri në qershor 2014, shënuan rritje vjetore prej 1.3 përqind kryesisht për shkak të rritjes prej 64.5 përqind të vlerës të investimeve në këtë kategori. Vlen të theksohet se rritja e të hyrave nga interesi në letra me vlerë është më e ulët se sa rritja e vëllimit të investimeve në këtë kategori. Kjo është rrjedhojë e rënies së normave në letrat me vlerë të investuara jashtë vendit duke pasur parasysh se struktura e portfolios së investimeve në letra me vlerë të bankave që operojnë në Kosovë vazhdon të dominohet nga fletëobligacionet e qeverive të huaja. Ndërsa, bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat përbëjnë një pjesë më të vogël të gjithsej portofolit të letrave me vlerë, shënuan rritje të normës së kthimit. Mesatarja e thjeshtë e normës vjetore të kthimit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, deri në qershor 2014, arriti në 1.3 përqind krahasuar me 1.0 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në rritjen e normës mesatare të kthimit të këtyre instrumenteve ndikim të rëndësishëm ka pasur plasimi në treg i fletëobligacioneve qeveritare me afat maturimi dy vjeçar, të cilat bartin norma më të larta të interesit (mesatarja ishte 2.5 përqind).

Ndryshe nga të hyrat prej interesit, të hyrat nga jo-interesi deri në qershor 2014 shënuan rritje prej 2.5 përqind. Në kuadër të të hyrave nga jo-interesi, kontribuues kryesor në rritje ishin të hyrat nga tarifat dhe komisionet të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 2.4 përqind. Rritja e këtyre të hyrave mund të ketë rezultuar nga rritja e çmimeve për shërbime të caktuara


Figura 53. Struktura e përgjithshme e të hyrave, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


kredi shënuan rënie vjetore prej 2.8 përqind, e cila

Figura 54. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 55. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


bankare, si dhe zgjerimi i përdorimit të shërbimeve bankare të cilat bartin tarifa dhe komisione. Rritja e këtyre të hyrave deri diku mund të reflektojë synimet e bankave për të shtrenjësuar ofrimin e shërbimeve në degët bankare si mënyrë për të nxitur klientët që t'i qasen shërbimeve bankare përmes platformave elektronike, gjë e cila mundëson zvogëlim të shpenzimeve dhe rritje të efikasitetit për bankat. Sidoqoftë, rritja e tarifave dhe komisioneve poashtu mund të shihet si veprim i bankave për të kompensuar deri diku rënien e të hyrave nga interesi në kredi.

Shpenzimet

Deri në qershor 2014, gjithsej shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën prej 94.7 milionë euro, shumë kjo që është për 12.6 përqind më e ulët se sa shuma e përgjithshme e shpenzimeve të regjistruara gjatë gjashtëmuajorit të parë 2013. Struktura e shpenzimeve dominohet nga shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të pasuara nga shpenzimet e interesit, ato të jo-interesit, dhe shpenzimet për taksat (figura 56). Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative deri në qershor 2014 shënuan rënie vjetore prej 1.0 përqind (figura 57). Në kuadër të tyre shpenzimet e përgjithshme u karakterizuan me rënie prej 2.5 përqind, shpenzimet e personelit shënuan rënie prej 0.8 përqind, kurse shpenzimet tjera nga jo interesi shënuan rritje prej 1.1 përqind.


Shpenzimet e interesit, deri në qershor 2014, shënuan rënie prej 19.2 përqind krahasuar me rritjen prej 4.8 përqind në qershor 2013. Rënia e shpenzimeve të interesit i atribuohet kryesisht shpenzimeve të interesit në depozita, komponentit kryesor të kësaj kategorie që përfaqëson 86 përqind të gjithsej shpenzimeve të interesit. Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rënie vjetore prej 25.1 përqind si rezultat i zvogëlimit të normës së interesit në depozita gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, përderisa vlera e depozitave ka shënuar trend të përsheptuar të rritjes (figura 58). Kategoria e shpenzimeve të jo-interesit u karakterizua me rënien më të theksuar vjetore prej 32.0 përqind dhe, rrjedhimisht, ishte kategoria kryesore që shkaktoi rënien e gjithsej

Figura 56. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 57. Rritja vjetore e shpenzimeve sipas kategorive kryesore, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 58. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

shpenzimeve. Zvogëlimi i këtyre shpenzimeve i atribuohet rënies vjetore prej 43.8 përqind të shpenzimeve të provizioneve për humbje ndaj kredive, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të jo-interesit. Shuma më e ulët e provizioneve të ndara gjatë kësaj periudhe reflekton faktin se shkalla e pëkeqësimit të portofolios së kredive jo-performuese deri në qershor 2014 ishte më e ulët se sa në vitin paraprak (figura 59). Përkundër zvogëlimit të shpenzimeve për provizione, shkalla e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione vazhdon të jetë e kënaqshme duke qëndruar në 116.4 përqind në qershor 2014.


Profitabiliteti dhe efikasiteti

Deri në qershor të vitit 2014, treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar kanë shënuar rritje te theksuar. Kthimi në Mesataren e Aseteve⁴ (angl. Return on Average Assets: ROAA) arriti në 1.8 përqind nga 0.9 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Kthimi në Mesataren e Kapitalit (angl. Return on Average Equity: ROAE) gjithashtu shënoi rritje duke arritur në 19.0 përqind nga 9.4 përqind sa ishte në dhjetor 2013 (figura 60).

Rënia e theksuar e shpenzimeve krahas rënies së lehtë të të hyrave, ka ndikuar në përmirësimin e indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të përgjithshme. Deri në qershor 2014, ky indikator u zvogëlua për 9.8 pikë përqindje duke zbritur në 77.9 përqind (figura 61).


Përmirësimi i efikasitetit të sektorit vërehet edhe në raportin e shpenzimeve operationale ndaj gjithsej asetëve, që në qershor 2014 u zvogëlua për 0.2 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (tabela 6). Margjina neto e interesit⁵ u zvogëlua në 2.8 përqind në qershor 2014, krahasuar me 2.9 përqind në qershor 2013. Zbritja e

Figura 59. Rritja vjetore e provizioneve për humbjet e kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


Figura 60. Treguesit e profitabilitetit



*Për 2014 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën deri në qershor 2014

Burimi: BQK (2014)

Figura 61. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

⁴ Profiti për llogaritjen e ROAA dhe ROAE për qershor 2014 është përvitësuar.

⁵ Margjina neto e interesit paraqet raportin ndërmjet të hyrave neto nga interesi dhe mjeteve mesatare fitimprurëse.

këtij indikatorit reflekton rritjen më të shpejtë aseteve që gjenerojnë interes krahasuar me rritjen e të hyrave neto nga interesi.

Tabela 6. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit bankar, në përqindje

Përshkrimi	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014
Shpenzimet operacionale/gjithsej Asetet	1.8%	1.9%	1.8%	1.6%
Margjina neto e interesit	3.1%	3.2%	2.9%	2.8%

Burimi: BQK (2014)

Në tabelën 7 janë paraqitur disa tregues të kapacitetit të sektorit bankar, zhvillimi i të cilëve gjatë viteve të fundit sugjeron rritje të shfrytëzimit të kapaciteti të sektorit. Kjo shprehet përmes indikatorëve që paraqesin vlerën mestare të aseteve të menaxhuara nga një punëtor bankar si dhe numrin e kredive të lëshuara mesatarisht nga një punëtor bankar. Të dhënat për të dy indikatorët deri në qershor 2014 sugjerojnë rritje të shfrytëzimit të kapacitetit nga sektorit bankar i Kosovës.

Tabela 7. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014
Asetet/nr i punëtorve (në mijëra euro)	684.46	714.34	766.07	877.15
Numri i kredive/nr i punëtorve	92.3	113.4	115.3	130.9
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	4.1	2.8	4.2	7.7
Shpenzime e personelit/nr i punëtorëve	5.5	5.6	5.8	6.0


Burimi: BQK (2014)

Poashtu, sektori bankar ka rritur edhe vlerën mesatare të profitit të realizuar për një punëtor. Në anën tjetër, vërehet që sektori bankar ka rritur vlerën mesatare të shpenzimeve të personelit për një punëtor, që paraqet rritje të kostos së punës për bankat. Lëvizjet në të gjithë këta indikatorë reflektojnë zvogëlimin e numrit të të punësuarve në sektorin bankar në 3,488 të punësuar nga 3,638 sa ishin të punësuar në qershor 2013, përderisa aktiviteti i sektorit ka shënuar rritje. Në rastin e shpenzimeve të personelit, duhet potencuar faktin se vlera e këtyre shpenzimeve ka mbetur në nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

6.3. Rreziqet e Sektorit Bankar

Rreziqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar i Kosovës nuk kanë shënuar ndonjë ndryshim të konsiderueshëm gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Disa nga faktorët e rrezikut kanë shënuar rritje të lehtë, por që në përgjithësi, zhvillimet me ndikim në sektorin bankar kanë shënuar përmirësim duke u reflektuar në ngritje të theksuar të performancës në krahasim me vitin paraprak. Në figurën 62, e cila paraqet indikatorët kryesor të rreziqeve bankare dhe performancës së sektorit, mund të vërehet se ambienti i jashtëm

Figura 62. Harta e rreziqeve të sektorit bankar (në përqindje)



Burimi: BQK (2014)

mund të vërehet se ambienti i jashtëm

makroekonomik ka shënuar përmirësim duke kaluar në normë pozitive të rritjes.⁶ Sa i përket ambientit të brendshëm makroekonomik, pritjet janë që norma e rritjes së PBB-së së Kosovës të jetë lehtësisht nën nivelin e vitit 2013. Sidoqoftë, prospektet për zhvillimet në sektorin bankar janë pozitive. Kërkesa dhe oferta e sektorit bankar për kreditimin e ekonomisë ka shënuar rritje, që është reflektuar në rimëkëmbjen e aktivitetit kreditor gjatë pjesës së parë të vitit. Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës duke ndikuar që të hyrat nga interesi të zvogëlohen përkundër rritjes më të lartë të kredive. Por, sektori shënoi rënie më të theksuar të shpenzimeve të interesit, andaj neto të hyrat nga interesi shënuan rritje krahasuar me qershorin e vitit 2013. Efikasiteti i përgjithshëm i sektorit bankar u përmirësua si rezultat i rënies më të lartë të shpenzimeve të përgjithshme në krahasim me rënien e të hyrave, duke rezultuar në pothuajse dyfishim të fitimit neto dhe, rrjedhimisht, rritje të treguesve të profitabilitetit.

Rritja e fitimit neto mundësoi rritjen e kapitalit të sektorit në gjysmën e parë të vitit. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) shënoi rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit dhe konsolidimit nga ndryshimet rregullative në kalkulimin e kapitalit rregullativ. Pozita e përforcuar e kapitalit sugjeron për qëndrueshmërinë e lartë të sektorit dhe aftësinë e kënaqshme të përballimit të humbjeve potenciale nga rritja e lehtë që karakterizoi rrezikun kreditor, i cili është pasqyruar me normë më të lartë të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive krahasuar me vitin paraprak si dhe me rritje të koncentrimin të rrezikut kreditor krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, norma e rritjes së kredive joperformuese gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 është ngadalësuar dhe në qershor 2014 norma e kredive joperformuese ishte më e ulët krahasuar me fillimin e vitit. Poashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese nga provizionet për humbje nga kreditë mbetet mbi 100 përqind që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme. Pozita e likuiditetit të sistemit bankar është përforcuar edhe më tutje. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra është rritur si dhe rezervat e detyrueshme të bankave komerciale të mbajtura në BQK vazhdojnë të jenë në nivel më të lartë se sa minimumi i kërkuar rregullativ. Sektori bankar i Kosovës poashtu vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut, marrë parasysh faktin se pothuajse të gjitha kreditë dhe depozitat vazhdojnë të bartin norma fikse të interesit si dhe faktin se bilanci i gjendjes së sektorit bankar përmban vetëm një pjesë shumë të vogël të aseteve dhe detyrimeve të denominuara në valuta jo-euro.

6.3.1. Rreziku i likuiditetit

Sektori bankar vazhdoi të ketë pozitë të kënaqshme të likuiditetit gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Indikatorët kryesorë të likuiditetit u përforcuan, duke zvogëluar kështu ekspozimin e sektorit ndaj rrezikut të likuiditetit. Depozitat, të cilat përbëjnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar, shënuan përsheptim të rritjes. Ky model tradicional i sektorit bankar të Kosovës që për burim kryesor të financimit ka depozitat vendore të cilat karakterizohen me kosto më të ulët dhe qëndrueshmëri më të lartë, bënë që sektori të ketë ekspozim të ulët ndaj lëvizjes së kostos së financimit dhe ndryshimeve në ofertën e fondeve me të cilat karakterizohen tregjet e jashtme të financimit afatshkurtër. Gjithashtu, ekspozimi i ulët ndaj bankave amë bëjnë që sektori të jetë relativisht i mbrojtur nga rreziku i mundshëm i tkurrjes së huazimit nga bankat amë në vazhden e presioneve të bankave të eurozonës për ristrukturim apo zvogëlim të ekspozimeve ndërkuftare.

Raporti i kredive ndaj depozitave zbriti në 78.1 përqind në qershor 2014 krahasuar me 83 përqind një vit më parë (figura 63). Siç vërehet edhe në figurën 62, raporti ndërmjet kredive dhe depozitave në vazhdimësi është karakterizuar me efekte sezonaliteti. Gjysma e parë e vitit karakterizohet me rritje të këtij raporti, i cili arrin maksimumin në mes të vitit, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit ka rënie graduale të këtij raporti i cili arrin minimumin në tremujorin e fundit.

⁶ Norma e rritjes vjetore së PBB-së së Kosovës për vitin 2014 është vlerësim i BQK-së, ndërsa norma e rritjes vjetore të PBB-së së Eurozonës është parashikim i FMN-së.


Sezonaliteti është më i theksuar te depozitat, të cilat pothuajse gjithmonë tentojnë të bien në tremujorin e dytë të vitit. Por kreditimi gjithashtu tregon efekte sezonaliteti, me tendencë rritjeje më të theksuar në tremujorin e dytë. Arsyeja e sezonalitetit në kredi dhe depozita mund të jetë rritja e kërkesës për shpenzime në ekonomi në tremujorin e dytë të vitit.

Kreditë e reja kanë vlerën më të lartë në këtë periudhë, që sugjeron për rritje të kërkesës për shpenzime në ekonomi. Në këtë situatë të shpenzimeve më të larta, mjetet e disponueshme për kursim janë më të ulëta andaj edhe depozitat tentojnë të bien.

Përkundër efektit të sezonalitetit, norma më e lartë e rritjes së depozitave në krahasim me kreditë në dy vitet e fundit ka ndikuar që raporti kredi/depozita të zbresë në nivel më të ulët se mesatarja historike prej afër 80 përqind, gjë që tregon për nivelin e lartë të likuiditetit në sektor, që njëherit paraqet hapësirë për rritje të mëtejme të kreditimit pa e kërcënuar pozicionin e likuiditetit të sektorit bankar.


Pozita e favorshme e likuiditetit, që tregon aftësinë e sektorit bankar për shlyerjen e detyrimeve afatshkurtra, dëshmohet edhe nga niveli i lartë i treguesve kyç të likuiditetit. Raporti i mjeteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtëra shënoi ngritje gjatë vitit 2014, duke arritur në 43.7 përqind nga 38.5 përqind në vitin paraprak (figura 64).⁷ Rritja e raportit të likuiditetit i atribuohet rritjes më të theksuar të mjeteve likuide krahasuar me detyrimet afatshkurtëra. Në qershor 2014, mjetet likuide shënuan rritje vjetore prej 25.9 përqind, ndërsa detyrimet afatshkurtëra u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.9 përqind. Në kuadër të mjeteve likuide, kontributin më të madh në rritje e kishin letrat me vlerë të tregtueshme të qeverive dhe bankave qendrore, të pasuara nga bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet tjera. Sa i

Figura 63. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Figura 64. Raporti mjete likuide 'gjithëpërfshirëse' / detyrime afatshkurtëra



Burimi: BQK (2014)

Figura 65. Rezervat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

⁷ Me rregullore të BQK-së kërkohet që niveli minimal i raportit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të jetë 25 përqind.

përket detyrimeve afatshkurtra, kontributin kryesor në rritje e kishin depozitat e transferueshme.


Rezervat e detyrueshme të sektorit bankar kanë shënuar rënie në gjysmën e parë të vitit 2014. Sidoqoftë, ato vazhdojnë të qëndrojnë në nivel mjaft më të lartë se kërkesat rregullative. Në qershor 2014, rezerva shënoi vlerën 215 milionë euro, që tejkalon minimumin e rezervës së kërkuar për 37 përqind (figura 65). Mbajtja e rezervave në nivel të lartë mund të konsiderohet si pozitive ngase zvogëlon ekspozimin e sektorit ndaj zhvillimeve me rrezik potencial për likuiditetin e sektorit. Megjithatë, mbajtja e rezervave mbi nivelin e obliguar paraqet kosto oportune për bankat të cilat nuk arkëtojnë interes për këto mjete, gjë që gjithashtu mund të reflektohet në rritjen e kostos së shërbimeve bankare. Andaj, tendenca rënëse e rezervave të tepërta në gjysmën e parë të vitit mund të konsiderohet pozitive ngase sugjeron për menaxhim më të mirë të mjeteve likuide në kuptim të minimizimit të kostos oportune si dhe në aspekt të vënies së mjeteve likuide në funksion të aktiviteteve me potencial zhvillimor ekonomik.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, sektori bankar i Kosovës është karakterizuar me rritje të 'rrezikut strukturor të likuiditetit', që manifestohet përmes rritjes së mospërputhjes së afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve të intervalit të njëjtë të maturitetit (figura 66).⁸ Hendeku i likuiditetit është rritur për pothuajse të gjitha kategoritë. Rritja më e theksuar është shënuar në kategorinë '1-7 ditë', gjë që ka ndikuar në rritjen e hendekut negativ të likuiditetit për periudhën 'deri në 3 muaj' nga -466.5 milionë euro në qershor 2013 në -558 milionë euro në qershor 2014. Sidoqoftë, hendeku kumulativ për periudhën 'deri në 1 vit' nuk ka shënuar rritje; por, përkundrazi, është ngushtuar lehtësisht në -370.6 milionë euro nga -388 milionë euro në vitin paraprak, dhe atë kryesisht si pasojë e rritjes së hendekut pozitiv për kategorinë e maturitetit '181-365 ditë'.

Në vitin 2014, asetet e të gjitha kategorive të maturimit kanë shënuar rritje. Asetet me maturitetit '1-7 ditë' shënuan rritjen më të lartë vjetore prej 162.8 milionë euro, duke dhënë kështu kontributin kryesor në rritjen e gjithsej aseteve. Në kuadër të kësaj kategorie të maturitetit, rritja më e lartë u shënuar në letrat me vlerë dhe kërkesat ndaj bankës amë. Ndërsa, kategoria e aseteve me maturim prej 'më shumë se 1 vit' u rritë për vetëm 36.1 milionë euro. Në anën e detyrimeve gjithashtu, rritja më e lartë vjetore u shënuar për kategorinë me afat maturiteti prej '1-7 ditë', të cilat rritën vlerën për 287.6 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave pa interes. Ndërsa, detyrimet me afat maturimi 'më shumë se 1 vit' shënuan rritje prej 53.5 milionë euro, që rezultoi kryesisht nga rritja e borxhit të ndërvarur dhe ekuitetit.

Gjatë kësaj periudhe, rritja e hendekut të likuiditetit, sidomos për kategorinë me maturitet më të shkurtër (deri në 3 muaj), është ndikuar në masë të madhe nga rritja më e theksuar e depozitave të sektorit, por edhe nga zhvendosja e një pjese të depozitave me interes nga kategoritë e maturimit më të gjatë drejt atyre me afat maturimi të shkurtër. Një zhvendosje e tillë mund të ketë ndodhur si rezultat i rënies së normës së interesit në depozita, gjë që e zvogëlon atraktivitetin e afatizimit të depozitave. Andaj, është e rëndësishme të theksohet që sektori të

Figura 66. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


⁸ Hendeku negativ nënkupton që asetet për intervalin e caktuar të maturitetit tejkalojnë detyrimet dhe anasjelltas.

bëjë përpjekje të vazhdueshme drejt zgjatjes së maturitetit të depozitave, ngase një zhvillim i tillë do të ngushtonte hendekun negativ në intervalet me maturitet të shkurtër dhe njëkohësisht do të mundësonte rritje të kreditimit me afat më të gjatë të maturimit, zhvillim ky mjaft i dëshirueshëm për përmirësimin e kushteve të financimit të investimeve.

6.3.2. Rreziku kreditor


Rreziku kreditor është ndër rreziqet kryesore ndaj të cilit ekspozohet sektori bankar i Kosovës. Krahasuar me një vit më parë, rreziku kreditor ka shënuar rritje, ku në qershor 2014 raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive arriti në 8.2 përqind nga 7.8 përqind në qershor 2013 (figura 67). Sidoqoftë, trendi rritës i normës së NPL-ve që karakterizoi gjysmën e dytë të vitit 2013 si dhe muajt e parë të vitit 2014 (në shkurt 2014 raporti i NPL-ve ishte 8.8 përqind) është ngadalësuar. Rënia e normës së NPL-ve krahasuar me fillimin e vitit 2014 i atribuohet përmirësimit të cilësisë së portofolios kreditore (që reflektohet nga norma më e ngadalshme e rritjes vjetore të vlerës së NPL-ve) si dhe rritjes më të shpejtë të stokut të kredive në vitin 2014 (figura 68). Në nivel të bankave individuale, katër prej tyre shënuan ngadalësim të normës së NPL-ve krahasuar me fundin e vitit 2013, ndërsa të tjerat shënuan ngritje të lehtë. Sektori më i ekspozuar ndaj rrezikut kreditor vazhdoi të jetë sektori i ndërmarrjeve, në kuadër të të cilit energjia dhe prodhimtaria shënuan normën më të lartë të NPL-ve (figura 69). Sektori i energjisë shënoi përkeqësim të normës së NPL-ve e cila arriti në 14.8 përqind në qershor 2014 nga 11.5 përqind një vit më parë. Ndërsa, sektori i prodhimitarisë ka shënuar përmirësim të portofolit kreditor, ku norma e NPL-ve ka zbritur në 12.2 përqind krahasuar me normën 15.7 përqind në vitin paraprak. Sektori i tregtisë, i cili dominon strukturën e kredive për ndërmarrje, shënoi normë të NPL-ve prej 11.5 përqind krahasuar me 10.3 përqind një vit më parë. Përkeqësim të konsiderueshëm të portofolit kreditor shënoi sektori i agrikulturës, norma e NPL-ve e të cilit pothuajse u trefishua duke arritur në 9.7 përqind nga 3.5 përqind në qershor 2013. Sektori i

Figura 67. Raporti NPL/gjithsej kreditë, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 68. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve



Burimi: BQK (2014)

Figura 69. NPL-të sipas sektorëve



Burimi: BQK (2014)

ekonomive familjare vazhdon të mbetet me ekspozimin më të ulët ndaj rrezikut kreditor, me normë të NPL-ve prej 2.8 përqind (2.5 përqind në qershor 2013).

Rritja e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor është shfaqur edhe përmes migrimit gradual të kredive nga kategoritë me cilësi më të mirë drejt atyre me cilësi më të dobët (figura 70). Kreditë 'standard' zvogëluan pjesëmarrjen për 2.0pp, ndërsa në anën tjetër, kreditë 'nënstandard' rritën pjesëmarrjen për 0.9pp. Kreditë e 'dyshimta' zvogëluan pjesëmarrjen për 0.5pp, ndërsa kreditë e 'humbura' rritën pjesëmarrjen për 0.9pp.

Tendenca e migrimit gradual të kredive drejt kategorive me klasifikim më të ulët kreditor mund të vërehet edhe në figurën 71.⁹ Kreditë me vonesa kanë rritur gradualisht pjesëmarrjen në gjithsej kreditë, ku në qershor 2014 raporti i tyre ndaj gjithsej kredive ishte 15.2 përqind. Ndërsa, raporti i kredive të klasifikuara (që paraqet kreditë me vonesa mbi 61 ditë ndaj gjithsej kredive) në qershor 2014 u rrit në 12.3 përqind nga 11 përqind në vitin paraprak.

Krahas tendencës së përgjithshme të përkeqësimit të portofolit kreditor, niveli i provizionimit të sektorit ka shënuar rritje. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione është rritur në 116.4 përqind nga 113.2 përqind në qershor 2013 (figura 72). Ndërsa, për

shkak të rritjes më të theksuar të kredive të klasifikuara në krahasim me kreditë joperformuese, raporti i mbulimit me provizione të kredive të klasifikuara ka shënuar rënie të lehtë në 77.8 përqind në qershor 2014 nga 80.1 përqind në qershor 2013.

Duhet theksuar se kreditimi në vitin 2014 është rimëkëmbur, në kuptimin që trendi i rritjes është përsheptuar. Vazhdimi i trendit të zgjerimit të kreditimit mund të ketë ndikim pozitiv në kapacitetin për zgjerim të ndërmarrjeve dhe shlyerjen e kredive ekzistuese, që mund të ketë efekt pozitiv në rënie e

Figura 70. Struktura e kredive sipas klasifikimit




Figura 71. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditore, në përqindje





Figura 72. NPL-të dhe provizionet



⁹ Sipas rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor, klasifikimet kreditore të mësipërme grupohen në tri kategori të ekspozimit të rrezikut kreditor: Kreditë me vonesa, të cilat përfshijnë kategoritë vrojtuese, nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura; Kreditë e klasifikuara që përfshijnë kategoritë nën standarde, të dyshimta dhe të humbura, dhe Kreditë joperformuese që përfshijnë kreditë e dyshimta dhe të humbura.

normës së NPL-ve. Gjithashtu, përmirësimi i ambientit të përgjithshëm ekonomik si dhe standardet më të shtrenguara të kreditimit që bankat kanë raportuar të kenë përdorur në pothuajse tri vitet e fundit pritet të kenë efekt pozitiv në cilësinë e portofolit kreditor. Për më tepër, performanca pozitive e sektorit dhe nivelet e profitit vazhdojnë t'i krijojnë hapësirë sektorit për ndarje të mjaftueshme të provizioneve, duke ngritur kështu aftësinë e sektorit për mbulimin e humbjeve të mundshme nga rreziku kreditor.

Një aspekt tjetër i rrezikut kreditor është edhe shkalla e koncentrimit të ekspozimeve kreditore. Sektori bankar i Kosovës ka vazhduar trendin rritës të koncentrimit të rrezikut kreditor, të matur përmes ekspozimeve të mëdha kreditore në raport me kapitalin e klasit të parë (figura 73). Gjatë vitit 2014, vlera e gjithsej ekspozimeve të mëdha¹⁰ të sektorit arriti në 124.0 përqind të vlerës së kapitalit të klasit të parë¹¹, për dallim prej 91.0 përqind sa ishte në qershor 2013. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga rritja më e lartë e ekspozimeve të mëdha në krahasim me kapitalin e klasit të parë. Vlera e ekspozimeve të mëdha në qershor 2014 arriti në 325.3 milionë euro (rritje vjetore prej 51.4 përqind), ndërsa kapitali bazë rregullativ – kapitali i klasit të parë – shënoi rritje vjetore prej 11.1 përqind, duke arritur në 262.4 milionë.

Gjatë kësaj periudhe, vlera e ekspozimeve të mëdha është rritur dukshëm përderisa numri i ekspozimeve të mëdha mbetet i përafërt me vitin paraprak (64 ekspozime të mëdha në qershor 2014 krahasuar me 59 në qershor 2013). Kjo ka rezultuar në rritjen e vlerës mesatare të ekspozimeve të mëdha në 5.1 milionë nga 4.2 milionë euro në qershor 2013, e që sugjeron për rritje të koncentrimit të rrezikut. Tendanca në rritje e ekspozimeve me vlerë më të lartë nga disa banka, që njëherit janë kontribuuesi kryesor në rritjen e gjithsej vlerës së ekspozimeve të sektorit, mbështetet edhe nga fakti që shumica e tri ekspozimeve më të mëdha të bankave pothuajse u dyfishua, ku në qershor 2014 kjo shumë arriti në 197.3 milionë euro krahasuar me 117.5 milionë euro në qershor 2013.


Rritja e vlerës së ekspozimeve është ndikuar nga bankat më të mëdha, përderisa bankat më të vogla kanë ulur ekspozimin. Raporti i shumës së ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë për disa nga bankat e mëdha tashmë ka tejkaluar bankat më të vogla, të cilat për shkak të bazës më të ulët të kapitalit të klasit të parë, kanë tendencë që të kenë këtë raport në nivel më të lartë.

6.3.3. Rreziku i solvencës

Treguesit e kapitalizimit

Sektori bankar i Kosovës përforcoi pozitën e tij të kapitalizimit gjatë vitit 2014. Në qershor 2014, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR), që paraqet raportin e gjithsej kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara ndaj rrezikut, arriti në 17.4

Figura 73. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2014)

¹⁰ Ekspozim i madh konsiderohet shumica e të gjitha ekspozimeve direkte dhe indirekte ndaj një huamarrësi të vetëm apo grupi të huamarrësve të ndërlidhur vlera e të cilave kalon 10% të vlerës së kapitalit të klasit të parë të bankës përkatëse.

¹¹ Sipas rregullores për ekspozime të mëdha, shumica e të gjitha ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj personit apo grupeve të personave, kur secili nga ekspozimet e tejkalon dhjetë përqind (10%) të kapitalit të klasit të parë të bankës, kufizohet në 300% të kapitalit të klasit të parë.

përqind krahasuar me 16.5 përqind një vit më parë (figura 74).¹² Ngritja e treguesit të kapitalizimit ishte rezultat i normës më të lartë të rritjes vjetore të kapitalit rregullativ, 16.8 përqind, në raport me 10.7 përqind rritje vjetore të Mjeteve të Peshuara ndaj Rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA) (figura 75).


Ndërsa, norma e kapitalit të klasit të parë ndaj mjeteve të peshuara ndaj rrezikut mbeti në nivel pothuajse të njëjtë me vitin paraprak, për shkak se rritja e kapitalit rregullativ në masë më të madhe u ndikua nga shtimi i kapitalit të klasit të dytë. Në qershor 2014, ky tregues (angl. Tier I capital to RWA) ishte 13.5 përqind krahasuar me 13.4 në qershor 2013.

Një indikator tjetër për vlerësimin e nivelit të kapitalizimit është raporti i levës, i cili paraqet nivelin e ekuitetit në raport me gjithsej mjetet. Gjatë vitit 2014, raporti i levës shënoi rënie të lehtë në 10.1 përqind nga 10.5 përqind sa ishte në qershor të vitit paraprak. Rënia rezultoi kryesisht si pasojë që gjithsej mjetet janë rritur më shumë (9.8 përqind rritje vjetore në qershor 2014)

se ekuiteti i sektorit (rritje vjetore prej 6.6 përqind). Raporti aktual i levës tejkalon kërkesën rregullative për raport minimal prej 7 përqind.¹³ Sidoqoftë, niveli aktual është nën nivelin e vendeve të rajonit, të cilat në qershor 2014, në mesatare, kishin raport të levës prej afër 13.5 përqind.¹⁴


Kapitali rregullativ i sektorit bankar, në qershor 2014, arriti vlerën 340.3 milionë euro, duke tejkeluar kërkesën minimale për kapital rregullativ për 106.2 milionë euro. Cilësia e tij ka shënuar trend rënës në vitet e fundit, ku pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë është zvogëluar në mënyrë graduale, ndërsa në anën tjetër, sektori bankar ka rritur financimin e kapitalit rregullativ nga burime të kapitalit të klasit të dytë

Figura 74. Kapitalizimi i sistemit bankar




Burimi: BQK (2014)

Figura 75. Kapitali rregullativ dhe RWA-të



Burimi: BQK (2014)

Figura 76. Struktura e kapitalit rregullativ të sistemit bankar



Burimi: BQK (2014)

¹² Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ në raport me RWA dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA.

¹³ Rregullorja e BQK-së për Mijaftueshmërinë e Kapitalit.

¹⁴ Mesatarja e raportit të levës për rajonin (vendet e Ballkanit Perëndimor, si: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia) të kalkuluara nga BQK nga raportet e bilanceve të gjendjes të vendeve përkatëse, të raportuara në Bankat Qendrore përkatëse.


(figura 76). Në qershor 2014, kapitali i klasit të parë përbënte 77.1 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ. Ky nivel është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat rregullative, por që megjithatë ka hapësirë për përmirësim të mëtejme dhe afrim drejt mesatares së rajonit e cila qëndron në rreth 85 përqind.¹⁵

Rritja e konsiderueshme e profitit të sektorit gjatë vitit 2014 tashmë është reflektuar në rritje të kapitalit të klasit të parë në pjesën e parë të vitit dhe paraqet potencial të rëndësishëm për rritjen e mëtejme të kapitalit të klasit të parë, shtimi i të cilit do të mundësonte që cilësia e kapitalit rregullativ dhe raporti i levës të ngritën dhe afrohen me mesataren e rajonit.

Rritja vjetore e kapitalit të klasit të parë në qershor 2014 ishte 11.1 përqind. Krahas profitit, konsolidimi konform ndryshimeve rregullative të fuqizuara në dhjetor të vitit 2012, që u manifestua me zvogëlimin gradual të ekspozimeve të sektorit ndaj personave të ndërlidhur me bankën, ishte faktori i rëndësishëm në rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë.¹⁶ Gjithashtu, shtimi i kapitali aksionar nga disa banka gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013, por në masë më të madhe në gjysmën e parë të vitit 2014, ndikoi në rritjen e kapitalit të klasit të parë. Në anën tjetër, shpërndarja e dividendës në dhjetor të vitit 2013 si dhe në qershor të vitit 2014 ishte pothuajse faktori i vetëm që zvogëloi kapitalin rregullativ përmes zvogëlimit të profitit të pashpërndarë. Struktura e kapitalit të klasit të parë mbetet e ngjashme me periudhat paraprake, ku kapitali aksionar mbetet kategoria dominuese me pjesëmarrje prej 86.2 përqind (92.5 përqind qershor 2013) (figura 77).


Kapitali i klasit të dytë, në anën tjetër, shënoi rritje vjetore prej 40.8 përqind. Burim i rritjes së kapitalit të klasit të dytë ishte borxhi i ndërvarur, vlera e të cilit pothuajse u dyfishua në raport me vitet paraprake. Në qershor 2014, vlera e tij arriti në 57.3 milionë euro, dhe përfaqësoi 73.6 përqind të kapitalit plotësues (figura 78). Ndërsa pjesa tjetër prej 20.6 milionë euro përbëhet nga provizionet e përgjithshme për kreditë.¹⁷ Për dallim nga vitet e mëhershme, ku bankat, megjithëse në përqindje shumë të vogël, shfrytëzonin instrumentet e borxhit detyrimisht të konvertueshëm në aksione të zakonshme në aksione për plotësim të kapitalit, në dy vitet e fundit këto instrumente nuk gjetën aplikim.

Figura 77. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 78. Struktura e kapitalit të klasit të dytë, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

¹⁵ Mesatarja e raportit të kapitalit të klasit të parë ndaj gjithsej kapitalit rregullativ për vendet e rajonit, e kalkuluar nga të dhënat e raportuara në kuadër të Tregueseve të Shëndetit Financiar të Fondit Monetar Ndërkombëtar –FMN-së si dhe nga publikimet e Bankave Qendrore të vendeve përkatëse

¹⁶ Huazimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën zbriten në përllogaritjen e kapitalit të klasit të parë, andaj zvogëlimi i këtyre ekspozimeve ka ndikuar në rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë. Në kuadër të pozicioneve të reja të cilat zbriten nga përllogaritja e kapitalit të klasit të parë, peshën më të madhe e kanë pikërisht huazimet ndaj personave të ndërlidhur, vlera e të cilave paraqet 8.4 përqind të kapitalit të klasit të parë në qershor 2014 në krahasim me 12.8 përqind në qershor 2013.

¹⁷ Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25% të mjeteve të peshuara ndaj rrezikut.

Mjetet e peshuara ndaj rrezikut


Vlera e mjeteve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Risk-Weighted Assets: RWA) në qershor 2014 arriti në 1.95 miliardë euro nga 1.76 miliardë euro një vit më parë. Rritja e RWA-ve ishte kryesisht rezultat i përfshirjes së rrezikut operacional në përllogaritjen e mjeteve të peshuara ndaj rrezikut, që është bërë me qëllim të ndarjes së rezervës së kapitalit për mbulim të rrezikut operacional.¹⁸ Në qershor 2014, vlera e mjeteve për rrezik operacional ishte 185.8 milionë euro, që njëherit përbënte 9.5 përqind të gjithë RWA-ve.

Mjetet e peshuara me rrezik 100%, të cilat përfshijnë kreditë si dhe zërat jashtë-bilancorë, ishin kategoria e radhës me ndikimin më të lartë në rritjen e gjithë RWA-ve. Vlera e këtyre mjeteve arriti në 1.41 miliardë euro nga 1.38 miliardë në vitin paraprak, mirëpo për shkak të rritjes së konsiderueshme të gjithë RWA-ve pjesëmarrja e këtyre mjeteve në gjithë RWA-të zbriti në 72.5 përqind nga 78.7 përqind në qershor 2013 (figura 79).

Në anën tjetër, mjetet me peshën më të lartë të rrezikshmërisë (150%), të cilat përfshijnë kërkesat direkte me maturitet prej '1 viti apo më pak' dhe të cilat kërkojnë aprovim paraprak nga BQK, por që kanë klasifikim kreditor me rrezik të lartë mos-pagese (nën B- sipas vlerësimeve të Fitch), shënuan rënie. Vlera e tyre në qershor 2014 zbriti në 1.2 milionë euro nga 32.3 milionë euro në vitin paraprak, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithë RWA-të zbriti në 0.1 përqind nga 1.8 përqind.


Kategoritë tjera të RWA-ve nuk pësuan ndonjë ndryshim të theksuar. Ndërsa, nga gjithë mjetet e sektorit¹⁹, vlera e mjeteve të cilat nuk bartin rrezik, apo që peshohen me rrezik 0%, shënoi ngritje në afër 60 përqind të vlerës së RWA-ve nga 52 përqind në qershor 2013. Kjo, së bashku me zvogëlimin e mjeteve të peshës së rrezikut 150 përqind, mund të sugjerojë për prirje të zvogëlimit të rrezikut nga sektori bankar i Kosovës. Prirja për rrezik më të ulët mund të mbështetet edhe në analizimin e raportit të RWA-ve ndaj gjithë mjeteve. Ky raport ka shënuar ngritje të lehtë në qershor 2014, dhe atë vetëm për shkak të faktit që në vitin 2014 janë përfshirë mjetet për rrezik operacional në gjithë RWA-të²⁰. Në të kundërtën, në rast se nuk merren parasysh mjetet për rrezik operacional për vitin 2014 për qëllime të krahasueshmërisë me vitet paraprake, raporti i

Figura 79. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2014)

Figura 80. Raporti i RWA-ve ndaj gjithë mjeteve të sektorit



Burimi: BQK (2014)

¹⁸ Pozicioni i rrezikut operacional zyrtarisht hyri në fuqi nga muaji korrik i vitit 2013.

¹⁹ Në këtë kalkulim janë përfshirë edhe mjetet jashtë-bilancore për shkak të përfshirjes së tyre në llogaritjen e gjithë RWA-ve.

²⁰ Përfshirja e mjeteve për rrezik operacional në RWA është bërë efektive në korrik 2013, andaj RWA-të e periudhës qershor 2013 nuk përfshijnë këto mjetet.

RWA-ve ndaj gjithsej mjeteve në qershor 2014 do të ishte 54.8 përqind (figura 80), që sugjeron për rënie të pjesëmarrjes së mjeteve me rrezik në portofolin e bankave.

6.3.4. Rreziku i tregut


Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton rrezikun nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe ndryshimet në normat e interesit, vazhdon të mbetet në nivel të ulët. Pozicionet e hapura neto në valuta të huaja ndaj kapitalit të klasit të parë kanë pësuar ndryshime marginale duke qëndruar në nivelin e tyre të ulët, që bënë sektorin të jetë pak i ndjeshëm ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit. Kreditë në valutë të huaj, të cilat edhe ashtu kanë pjesëmarrje mjaft të ulët në gjithsej portofolin kreditor (0.3 përqind në qershor 2014), kanë shënuar rënie, dhe në këtë mënyrë nuk paraqesin rrezik indirekt kreditor, që mund të manifestohej prej ndryshimeve në kurse valutore në rast të kreditimit në valutë të huaj kur huamarrësi pranon të ardhurat në valutë tjetër nga ajo e kthimit të kredisë. Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit mbetet i ulët gjithashtu, për faktin që zërat kryesor të bilancit të gjendjes së sektorit, kreditë dhe depozitat, kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit në afat të shkurtër. Diferenca mes aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit në raport me gjithsej asetet e sektorit mbetet e ulët, gjë që sugjeron se ndryshimet në norma të interesit mund të kenë ndikim jo të rëndësishëm në performancën e sektorit.

Rreziku nga normat e këmbimit valutor

Pozicioni i agreguar i hapur neto në valutë të huaj është zgjeruar lehtësisht gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Asetet në valutë të huaj rritën vlerën e tyre në 145.8 milionë euro (vlerë ekuivalente) nga 134.6 milionë në qershor 2013. Mirëpo, detyrimet në valutë të huaj shënuan rritje më të lartë në 146.9 milionë nga 133.7 milionë euro vlerë ekuivalente, duke bërë që pozicioni i hapur neto të ndërrojë kahje (detyrimet në valutë tejkalojnë asetet) dhe të zgjerohet në -1.1 milionë euro vlerë ekuivalente (0.9 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2013). Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat²¹ shënoi rritje gjithashtu, nga 6.5 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2013, në 6.9 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2014. Sidoqoftë, rritja e nivelit të kapitalit të klasit të parë të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe bëri që raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë të zbrësë në 2.6 përqind krahasuar me 2.7 përqind në vitin paraprak (figura 81).

Në aspektin e disagreguar valutor, pozicionin më të lartë neto të hapur ndaj kapitalit të klasit të parë e arriti dollari amerikan, për dallim nga franga zvicerane në vitin e kaluar. Në qershor 2014, ky raport për dollarin amerikan arriti në -0.7% (-0.05% në qershor 2013), ndërsa për frankun zviceran raporti zbriti në 0.4% (nga 0.6% në qershor 2013). Raporti i pozicioneve neto të hapura për valuta individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën

Figura 81. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë




Burimi: BQK (2014)

²¹ Pozicioni i agreguar neto i hapur nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në të gjitha valutat. Më konkretisht, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezultojnë në neto pozicion të grumbulluar prej 2 milionë euro.

maksimumi prej 15 përqind të lejuar nga BQK. Bazuar në këto të dhëna, mund të sugjerohet që sektori bankar vazhdon të mbetet mjaft mirë i mbrojtur nga lëvizjet në kurset e këmbimit.

Sektori bankar i Kosovës ka kreditim mjaft të ulët në valutë të huaj. Në qershor 2014, kreditë e lëshuara në valutë të huaj zbritën në 5.9 milionë nga 6.9 milionë euro vlerë ekuivalente dhe raporti i tyre ndaj gjithsej portofolit kreditor zbriti në 0.3 nga 0.4 përqind në qershor. Depozitat në valutë të huaj, në anën tjetër, kanë pjesëmarrje më të lartë. Në qershor 2014, vlera e tyre arriti në 138.3 milionë nga 126.3 milionë euro vlerë ekuivalente në vitin paraprak, ndërsa pjesëmarrja në gjithsej depozitat mbeti e njëjtë në 5.7 përqind. Raporti i kredive ndaj depozitave në valutë të huaj zbriti në 4.3 përqind nga 5.5 përqind në qershor 2013 (figura 82).

Figura 82. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj




Burimi: BQK (2014)

zbriti në 4.3 përqind nga 5.5 përqind në qershor 2013

Rreziku nga ndryshimet në normat e interesit

Sektorit bankar i Kosovës është i mbrojtur relativisht mirë ndaj ndryshimeve në normat e interesit, për faktin që kreditë dhe depozitat kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe të hyrat dhe shpenzimet e interesit nga këto zëra nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim.. Në qershor 2014, rreth 91 përqind e gjithsej kredive kishin normë fikse të interesit. Ndërsa, depozitat me normë fikse të interesit përbëjnë 100 përqind të gjithsej depozitave (figura 83).


Figura 83. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit, sipas llojit të normës së interesit



Burimi: BQK (2014)

Megjithatë, ndryshimi i normave të interesit mund të ketë ndikim në kuptimin e rrezikut të rifinancimit dhe riinvestimit të mjeteve varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe depozitave të ndjeshme ndaj normave të interesit (figura 84), si dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit. Dallimi mes aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit është pothuajse më i larti për kategorinë e maturimit deri në 30 ditë, ku detyrimet e ndjeshme ndaj normës së interesit tejkaluan asetet për 363.2 milionë euro (332.1 milionë euro në qershor 2013). Marrë parasysh që kjo diferencë është negative (vëllimi i detyrimeve të

Figura 84. Hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

ndeshme ndaj normave të interesit është më i lartë se i aseteve), ndryshimet e mundshme në norma të interesit në afat të shkurtër reflektohen më shumë në shpenzime krahasuar me të hyrat e sektorit. Pjesa dominuese e detyrimeve të ndeshme ndaj normës së interesit në Kosovë janë depozita, andaj sektori bankar është i ekspozuar ndaj rritjes së mundshme të normave të interesit në afat të shkurtër në kuptimin që kosto e rifinancimit të depozitave rritet më shpejtë se që mund të rriten të hyrat e arkëtuara nga normat më të larta të interesit për investime ngase maturimi i aseteve është më i gjatë.

Kutia 4. Identifikimi i bankave me rëndësi sistematike në Kosovë

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistematike²² paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së rëndësisë sistematike të bankave përkatëse. Në përgjithësi, një bankë konsiderohet të ketë rëndësi sistematike nëse pritet që dështimi i mundshëm i saj të manifestohet me pasoja të rëndësishme negative për funksionimin dhe stabilitetin e tërë sektorit dhe për ekonominë në tërësi. Andaj, monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së rëndësisë sistematike konsiderohet të jetë i rëndësishëm së veçantë për stabilitetin financiar për shkak se mundëson identifikimin e ‘vatrave potenciale të rrezikut’ dhe rekomandimin e hartimit të politikave dhe masave të nevojshme për sigurimin adekuat të kapaciteteve absorbuese të humbjeve të bankave konform shkallës së rëndësisë së tyre sistematike.

Ky artikull paraqet vlerësimin e shkallës së rëndësisë sistematike për të gjitha bankat dhe degët bankare që operojnë në tregun e Kosovës duke u bazuar në të dhënat e muajit qershor 2014 të bilanceve të gjendjes së bankave përkatëse. Për vlerësimin e rëndësisë sistematike të bankave, modeli bazohet në katër kriteret bazë: kriterin e madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlikohjes dhe kompleksitetit. Dy kriteret e para të sugjeruara nga modeli bazë (madhësia dhe zëvendësueshmëria) janë konsideruar si kriteret themelore për përcaktimin e rëndësisë sistematike në rastin e Kosovës, andaj dhe pesha e tyre në model është dominuese me nga 40 përqind secila. Ndërsa dy kriteret tjera (ndërlikohja dhe kompleksiteti) janë peshuar me nga 10 përqind duke u bazuar në faktin që sektori bankar i Kosovës ka shkallë të ulët të ndërlikohshmërisë së institucioneve në kuptimin e kreditimit dhe huazimit të ndërsjellë, si dhe është i bazuar në aktivitete tradicionale të bankikut ku shkalla e kompleksitetit është e ulët ngase financimi bazohet kryesisht në depozita dhe produktet kryesore janë kreditë.

Për secilin nga kriteret janë përcaktuar indikatorët përmes të cilëve synohet matja e shkallës së rëndësisë sistematike për secilën bankë.²³ Indikatorët e përdorur janë paraqitur në tabelën 7, dhe secilit prej indikatorëve brenda një kriterit të caktuar i është dhënë peshë e barabartë.²⁴

Përzgjedhja e indikatorëve është bërë konform teorisë përkatëse dhe sugjerimeve të kornizës mbi të cilin është zhvilluar ky model. Supozimi i përgjithshëm në raport me *kriterin e madhësisë*, i konsideruar si kriteri kryesor për matjen e rëndësisë sistematike të një institucioni, është që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq më e madhe është rëndësia e saj sistematike meqë palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve është synuar të matet si në aspektin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së aseteve në gjithsej asetet e sektorit, ashtu edhe në aspekte të veçanta të bilancit të gjendjes siç janë pjesëmarrja e depozitave të bankës përkatëse në gjithsej depozitat e sektorit, numri i depozitorëve, pjesëmarrja e parave të gatshme dhe rezervave, etj. për të reflektuar kështu rëndësinë e tyre në aspekte/segmente të veçanta të sektorit bankar, si p.sh. numri i depozitorëve që mund të ndikohet në rast të paraqitjes së problemeve apo falimentimit të mundshëm të një banke të caktuar.

Kriteri i zëvendësueshmërisë synon që të masë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të bankës përkatëse nga bankat tjera në treg, në rast të dështimit të saj. Supozimi kryesor për kriterin e zëvendësueshmërisë është që sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar

²² Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistematike është zhvilluar bazuar në principet bazë të modelit për identifikimin e bankave me rëndësi sistematike të hartuar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare në qershor 2012, si dhe në modelin paraprak të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për Identifikimin e Bankave me Rëndësi Sistematike në Kosovë (Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 3, 2012). Vlerësimi dhe modifikimi i specifikave të modelit bëhet në mënyrë të vazhdueshme me qëllim të avancimit të tij.

²³ Vlen të theksohet që modeli ka për qëllim që të identifikojë institucionet me rëndësi sistematike në bazë të shkallës apo efektit që falimentimi i tyre i mundshëm mund të ketë në tregun vendor, dhe jo të masë rrezikun e falimentimit të institucioneve.

²⁴ Të gjithë indikatorët janë të shprehur si përqindje e vlerës totale të indikatorit përkatës të gjitha bankave të përfshira në analizë.

të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta kapacitete teknike dhe njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. vlerësimin e rrezikut të kredive për sektorin e bujqësisë), gjë që e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e rolit të saj në atë fushë nga bankat ekzistuese apo edhe nga hyrësit e ri në treg. Andaj, edhe rëndësia sistematike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të saj janë më të mëdha.

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë së institucioneve bankare ndërmjet vete si dhe me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës së krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistematik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndër-bankar është pothuajse joekzistent dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kryesisht kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar kanë në bankat komerciale në vend. Rrjedhimisht, ndërlidhja mes institucioneve financiare do të tentohet të matet përmes pjesëmarrjes së plasmanëve në bankat tjera dhe ekspozimit kreditor për korporatat tjera financiare, si dhe pjesëmarrjes së depozitave dhe huamarrjeve nga korporatat tjera financiare.

Sa i përket *kriterit të kompleksitetit*, synimi i tij është që të masë shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit. Në rastin e Kosovës, si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor në gjithsej portfolion e aseteve të asaj banke.

Tabela 8. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistematike të bankave në Kosovë

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 40%)	Pjesëmarrja e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në Pjesëmarrja në tregun e aseteve të sektorit Pjesëmarrja në tregun e depozitave të sektorit Kapitali vetanak i bankës në raport me gjithsej kapitalin e sektorit Pjesëmarrja e letrave me vlerë të sektorit Numri i depozitorëve të bankës në raport me gjithsej depozitorët Pjesëmarrja e mjeteve likuide të sektorit
Zëvendësueshmëria (pesha 40%)	Pjesëmarrja në kreditë për bujqësi të gjithsej sektorit Pjesëmarrja në kreditë për konsum të ekonomive familjare Pjesëmarrja në kreditë e industrisë, prodhimit, energjisë dhe ndërtimitarisë Pjesëmarrja në kreditë e tregtisë Numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës Pjesëmarrja në tregun e gjithsej kredive
Ndërlidhshmëria (pesha 10%)	Pjesëmarrja e depozitave dhe huazimeve nga korporatat tjera financiare dhe bankat tjera Pjesëmarrja e kredive për korporatat tjera financiare Pjesëmarrja e plasmanëve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë)
Kompleksiteti (pesha 10%)	Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2014)

Për të identifikuar rëndësinë sistematike të një bankë është krahasuar vlera e secilit indikator me vlerën mesatare të indikatorit përkatës për tërë sektorin. Në rastet kur vlera e indikatorit të një institucioni ka tejkaluar vlerën mesatare të sektorit, atëherë ai institucion është konsideruar të ketë rëndësi sistematike për indikatorin përkatës. Kur indikatorin ka rezultuar mbi mesataren e sektorit (i rëndësisë sistematike), atij i është dhënë vlera 1, ndërsa në të kundërtën i është përcaktuar vlera 0. Në vazhdimësi, këto vlera janë shumëzuar me peshën e indikatorit përkatës, dhe kur një bankë ka rezultuar të ketë rëndësi sistematike në gjysmën apo më shumë se gjysmën e indikatorëve të një kriteri, atëherë ajo është konsideruar të ketë rëndësi sistematike për kriterin përkatës. Në fund, bankat të cilat kanë rezultuar të kenë shumën e

mesatares së peshuar të kriterëve të barabartë ose më të lartë se 50%²⁵, atëherë ato banka janë konsideruar të kenë rëndësi sistemike. Sa më e lartë mesatarja e peshuar, aq më e lartë rëndësia sistemike e atij institucioni.

REZULTATET

Rezultatet e përgjithshme të modelit me të dhëna të qershorit 2014²⁶ mbesin të ngjashme me ato të muajit qershor 2013. Katër bankat më të mëdha që operojnë në Kosovë vazhdojnë të konsiderohen me rëndësi të përgjithshme sistemike. Intervali i shkallës së rëndësisë sistemike ka shënuar ngritje të lehtë dhe shtrihet nga 65%, për bankën sistemike me shkallën më të ulët të rëndësisë sistemike, deri në 94.2% për bankën sistemike me shkallën më të lartë. Dy nga bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike rezultuan me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret, sikurse në qershor 2013. Ndërsa dy të tjerat, përkundër rëndësisë sistemike të përgjithshme, nuk rezultuan të kenë rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhshmërisë.

Rezultatet gjithashtu sugjerojnë që njëra nga bankat më të vogla, e cilat nuk rezultoi me rëndësi të përgjithshme sistemike për shkak të pjesëmarrjes më të ulët në treg, megjithatë doli të ketë rëndësi sistemike në njërin nga kriteret si ai i kompleksitetit. Gjithashtu, vlen të theksohet se disa nga bankat, megjithëse nuk rezultuan të kenë rëndësi sistemike për tërë kriterin e zëvendësueshmërisë dhe ndërlidhshmërisë, dolën të kenë pjesëmarrje të rëndësishme në disa indikatorë si numrin e transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave, pjesëmarrjen në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si dhe pjesëmarrjen e depozitave dhe huazimeve nga korporatat tjera financiare dhe plasmanët në banka tjera duke mos përfshirë bankat amë. Një rezultat i tillë ku bankat kanë rëndësi sistemike në disa indikatorë dhe kriteret të caktuara, por jo edhe rëndësi sistemike të përgjithshme, sugjeron që efekti i dështimeve të mundshme të këtyre bankave megjithatë mund të jetë i lartë për sektorë dhe aspekte të caktuara të sektorit financiar dhe atij real.

6.4. Analiza Stres-Test

Analiza stres-test paraqet një vegël të rëndësishme të vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit ndaj tronditjeve të mundshme në portofolin kreditor si dhe në pozitën e likuiditetit, të cilat mund të pasojnë nga zhvillimet jo të favorshme ekonomike dhe ndryshimet në kushtet e tregut. Përmes kësaj analize vlerësohet ndikimi i këtyre tronditjeve në kualitetin e portofolit kreditor, të hyrat e bankës, pozitën e likuiditetit, si dhe gjendjen e saj të përgjithshme financiare – nivelin e kapitalit.

Analiza e prezantuar më poshtë ka për bazë të dhënat e sektorit bankar të Kosovës për muajin qershor 2014, të cilat janë shfrytëzuar për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit valutor (rreziku i tregut). Gjithashtu, është testuar aftësia e sektorit që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike mbi tërheqje të konsiderueshme të depozitave (rreziku i likuiditetit).

Rezultatet e analizës stres-test sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar 'situatat ekstreme' të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

6.4.1. Rreziku kreditor

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se gjendja ekonomike në eurozonë dhe në rajon do të përkeqësohet, dhe kjo do të reflektohet në ekonominë e Kosovës kryesisht përmes

²⁵ Kufijtë për llogaritjen e rëndësisë sistemike në kriteret përkatëse ishin: për kriterin e madhësisë, kur mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë apo më e lartë se 20% (gjysma e peshës së kriterit të madhësisë prej 40%, apo shuma e peshës së gjysmës së indikatorëve të kriterit: $20\% = 5.7\% \cdot 3.5$ indikatorë); për zëvendësueshmërinë, kur mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 20% (gjysma e peshës së kriterit prej 40%); për kriterin e ndërlidhshmërisë, kur mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 5% (gjysma e peshës së kriterit prej 10%); dhe për kriterin e kompleksitetit, kur mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 10% (gjithsej pesha e kriterit meqenëse u vlerësua nga një indikatorë i vetëm).

²⁶ Rëndësia sistemike ndryshon në kohë ngase është relative dhe krahasimore, andaj sugjerohet të vlerësohet në mënyrë periodike.

zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, rritja ekonomike në vend supozohet të përkeqësohet duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.5 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.5 përqind për vitin 2014. Në këtë situatë, hendeku i prodhimit do të ishte 6.0 përqind, ndërsa ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, që nënkupton rritje prej 4.8pp të pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është konsideruar që në gjysmën e dytë të vitit nuk do të ketë rritje të kreditimit.

Në një skenar shtesë ndaj skenarit bazë, krahas rrezikut kreditor janë konsideruar edhe efektet e rrezikut të tregut në të hyrat e sektorit. Pra, rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit, duke supozuar rënie të normave të interesit për 2.0pp si dhe zhvlerësim të valutës euro ndaj valutave të tjera për 20 përqind.

Efektet e supozimeve të mësipërme në sektorin bankar reflektohen si në vijim: rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve; zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave.

Krahas këtyre supozimeve, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të hyrave nga interesi si rezultat i dështimit të kredive (rritjes së NPL-ve). Andaj, profiti i pritshëm i bankave është llogaritur duke marrë për bazë profitin neto pas tatimit të gjysmës së vitit 2014, ndaj të cilit fillimisht është aplikuar tronditje prej 40 përqind për të reflektuar efektin e mos rritjes së kreditimit në pjesën e dytë të vitit, dhe pastaj janë zbritur edhe të hyrat që do të realizoheshin po qe se NPL nuk do të rritej.

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të humbura). Rritja e NPL-ve është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin shtesë është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pjesa dërmuese e portofolios së kredive është në euro, kreditimi në valutë të huaj pothuajse nuk ekziston, duke bërë që rreziku nga norma e këmbimit valutor të mbetet minor.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp (si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes). Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), kryesisht duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave ngase pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit dhe ndryshimet në norma të interesit nuk reflektohen deri në maturim. Sidoqoftë, ekspozimi ndaj rrezikut të rënies

së normave të interesit është i ulët ngase hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit nuk është i lartë, si dhe efekti i mundshëm negativ nga rënia e normave të interesit për kategoritë me hendek pozitiv (siç janë kategoritë me maturitet më të gjatë se një muaj) neutralizohet, apo në shumë raste edhe tejkalohet, nga efekti pozitiv që rënia ka rënia e normës së interesit për kategorinë me hendek negativ siç është ajo me maturitet deri në një muaj ku detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit tejkalojnë mjetet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit.

Skenarë tjerë shtesë: Krahas skenarëve bazë të lartpërmendur, skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përbalues i NPL-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të skenarëve hipotetik në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar, mjeteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

Rezultatet

Gjendja e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave në qershor 2014 ishte mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.4 përqind (tabela 8). Sektori bankar vazhdoi të qëndrojë mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive jo-performuese në raport me gjithsej kreditë, të cilat qëndruan në 8.2 përqind në qershor 2014, si dhe mbulueshmërisë së tyre me provizione me 116.4 përqind. Andaj, si rezultat i pozicionit të mirë fillestar si dhe profitabilitetit më të lartë që nga fillimi i funksionimit të tij, sektori bankar i Kosovës ka treguar nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e supozimit të skenarëve hipotetik të përshkruar më lartë.

Nën supozimet e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor (bilancor dhe jashtë bilancor) - në të cilin pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion kreditor do të rritej për 4.8pp, ndërsa profiti i pritur për tërë vitin do të shfrytëzohej për absorbimin e humbjeve - treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) të sektorit bankar do të zbriste në normën prej 16.7 përqind.²⁷ Norma e kapitalizimit pas tronditjeve do të mbetej mbi minimumin prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Megjithatë, në nivel të bankave individuale, CAR për tri nga bankat do të zbriste në nivelin 12 përqind, dhe rrjedhimisht, do të duhej një injektim kapitali prej 3.5 milionë euro (ekuivalent me 0.07 përqind të vlerës së PBB-së së parashikuar për vitin 2014) për të rikthyer kapitalizimin në nivelin e kërkuar. Në këto rrethana, pjesëmarrja e NPL në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 13.0 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale niveli më i lartë i normës së NPL-ve do të ishte 16.5 përqind. Duke u bazuar në supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 63.5 milionë euro (1.21 përqind të PBB-së).

Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si humbje eventuale me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar. Gjithashtu, një pjesë e humbjeve kthehen nga realizimi i kolateralit apo nga riprogramimi, por që ky aspekt nuk është konsideruar për qëllim të kësaj analize.

²⁷ Vlen të theksohet se në këtë edicion ka ndryshim metodik në vlerësimin e rrezikut kreditor, ku humbjet e vlerësuara vjetore tash e tutje nuk zbriten nga mjetet e peshuara me rrezik për qëllim të kalkulimit të normës së kapitalizimit (CAR) pas tronditjeve. Ky ndryshim është konform praktikës që kreditë e klasifikuara si të humbura nuk ndodhë të shlyhen nga bilanci i gjendjes para se të kalojë një vit, dhe me që horizonti kohor i analizës stres-test është një vit, sugjerohet që humbjet e tilla të mbeten në kuadër të mjeteve të peshuara me rrezik me faktor (peshë) të njëjtte të rrezikut. Ky ndryshim metodik paraqet qasje më konservative të vlerësimit të rrezikut kreditor në krahasim me edicionet paraprake.

Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave ^{1/}			CAR %			NPL %			Rikapitalizimi	
	CAR <0	CAR 0-8%	CAR 8-12%	Nr. më i ulët	Nr. më i lartë	Nr. i sektorit	Nr. më i ulët	Nr. më i lartë	Nr. i sekt.	Në mln. euro	Si % e PBB-së
Nivelet para goditjeve	0	0	1	11.5	19.5	17.4	6.0	11.7	8.2		
Rezultatet e makroskenarëve											
Skenari bazë	0	0	3	10.0	20.0	16.7	4.8	16.5	13.0	3.5	0.07
Kombinimi me rrezik të tregut	0	0	3	10.8	20.0	16.8	4.8	16.5	13.0	2.6	0.05
Dështimi i tre kredimarrësve	2	0	3	-5.4	20.1	11.0	9.5	35.2	18.7	78.2	1.5
Dështimi i pesë kredimarrësve	2	4	0	-12.0	20.1	8.6	10.6	38.7	21.6	122.4	2.3

Shënim: 1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stress-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullativ, i ndarë sipas kategorive.

Shënim: 2/ Në raportim të vlerave minimale dhe maksimale të indikatorëve në nivel të bankave, në disa raste janë përjashtuar vlerat e larta të CAR si dhe vlera e NPL prej 0 përqind, të cilat karakterizojnë bankat në fillim të veprimtarisë.

Burimi: BQK (2014)

Rezultatet e skenarit shtesë në të cilin rreziku kreditor kombinohet me rrezikun e tregut – në të cilin rast krahas rritjes së normës së NPL-ve për 4.8pp, euro do të zhvlerësohej ndaj valutave tjera për 20 përqind, dhe normat e interesit do të zvogëloheshin për 2.0pp - treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) të sektorit bankar do të mbetej në 16.8 përqind. Tri banka do të zbrisnin nën minimumin rregullativ të CAR prej 12 përqind, dhe nevojat për rikapitalizim do ishin 2.6 milionë euro (0.05 përqind të PBB-së).

Skenarët tjetër shtesë supozojnë dështimin e ekspozimeve të mëdha. Rezultat e skenarit në të cilin supozohet dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat sugjeron që CAR i sektorit do të zbriste në nivelin 11.0 përqind. Në nivel të bankave individuale, CAR i pesë bankave do të zbriste nën nivelin minimal të kërkuar prej 12 përqind dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin 78.2 milionë euro (vlerë ekuivalente me 1.5 përqind të PBB-së së supozuar për vitin 2014). Nën supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, CAR i sektorit do të zbriste në nivelin 8.6 përqind, ndërsa numri i bankave të nën-kapitalizuara do të arrinte në gjashtë. Vlera e nevojshme për rikapitalizimin e sektorit bankar do të arrinte në 122.4 milionë euro që është ekuivalente me 2.3 përqind të PBB-së së supozuar për 2014.

Nivelet përballuese të NPL-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalizim (para se Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit –CAR të zbres nën nivelin 12 përqind) duken të jenë mjaft të larta për shumicën prej bankave. Në një prej bankave, NPL do të mund të rritej deri në 22.1 përqind të gjithsej portofolit të kredive të asaj banke para se të paraqitet nevoja për kapital shtesë. Në disa banka, nivelet përballuese të normës së NPL-ve duken të jenë më të ulëta, ku niveli më i ulët në njërin nga bankat është 9.7 përqind (vetëm 1.8pp më shumë se niveli i NPL para tronditjes). Njëra nga bankat mund të përballojë rritje të raportit të NPL për vetëm 1.3pp para se të paraqiten nevojat për kapitalizim shtesë. Sidoqoftë, sektori bankar është në gjendje të përballojë një raport të NPL-ve deri në 16.5 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim kapitali për mbajtjen e CAR të sektorit në nivelin rregullativ prej 12 përqind.

6.4.2. Rreziku i likuiditetit

Metodologjia²⁸

Skenari bazë: Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin bazë të tërheqjes së një vlere të theksuar të depozitave nga sektori bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Më specifikisht, është konsideruar tërheqja e 8% të depozitave në baza ditore, përgjatë një periudhe pesë ditore, duke ndarë 5% të depozitave të mbetura pas

²⁸ Metodologjia e llogaritjes së mjeteve likuide ka ndryshuar për të qenë konform rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Paraprakisht mjetet likuide për qëllim të analizës stres-test janë llogaritur sipas metodologjisë së Tregueseve të Shëndetit Financiar të FMN-së.

çdo dite për qëllime operacionale të bankës. Ndarja e 5 % të depozitave nënkupton që, nën këto kushte, supozohet që rezerva e detyrueshme prej 10 % do të përgjysmohet. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu, në këtë skenar është supozuar se bankat nuk kanë mundësi të financimit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenarë shtesë: Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përbalues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të paraqitet nevoja për likuiditet shtesë.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar tërheqje mjaft të mëdha të depozitave si dhe mjaftueshmëria e aseteve likuide për të përballuar rrezikun e mundshëm nga koncentrimi i depozitave.

Rezultatet

Spektori bankar i Kosovës u karakterizua me likuiditet të lartë në qershor të vitit 2014, ku indikator i kyç i likuiditetit - raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra- qëndroi në 43.7 përqind. Andaj, si rezultat i pozitës së fortë të likuiditetit, sektori bankar tregoi aftësi të kënaqshme të përballimit të skenarëve të supozuar mjaft konzervativ të tërheqjes së depozitave.

Rezultatet e skenarit bazë të tërheqjes së 8% të depozitave në ditë, për pesë ditë në vazhdimësi, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës do të fillonte të ketë nevojë për likuiditet shtesë në ditën e tretë, ku vetëm njëra nga bankat ka mungesë të mjeteve likuide prej 1.4 milionë euro (tabela 10).

Tabela 10. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave ^{1/}	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mln. €)
Pas ditës së parë	0	0
Pas ditës së dytë	0	0
Pas ditës së tretë	1	1.4
Pas ditës së katërt	2	19.5
Pas ditës së pestë	4	44.4

Shënim: 1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Burimi: BQK (2014)

Në fund të ditës së katërt, edhe një bankë tjetër fillon të ketë probleme me adekuatshmëri të mjeteve likuide dhe nevojat e përgjithshme për injektim të likuiditetit arrijnë në 19.5 milionë euro. Pas ditës së pestë, gjithsej katër banka kanë mungesë të mjeteve likuide për përballim të tërheqjeve të supozuara të depozitave. Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në ditën e pestë do të arrinte në 34 përqind, dhe shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 44.4 milionë euro (0.85 përqind e PBB-së së supozuar për vitin 2014).

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat rezulton të mos jetë shqetësues për gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sektorin bankar. Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit (depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve); andaj, tërheqja e menjëhershme e depozitave nga individë apo kompani me vlerën e depozitave më të mëdha nuk paraqet rrezik serioz për sektorin.

Nivelet përbaluese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet rezultojnë të jenë mjaft të larta. Banka me pragun më të ulët qëndron në 19.5 përqind, ndërsa ajo me pragun më të lartë në 45.5 përqind. Në nivel të sektorit, pragu i tërheqjes së gjithsej depozitave ishte afër 33.1 përqind, që nënkupton që sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e një të tretave (1/3) të gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë. Në këtë rast, nën supozimin që vlera e kredive nuk do të rritet, raporti kredi/depozita për sektorin bankar do të arrijë në 116.1 përqind.

6.5. Ngarkesa me borxh dhe performanca e kredive të klientëve

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka realizuar studimin mbi nivelin e ngarkesës me borxh të klientëve kreditor në Kosovë, qëllimi kryesor i të cilit ishte vlerësimi i nivelit të ngarkesës me borxh si dhe identifikimi i modeleve të huamarrjes së klientëve kreditor dhe faktorëve që mund të kenë ndikim në kapacitetin e huamarrësit për të shlyer detyrimet kreditore. Studim i ngjashëm, që hulumtoi çështjen e ngarkesës me borxh të klientëve kreditor në Kosovë, është kryer më parë nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) në bashkëpunim me Qendrën Mikrofinanciare, ndërsa nga viti 2013 BQK është përkushtuar për ndërmarrjen e analizave të tilla që shfrytëzojnë të dhënat e Regjistrimit të Kredive të Kosovës për të informuar mbi ngarkesën me borxh dhe performancën e klientëve në pagesën e kontratave kreditore.²⁹

Ky studim përfshiu një mostër³⁰ prej 1,160 klientëve kreditor të 7 (shtatë) bankave³¹ me kontratë kreditore aktive me datën 31 dhjetor 2013, shuma e aprovuar e të cilave ishte në intervalin 5,000 – 50,000 euro. Përveç shfrytëzimit të dhënave të Regjistrimit të Kredive, studimi bazon gjetjet e tij gjithashtu në të dhëna të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të bankave të përfshira në studim.

Analiza strukturore rreth dy subjekteve kyçe: a) huamarrësve, ku theksi bie në karakteristikat sociodemografike të klientëve të përzgjedhur si mostër, modelet e tyre të huamarrjes, si dhe performancën në pagesë dhe nivelin e ngarkesës me borxh, dhe b) kontratave kreditore, ku në fokus të analizës është kontrata kreditore dhe jo huamarrësi. Në këtë pjesë analizohen të dhënat për të gjitha kontratat kreditore aktive të huamarrësve të përzgjedhur si mostër, me theks në karakteristikat kryesore të kontratave dhe ndërlidhja e tyre me performancën e pagesës.

Rezultatet kryesore të studimit do të paraqiten shkurtimisht në vijim, ndërsa studimi i plotë i cili do të përfshijë metodologjinë e plotë dhe analizën e detajuar të modeleve të huamarrjes, performancës së pagesës së kontratave kreditore dhe nivelit të ngarkesës me borxh, do të paraqitet si publikim i veçantë i BQK-së.

²⁹ Fondin Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) dhe Qendrën Mikrofinanciare kanë bashkëpunuar me BQK-në në bartjen e njohurive dhe eksperiencës së tyre në realizimin e studimeve të nivelit të ngarkesës me borxh.

³⁰ Mostra e përgjithshme e studimit është përzgjedhur nga popullimi i klientëve të gjitha institucioneve kredithënëse në Kosovë (institucioneve bankare dhe atyre mikrofinanciare) me kredi aktive në segmentin e kredive të përzgjedhur për studim. Shpërndarja e mostrës për bankat e përfshira në studim është bërë duke u bazuar në pjesëmarrjen e bankave përkatëse në segmentin e përzgjedhur të tregut.


³¹ Ky projekt studimor, i cili do të realizohet në baza të rregullta, synon të përfshijë të gjitha bankat komerciale që operojnë në Kosovë, dhe të cilat kanë historik kreditor të mjaftueshëm.

Huamarrësit

Afër 70 përqind e huamarrësve të përfshirë në studim ishin huamarrës individual të cilët huazuan si persona fizik, ndërsa 30 përqind prej tyre ishin subjekte juridike dhe huazuan si biznese. Nga gjithsej huamarrësit, 82 përqind e tyre ishin meshkuj, ndërsa 74 përqind e gjithsej huamarrësve jetonin në vende urbane. Të hyrat mujore³² bruto dhe neto të huamarrësve treguan ndryshueshmëri të konsiderueshme. Në përgjithësi, mediana e të hyrave mujore bruto për huamarrësit individual ishte afër 800 euro, ndërsa për të hyrat neto ishte 533 euro. Për bizneset, mediana e të hyrave mujore bruto ishte 10,850 euro ndërsa për të hyrat neto ishte 2,693 euro. Shumica e huamarrësve (72 përqind) kishin më shumë se një kontratë kreditore aktive në kohën e studimit, ku mesatarisht çdo huamarrës kishte 2.6 kontrata kreditore aktive. Huamarrja nga më shumë se një institucion ishte e pranishme te 39 përqind e huamarrësve. Në mesatare, një huamarrës kishte kontratë kreditore me 1.48 institucione kredidhënëse, ndërsa kishte huamarrës që kishin kontrata aktive kreditore nga 6 institucione njëkohësisht. Nga gjithsej huamarrësit, 16 përqind ishin të angazhuar në bashkë-huamarrje tjera krahas kontratave të veta kreditore, ndërsa 24.3 përqind e tyre kishin rolin e garantuesit në kontrata tjera kreditore.


Shpërndarja e huamarrësve sipas llojit të kontratës kreditore tregon se 98 përqind e klientëve kishin kredi aktive në portofolin e tyre kreditor (figura 85). Ndërsa, pjesëmarrja e vlerës së stokut të kredive në gjithsej vlerën e portoflios së huamarrësit në mesatare ishte 91 përqind Mbitërheqjet ishin produkti kreditor tjetër më i shpeshtë, ku 48 përqind e klientëve kishin mbitërheqje. Sidoqoftë, pjesëmarrja e vlerës së mbitërheqjeve në gjithsej portofolin kreditor të huamarrësit ishte vetëm 5 përqind, dhe kjo për

Figura 85. Shpërndarja e huamarrësve sipas llojit të kredisë (si përqindje e gjithsej huamarrësve)




Burimi: BQK (2014)

Figura 86. Shpërndarja e huamarrësve sipas kohës së vonesës së kontratave (si përqindje e gjithsej huamarrësve)



Burimi: BQK (2014)

Figura 87. Performanca e pagesës sipas llojit të huamarrësve (si përqindje e huamarrësve)



Burimi: BQK (2014)

³² Të dhënat për të hyrat mujore bruto dhe neto të klientëve janë pranuar nga bankat. Të dhënat mujore bruto për ndërmarrjet përfshijnë qarkullimin apo të hyrat totale mujore të biznesit, ndërsa për ekonomi familjare të ardhurat mujore bruto të komplet ekonomisë familjare. Të hyrat mujore neto për ndërmarrje përfshijnë fitimin neto pas tatimit, ndërsa për ekonomi familjare të hyrat totale bruto pas shpenzimeve mujore të ekonomisë familjare, duke mos përfshirë shpenzimet për pagesa të çfarëdo kësti kreditor.

shkak të vlerës më të ulët mesatare të mbitërheqjeve si dhe të bilancit zero të shumë mbitërheqjeve (37 përqind e gjithsej klientëve kishin borxh të mbetur në mbitërheqje në periudhën e studimit). Rasti i njëjtë ishte edhe me kredit kartelat ku 45 përqind e klientëve ishin shfrytëzues të këtij produkti, por vetëm 35 kishin borxh të mbetur, vlera e të cilit në raport me gjithsej portofolin kreditor të klientit, në mesatare, përbënte vetëm 2 përqind. Llojet tjera të kreditit rezultuan të përdoren nga 6 përqind e gjithsej huamarrësve dhe në mesatare përfaqësonin 1 përqind të vlerës së portfolios së huamarrësit.

Nga gjithsej huamarrësit, 11 përqind kishin vonesa më shumë se 30 ditë në pagesën e kështit, në ç'rast vonesat e gjata ishin më të shpeshta (figura 86). Performanca e pagesës dallonte sipas llojit të huamarrësve, ku huamarrësit individual kishin më pak vonesa në krahasim me ndërmarrjet (figura 87). Lloji i biznesit, ndërkaq, nuk rezultoi të ketë ndikim në performancën e pagesës, ku dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të bizneseve në aspektin e vonesave ishin marginale. Në anën tjetër, përvoja në biznes e ndërmarrjeve rezultoi të ketë ndikim, ku ndërmarrjet më të vjetra se 6 vite kishin më shpesh vonesa në kthimin e kredisë (figura 88).


Performanca e pagesës nuk ndryshonte sipas llojit të kreditit që kishin huamarrësit. Mundësia e vonesës në pagesë ishte e ngjashme për pothuajse të gjithë huamarrësit pavarësisht llojit të kontratës kreditore që posedonin, me një gjasë lehtësisht më të lartë të vonesës për klientët që posedonin kontrata të specifikuar si 'kontra tjera kreditore' e të cilat përfshijnë garancione, letra të kreditit, lizingje etj. (figura 89).

Ndër faktorët tjerë që rezultuan të kenë lidhshmëri me performancën e pagesës ishte huamarrja e shumëfishtë nga më shumë se një institucion. Huamarrësit me kontrata nga disa institucione rezultuan të kenë më shumë vonesa në pagesë të kredive. Gjithashtu, vonesa në pagesën e bashkëhuamarrjes doli të jetë e lidhur me vonesën në pagesën e kontratave të veta kreditore. Të qenit garantues në kontrata tjera nuk rezultoi të asocohet me performancën e pagesës.

Kontratat Kreditore


Sa i përket kontratave aktive kreditore, më shumë se gjysma ishin kredi (53 përqind), pasuar nga mbitërheqjet (22 përqind) dhe kartelat e kreditit (21 përqind). Llojet tjera të kontratave kreditore përbënin vetëm 5 përqind të gjithsej portofolit kreditor. Kohëzgjatja mesatare e të gjitha kontratave kreditore aktive ishte 3 vjet e 6 muaj, ndërsa kontrata me maturimin më të gjatë arrinte në 20 vite. Më shumë se një e treta e kontratave kreditore ishin të lëshuara për qëllime biznesi. Kontratat për qëllime konsumi kishin pjesëmarrje prej 17 përqind, ato për qëllime të banimit 14 përqind, dhe kreditë për agrikulturë 4 përqind. Ndërsa, një pjesë e

Figura 88. Performanca e pagesës së ndërmarrjeve sipas vjetërsisë së ndërmarrjes (si përqindje e ndërmarrjeve)



Burimi: BQQ (2014)

Figura 89. Performanca e pagesës së huamarrësve sipas llojit të kontratës aktive kreditore (si përqindje e huamarrësve)



Burimi: BQQ (2014)


konsiderueshme prej 30 përqind ishishin kredi individuale të cilat u raportuan të kenë qëllime tjera.³³

Më pak se gjysma (43 përqind) e kontratave aktive kreditore ishishin të kolateralizuara me koleteral vetanak të huamarrësve dhe mesatarisht vlera e aprovuar e tyre ishte dukshëm më e lartë se e kontratave të pa mbështetura me kolateral nga vet huamarrësi.³⁴ Në mesatare, raporti i mbulueshmërisë së kontratave kreditore me koleteral ishte 5.3, por që ky raport është ndikuar nga vlera shumë e lartë e kolateralit për disa kontrata në krahasim me shumën e kontratës. Andaj, bazuar në medianën, raporti i mbulueshmërisë së kredisë me kolateral ishte 1.3, që sugjeron që për gjysmën e kontratave kreditore vlera e kolateralit mbulonte vlerën e kredisë për më pak se 1.3 herë. Raporti i mbulueshmërisë së kredisë me kolateral kishte dallime varësisht prej qëllimit të kontratës kreditore, ku kontratat për qëllime biznesi u shquan me raport mjaft më të lartë të mbulueshmërisë me kolateral.

Rezultatet e studimit tregojnë që shumica e kontratave aktive kreditore kishin performancë të saktë të pagesës. Nga gjithsej kontratat, 6.7 përqind kishin vonesë në pagesë për më shumë se 30 ditë. Dallimet në kohën e pagesës në mes të disa llojeve të ndryshme të kontratave kreditore rezultuan të jenë statistikisht të rëndësishme. Mbitërheqjet ishishin ndër produktet kreditore që kishin më së paku raste të vonesave, ndërsa kreditë, në anën tjetër, ishishin produkti me gjasën më të madhe për vonesë në pagesë pas produkteve tjera kreditore (figura 90).³⁵


Vonesa në pagesë për më shumë se 30 ditë rezultoi të ketë lidhshmëri me kohën e maturimit të kontratës. Kontratat të cilat ishishin në gjysmën e dytë të maturimit kishin më shumë vonesa në krahasim me kontratat kreditore që ishishin në dy fazat (çerekët) e parë të

Figura 90. Shpërndarja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë (mbi 30 ditë) sipas llojit të kontratës




Burimi: BQK (2014)

Figura 91. Pjesëmarrja e kontratave kreditore të vonuara në pagesë (mbi 30 ditë) sipas qëllimit



Burimi: BQK (2014)

Figura 92. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesë (mbi 30 ditë) në gjithsej pagesat për vitet 2006 - 2013



Burimi: BQK (2014)

³³ Të dhënat për qëllimin e kredisë ishishin në dispozicion vetëm për 83 përqind të kontratave kreditore aktive.

³⁴ Informata mbi kolateralin apo format e tjera të garancionit që të tjerët mund të kenë vënë në dispozicion për këto kontrata kreditore nuk është në dispozicion.

³⁵ Vlerat në legjendë paraqesin gjithsej numrin e kontratave kreditore sipas llojit të kontratës.

ripagesës. Prirjet për parregullsi në kthimin e kredisë në kohë që janë paraqitur në fazat afër maturimit të afatit të kthimit të kredisë mund të jenë, mes tjerash, pasojë e vlerësimit joadekuat të performancës së pritshme të kredimarrësve nga ana e institucioneve kredidhënëse, ose nga paraqitja e faktorëve të paparashikuar me ndikim në performancën e kredimarrësit.

Në mesatare, kontratat kreditore me vlerë më të lartë në kohën e aprovimit, dhe ato me vlerë më të lartë të mbetur për pagesë, rezultuan të kenë më shpesh raste të vonesës në pagesën e kësteve.


Për grupin e kontratave kreditore aktive për të cilin ekzistuan të dhënat e qëllimit të kredisë, pjesëmarrja e kontratave me vonesë ishte 5.7 përqind. Kontratat kreditore për qëllime të biznesit kishin më së shpeshti vonesa, të pasuara nga kontrata kreditore për agrikulturë dhe konsum. Kontratat për banim dhe qëllime tjera, të cilat janë kontrata të ekonomive familjare, kishin më së paku vonesa (figura 91).

Trendi i pagesave me vonesë më shumë se 30 ditë, i paraqitur në figurën 92, tregon se vonesat kanë filluar të rrisin pjesëmarrjen nga vitit 2011, duke arritur në 6.4 përqind të gjithsej pagesave në fund të vitit 2013. Kreditë e lëshuara në vitin 2011 rezultojnë të kenë pasur më së shumti pagesa me vonesë (figura 93), që përkon me gjetjet e mësipërme ku pjesëmarrja e pagesave me vonesë ndaj gjithsej pagesave fillon rritjen nga viti 2012.

Niveli i ngarkesës me borxh


Niveli i ngarkesës me borxh është vlerësuar përmes konstruktimit të indeksit të ngarkueshmërisë, i cili është llogaritur veçmas për klientët individual dhe për ndërmarrjet. Në rastin e individëve, janë marrë për bazë të hyrat mujore të ekonomisë familjare, përkatësisht të hyrat mujore neto pas pagesës së taksave, ndërsa për bizneset është marrë për bazë profiti neto. Indeksi, në të dy rastet, është kalkuluar si raport i këstit mujor (shumës së këstit mujor për të gjitha kreditë aktive) të huamarrësit ndaj të hyrave mujore neto.³⁶

Figura 93. Mesatarja e pjesëmarrjes së pagesave me vonesë (mbi 30 ditë) sipas vitit të lëshimit të kredive



Burimi: BQK (2014)

Figura 94. Shpërndarja e huamarrësve individual sipas indeksit të ngarkueshmërisë




Burimi: BQK (2014)

³⁶ Në rastet kur informatat mbi vlerën e këstit të kontratës kreditore kanë munguar, është bërë llogaritja e këstit mujor duke marrë për bazë normat mesatare të interesit të produkteve përkatëse kreditore të raportuara nga bankat dhe nga BQK.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se rreth 35 përqind e gjithsej huamarrësve të përfshirë në këtë studim (ekonomi familjare dhe biznese) rezultojnë të kenë problem me ngarkesë të borxhit, ku vlera e këstit mujor tejkalon mbi 50 përqind të hyrave neto.³⁷ Studimi gjithashtu ofron një pasqyrë të nivelit të ngarkesës me borxh të ekonomive familjare dhe bizneseve ndarazi. Problemet me ngarkesë më borxh janë më të shpeshta tek ekonomitë familjare, ku 44.7 përqind kanë ngarkesë borxhi të ndonjë niveli (janë në njërin nga kategoritë e ngarkesës me borxh si: në rrezik, në fazë kritike apo josolvent) (figura 94), në krahasim me 36 përqind të ndërmarrjeve (figura 95). Sidoqoftë, bizneset kanë raste më të shpeshta të ngarkesës së nivelit më të lartë, ku 19.3 përqind e tyre janë josolvent në raport me vetëm 8.4 përqind të individëve.

Figura 95. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas indeksit të ngarkueshmërisë




Burimi: BQK (2014)

Individët që shfrytëzonin aktivisht mbitërheqjet apo kartelat e kreditit - që nënkupton huamarrësit të cilët me datën e ekstraktimit të dhënave për studim kishin borxh të mbetur në mbitërheqje apo kreditkartelë - kishin më shumë raste të mbingarkesës.

Ngarkesa me borxh tek individët rezultoi të ketë lidhshmëri me llojin e vendbanimit, ku huamarrësit e vendeve urbane kishin në përgjithësi më shpesh probleme me ngarkueshmëri në krahasim me vendet rurale, por që rastet e josolventës ishin më të shpeshta në vendet rurale. Gjithashtu, moshë kishte lidhshmëri me ngarkesën me borxh, ku në përgjithësi, huamarrësit e moshës së mesme kishin më shpesh probleme me ngarkueshmëri.

Sa i përket ndërmarrjeve, rastet e josolventës ishin më të shpeshta në vende urbane. Faktor tjetër që kishte lidhshmëri me ngarkesën me borxh tek bizneset ishte përvoja në marrje të kredisë dhe historiku kreditor, për dallim nga individët ku ky relacion nuk doli të jetë i statistikisht i rëndësishëm. Ndërmarrjet që morën kredi për herë të parë ishin më pak të ngarkuara me borxh, dhe niveli i ngarkesës ishte më i lartë, sa më e gjatë që ishte historia kreditore e ndërmarrjeve.

Figura 96. Niveli i ngarkesës së huamarrësve individual dhe numri i institucioneve kredidhënëse



Burimi: BQK (2014)

Si në rastin e individëve, ashtu edhe tek bizneset, huamarrësit me më shumë se një kontratë kreditore kishin më shumë gjasë të jenë të mbingarkuar me borxh. Problemet me ngarkueshmëri shpeshtoheshin me shtimin e numrit të kontratave kreditore, si dhe huamarrësit që ishin klient të më shumë se një institucioni kishin më shumë gjasë të jenë të mbingarkuar me borxh (figura 96 dhe 97).

³⁷ Niveli i ngarkesës me borxh është kategorizuar si në vijim: a) Të pa ngarkuar me borxh, kur raporti i këstit ndaj të hyrave neto është nën 50 përqind; b) Në rrezik, kur indeksi i ngarkesës më borxh është mes 50 -75 përqind; c) Në fazë kritike, kur indeksi është mes 75 – 100 përqind, dhe d) Josolvent, kur indeksi tejkalon vlerën 100 përqind.

Tek ndërmarrjet, niveli i ngarkesës me borxh dallonte mjaft shumë varësisht nga fakti se a posedonte biznesi mbitërheqje dhe/apo kreditkartelë në portofolin kreditor. Bizneset të cilat posedonin njërin nga këto produkte kishin shumë më shpesh probleme të ngarkesës me borxh, dhe në 27 përqind të rasteve kishte probleme me josolventë (figura 98).


Një fakt i rëndësishëm është se studimi sugjeron që nuk ka lidhshmëri statistikisht të rëndësishme në mes të ngarkesës me borxh dhe performancës së pagesës së kredisë (faktit se a paguan huamarrësi kredisë në kohë apo me vonesë më shumë se 30 ditë). Sidoqoftë, huamarrësit josolvent kishin dyfish më shumë gjasë për të u vonuar në pagesa.

Përfundimisht, gjetjet e studimit sugjerojnë se faktorët kryesorë që kanë treguar lidhshmëri me vonesat në pagesën si dhe në ngarkesën me borxh, ndër tjera, përfshijnë: huamarrjen e shumëfishtë, e në veçanti huamarrjen e njëkohësishme nga disa institucione të ndryshme; përvojën në kredimarrje apo historikun kreditor; posedimin e mbitërheqjeve dhe produkteve tjera kreditore, etj. Faktorë të ngjashëm me rëndësi në performancën e pagesës dhe nivelit ngarkesës me borxh janë identifikuar edhe në studimin e fundit të realizuar nga EFSE³⁸, me disa dallime të vogla.

Kufizimet e studimit


Duhet të theksohet që gjetjet e studimit mund të jenë subjekt i disa kufizimeve në kualitetin e të dhënave. Më konkretisht, kalkulimi i indeksit të ngarkesës me borxh është subjekt i disa mangësive në lidhje me të dhënat e shfrytëzuara, si dhe gabimeve të mundshme në raportim të këtyre të dhënave. Të dhënat për këstin mujor nuk kanë qenë në dispozicion për të gjitha kreditë aktive, andaj është bërë kalkulimi duke shfrytëzuar normën mesatare të interesit për produktet përkatëse. Gjithashtu, në raste të disa produkteve kreditore siç janë mbitërheqjet, linjat kreditore dhe kreditë e mbuluara me para të

Figura 97. Niveli i ngarkesës së ndërmarrjeve dhe numri i institucioneve kredidhënëse




Burimi: BQK (2014)

Figura 98. Niveli i ngarkesës së ndërmarrjeve dhe posedimi i kreditkartelave dhe/apo mbitërheqjeve



Burimi: BQK (2014)

Figura 99. Niveli i ngarkesës me borxh dhe marrja e kontratave të reja kreditore pas kontratës mostrër



Burimi: BQK (2014)

³⁸ Përmbledhje e këtyre rezultateve është e përfshirë në Raportin e Stabilitetit nr.3, nën titullin: 'Ngarkesa me Borxh dhe Performanca e Kredive të Klientëve Mikro kreditor në Kosovë'.

gatshme, kësti mujor është raportuar në vlerë të barabartë me shumën totale të aprovuar të produktit kreditor, megjithëse afati i maturimit të produktit ishte më i gjatë.

Një mangësi tjetër e indeksit ka të bëjë me kualitetin e të dhënave për të hyrat e individëve dhe bizneseve. Kjo përfshinë jokonsistencën e mundshme ndërmjet institucioneve për sa i përket mënyrës së llogaritjes së të hyrave neto në dispozicion të huamarrësve. Problem tjetër mund të jetë vjetërsia e të dhënave për të hyrat mujore neto të disponueshme, e cila ka ndikim sidomos në rastet kur të hyrat e huamarrësve janë rritur në periudhën ndërmjet kohës kur banka ka bërë regjistrimin e të hyrave të tyre dhe datës së studimit e që nënkupton se kapaciteti për marrje të kredive shtesë të huamarrësve është rritur. Andaj, në rastet kur huamarrësi ka marrë kredi shtesë pas kredisë që është shfrytëzuar si mostër për përzgjedhjen e huamarrësve, ekziston mundësia që indeksi i ngarkesës me borxh të jetë mbivlerësuar.

Rezultatet e studimit sugjerojnë që ka lidhshmëri statistikisht të rëndësishme në mes të nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve si dhe faktit nëse i është lëshuar ndonjë kontratë e re kreditore huamarrësit në fjalë pas kredisë e cila është marrë për bazë për përzgjedhjen e mostrës për këtë studim. Huamarrësit të cilët kanë nënshkruar kontratë tjetër kreditore kanë më shpesh probleme me ngarkesë me borxh se huamarrësit të cilët nuk kanë nënshkruar kontrata tjera (figura 99). I njëjti rezultat vlen edhe në analizën e bërë ndaras për huamarrësit individual dhe bizneset. Përderisa ky rezultat mund të përputhet me gjetjen që problemet me ngarkesë rriten me rritjen e numrit të kontratave kreditore, ekziston gjithashtu mundësia që ngarkesa me borxh të jetë mbivlerësuar për shkak të mos llogaritjes së rritjes së mundshme të të hyrave dhe kapacitetit kredi marrës të huamarrësve.

6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë

6.6.1. Sistemi i Pagesave

Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi. Funkionimi efikas dhe i sigurt i sistemeve të pagesave paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK). Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) është sistem hibrid i pagesave, përmes të cilit procesohen pagesat me vlera të vogla, me vlera të mëdha si dhe pagesa urgjente.

Numri dhe vlera e transaksioneve që përpunon SEKN vazhdon të rritet. Deri në qershor 2014, numri i transaksioneve të përpunuara nga SEKN arriti në 4.3 milionë (2.6 milionë në qershor 2013), duke shënuar rritje vjetore prej 63.4 përqind. Kurse vlera e gjithsej transaksioneve deri në qershor 2014, arriti në 3.2 miliardë euro (2.8 miliardë në qershor 2013), që paraqet një rritje vjetore prej 11.7 përqind. Mesatarja ditore e transaksioneve përmes SEKN arriti në 35.8 mijë të tilla, ndërsa vlera e tyre në 26.5 milionë euro.

Në raport me numrin e transaksioneve, pagesat e rregullta masive vazhdojnë ta kenë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të instrumenteve të pagesave, 41.7 përqind të numrit të gjithsej pagesave (tabela 11). Këto pagesa janë kryesisht të realizuara për institucionet qeveritare. Më pas vijnë pagesat prioritare masive me një pjesëmarrje prej 36.6 përqind që janë kryesisht të realizuara nga institucionet qeveritare siç janë pagesat e pagave si dhe pagesat e rregullta me një pjesëmarrje prej 10.7 përqind. Pagesat prioritare masive janë pagesat të cilat kanë shënuar rritjen më të shpejtë në numër (1,574,546 në qershor 2014 nga 236,880 në qershor 2013) kryesisht si rezultat i fillimit të procesimit të pagave të administratës dhe pensioneve të MPMS përmes SEKN-së që nga prilli 2013.

Tabela 11. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së, në përqindje

Përshkrimi	Pjesëmarrja në numrin e gjithsej transaksioneve		Pjesëmarrja në vlerën e gjithsej transaksioneve	
	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2013	Qershor 2014
Të rregullta	15.8%	10.7%	51.4%	48.2%
Prioritare	0.4%	0.3%	13.7%	9.4%
Të rregullta - masive	62.7%	41.7%	9.0%	8.3%
Prioritare - masive	9.0%	36.6%	3.1%	9.6%
Pagesat xhiro	11.9%	10.5%	13.9%	13.3%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	8.7%	11.2%
Debitim Direkt	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK (2014)

Në raport me vlerën e transaksioneve, pagesat e rregullta vazhdojnë të kryesojnë strukturën e pagesave (48.2 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve). Pagesat kos-xhiro edhe pse shënuan rënie të pjesëmarrjes në vlerën e gjithsej pagesave (13.3 përqind në qershor 2014 krahasuar me 13.9 përqind në qershor 2013) vazhdojnë të qëndrojnë në vendin e dytë. Pagesat prioritare masive dhe letrat me vlerë janë instrumentet të cilat u karakterizuan me rritjet me të theksuara në vlerë gjatë kësaj periudhe, gjë që u reflektua edhe në rritjen e dukshme të pjesëmarrjes së tyre në strukturë të pagesave. Pagesat prioritare masive të procesuara përmes SEKN rritën pjesëmarrjen në 9.6 përqind në qershor 2014 nga 3.1 përqind sa ishin në qershor 2013, kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar së tyre në vlerë (305.5 milionë në qershor 2014, nga 89.6 milionë në qershor 2013). Siç edhe ceket më lartë procesimi i pagave të administratës dhe pensioneve të MPMS përmes SEKN-së, nga prilli 2013, është faktori kryesor i rritjes së lartë të këtij instrumenti. Pagesa e letrave me vlerë përmes SEKN gjithashtu shënoi rritje të theksuar (355.3 milionë euro në qershor 2014 nga 247.1 milionë euro në qershor 2013) që rezultoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në strukturë në 11.2 përqind në qershor 2014 (8.7 përqind në qershor 2013).

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare arriti në 1.88 milionë llogari në qershor 2014, që nënkupton që mesatarisht çdo qytetar në Kosovë është i pajisur me llogari bankare.³⁹ Nëse e krahasojmë numrin e llogarive bankare në vend në qershor 2014 me periudhën e njëjtë të viti të kaluar kemi një rritje të gjithsej llogarive bankare për 5.2 përqind.⁴⁰

Llogaritë bankare E-banking përmes të cilave shfrytëzuesit i qasen shërbimeve bankare 'online' nga interneti kanë vazhduar të rriten. Deri në qershor 2014 numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 147,739, një rritje vjetore prej 30.5 përqind. Rrjedhimisht, edhe numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 680,315 deri në qershor 2014 (443,053 në qershor 2013). Vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking deri në qershor 2014 arriti në 1.7 miliardë euro (1.1 miliardë në qershor 2013)

Struktura e llogarive E-bankare vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 97.2 përqind në qershor 2014. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë rreth 80.3 përqind të gjithsej llogarive të rezidentëve dhe pjesa e mbetur nga 19.7 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale (92.1 përqind në qershor 2014), përderisa llogaria afariste ka një pjesëmarrje prej 7.9 përqind.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme shënoi rritje vjetore prej 6.9 në qershor 2014. Numri i kartelave me funksion debiti në qershor 2014 arriti në 633,635, kurse me funksion krediti në

³⁹ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në dhjetor 2012 popullsia e përgjithshme rezidente ishte 1,815,606.

⁴⁰ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

117,243. Përkundër shkallës më të ulët të përdorimit, numri i kartelave të kreditit u karakterizua me rritje më të shpejtë (18.0 përqind) krahasuar me kartelat e debitit (5.1 përqind). Pjesëmarrjen më të lartë si në kartelat e kreditit dhe debitit deri në qershor 2014 e kishin kartelat Visa (89.6 përqind përkatësisht 73.2 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (10.4 përqind përkatësisht 26.8 përqind)

Infrastruktura bankare në vend sa i përket rrjetit të bankomatëve (angl. Automatied Teller Machine: ATM) ka shënuar rënie, ndërsa sa i përket pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) ka shënuar rritje. Numri i pajisjeve ATM dhe POS (që mundësojnë pagesat në pika të shitjes) shënuan rënie vjetore prej 1.2 përqind përkatësisht rritje prej 1.7 përqind deri në qershor 2014. Numri i ATM-ve të instaluara nga bankat komerciale në qershor 2014 ishte 487 përderisa numri i POS arriti në 9191 (tabela 12). Deri në qershor 2014, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 4.7 milionë, me një qarkullim prej 450.1 milionë euro (411.4 milionë deri në qershor 2013). Numri pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS deri në qershor 2014 arrit në 2.2 milionë me vlerë prej 103.6 milionë euro. Përdorimi i parasë së gatshme vazhdon të mbetet në nivel të lartë në vend.

Tabela 12. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014
Numri i ATM-ve	441	472	493	487
Numri i POS-ve	6,654	7,713	9,039	9,191
Numri i llogarive 'e-banking'	58,675	100,519	113,171	147,739

Burimi: BQK (2014)

Vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arriti në 79.7 përqind deri në qershor 2014. Ndërsa, vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arrit në 18.3 përqind deri në qershor 2014.

7. Sektori Pensional

Sektori pensional i Kosovës vazhdon të përbëhet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Pjesa më e madhe e kursimeve pensionale në Kosovë administrohen nga FKPK, i cili menaxhon me 99.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit të pensioneve, ndërsa FSKP administron një pjesë më të vogël të kursimeve pensionale të cilat janë pensione vullnetare.

Tabela 13. Struktura e fondeve pensionale sipas pronësisë

Përshkrimi	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014
Kosovë	99.1%	99.3%	99.4%	99.4%
Slloveni-Kosovë	0.9%	0.7%	0.6%	0.6%


Burimi: BQK (2014)

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së aseteve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës. Vlera e aseteve të sektorit pensional, deri në qershor 2014, arriti në 1.0 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 24 përqind. Vlera e aseteve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) u karakterizua me rritje vjetore prej 24 përqind, ndërsa asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP) shënuan rritje vjetore prej 10.5 përqind.

Sa i përket FKPK-së, struktura e aseteve deri në qershor 2014, u dominua nga investimet në tregun e jashtëm me një pjesëmarrje prej 75.4 përqind (figura 100). Pjesa e mbetur përbëhet nga investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës (6.4 përqind) dhe nga depozitat në BQK (18.2 përqind). Vlen të theksohet që gjatë viteve të fundit vërehet një tendencë rënëse e investimeve jashtë vendit dhe rritje e investimeve të FKPK-së në Kosovë. Në kuadër të investimeve të FKPK-së në tregun e jashtëm, investimet në aksione kryesojnë me 47.9 përqind, të pasuara nga bonot e ndërlidhura me inflacionin (16.9 përqind), bono të qeverive të huaja (13.1 përqind), multi-asete (5.3 përqind), tregu e kredive (3.2 përqind), dhe investimet në fondet investuese (22.3 përqind).

Investimet jashtë vendit dominojnë edhe strukturën e aseteve të FSKP-së. Deri në qershor 2014, jashtë vendit janë investuar gjithsej 73.1 përqind të aseteve të FSKP-së, ndërsa pjesa e mbetur prej 26.9 përqind paraqet investimet në Kosovë, nga të cilat 20.3 përqind të aseteve janë depozita në banka (figura 100). Në asetet e FSKP-së, vërehet tendencë e rritjes së investimeve jashtë vendit.

Figura 100. Struktura e investimeve të fondeve pensionale, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

7.1. Performanca e Sektorit Pensional


Sektorit pensional gjatë gjashtëmujorit të parë 2014 u karakterizua me performancë pozitive financiare. Të dy fondet shënuan ngritje të çmimit të aksionit dhe kthim pozitiv nga investimet (figura 101 dhe 102). Vlera e çmimit të aksionit⁴¹ të FKPK-së, në qershor 2014, arriti në 1.25 euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.5 përqind. Vlen të theksohet se çmimi i aksionit të FKPK-së ka arritur vlerën më të lartë ndonjëherë, duke u rikuperuar nga rënia e konsiderueshme si pasojë e krizës globale financiare. Gjithashtu, në qershor 2014, edhe vlera e çmimit të aksionit të FSKP-së ka vazhduar me trendin rritës, duke arritur në 143.89 euro, që përkthehet në rritje vjetore prej 8.2 përqind. Performanca pozitive e investimeve reflekton përmirësimin e kushteve në tregjet ndërkombëtare të aksioneve, ku edhe janë investuar pjesa më e madhe e mjeteve të sektorit pensional të Kosovës.

Figura 101. Mjetet nën menaxhimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK (2014)

Figura 102. Mjetet nën menaxhimin e Fondit Sloveno-Kosovar të Pensioneve




Burimi: BQK (2014)

⁴¹ Vlera bazë e çmimit të aksionit për FKPK-në është =1, ndërsa për FSKP-në është =100.

8. Sektori i Sigurimeve

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit 'jo-jetë' i cili përfaqëson 90 përqind të gjithë asetëve të sektorit, ndërsa pjesa e mbetur prej 10 përqind e asetëve përfshinë shërbimet e sigurimit 'jetë'. Nga gjithësej 13 kompani të sigurimeve që operojnë në Kosovë, 10 kompani ofrojnë produkte të sigurimit 'jo-jetë', ndërsa 3 kompani ofrojnë produkte të sigurimit 'jetë'. Sektori i sigurimeve në Kosovë vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, të cilat në qershor 2014 menaxhuan 66.4 përqind të gjithë asetëve dhe 70.6 përqind të gjithë kapitalit të sektorit.

Figura 103. Struktura e asetëve të kompanive të sigurimit



Pjesa më e madhe e asetëve në sektorin e sigurimeve zotërohet nga kompanitë me prejardhje nga Austria dhe Shqipëria, që përfaqësohen me pesë kompani dhe përbëjnë 37.7 përqind të gjithë asetëve të kësaj industrie. Ndërsa, 33.6 përqind e asetëve është me pronësi vendore dhe përfaqësohet nga katër kompani (figura 103).

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve është dukshëm më e ulët se ajo në sektorin bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e kompanive të sigurimeve tregon 901.0 pikë në qershor 2014, që mund të konsiderohet si shkallë jo e lartë e koncentrimit. Shkalla e koncentrimit në asete është më e ulët në krahasim me primet, ku në qershor 2014 Indeksi Herfindahl-Hirschman për primet ishte 1088.8 pikë. Diferencë e ngjashme vërehet edhe nëse krahasohet pjesëmarrja e tri kompanive më të mëdha në gjithësej asetet dhe primet e sektorit, ku në qershor 2014 pjesëmarrja në gjithësej asetet ishte 35.2 përqind, ndërsa në gjithësej primet ishte 41.5 përqind.

Tabela 14. Depërtimi dhe densiteti i sektorit të sigurimeve të vendeve të rajonit⁴²

Përshkrimi	Primet/Numri i Popullsisë	
	Dhjetor 2013	Prime/PBB Dhjetor 2013
Maqedoni	56.6 euro	2.0%
Shqipëri	-	0.6%
Mali i Zi	56.8 euro	2.2%
Serbi	78.0 euro	1.8%
Kosovë	43.6 euro	1.5%
Kroaci (2012)	280 euro	2.7%
Sloveni (2012)	983 euro	5.7%

Burimi: Statistikat zyrtare të vendeve përkatëse (2014)

Përkundër rritjes së vazhdueshme, sektori i sigurimeve mund të konsiderohet të jetë ende në një fazë të hershme të zhvillimit duke marrë parasysh peshën e vogël që ka në kuadër të gjithësej sistemit financiar si dhe shkallën e ulët të depërtimit në treg dhe të dendësisë. Depërtimi i sigurimeve, i cili llogaritet si raport i përqindjes së *bruto* primeve të pranuar ndaj PBB-së dhe matë zhvillimin e tregut të sigurimeve, tregon përfaqësim të ulët prej 1.5 përqind në dhjetor 2013

⁴² Me qëllim që të bëhet një krahasim më i saktë i depërtimit dhe densitetit të sigurimeve të Kosovës me vendet e rajonit, jemi bazuar me të dhënat më të reja të fundviti të vendeve përkatëse.

(tabela 14). Densiteti i sigurimeve, i cili llogaritet si raport i bruto primeve të pranuar ndaj popullsisë ishte 43.6 euro për kokë banori. Në krahasim me vendet e rajonit, Kosova ka raportin më të ulët prime/popullsi, ndërsa Sllovenia ka nivelin më të lartë të këtij indikator. Kurse, sa i përket raportit prime/GDP, niveli më i ulët është regjistruar në Shqipëri dhe Kosovë, ndërsa niveli më i lartë në Slloveni.


8.1. Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve

Deri në qershor 2014, vlera e aseteve të sektorit të sigurimeve arriti në 135.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.2 përqind, rritje kjo më e ngadalshme se sa rritja vjetore prej 8.3 përqind në qershor 2013. Në kuadër të gjithsej aseteve, rritje më të theksuar kishin depozitat e mbajtura në banka, pasuar nga paraja e gatshme dhe asetet tjera financiare. Kurse, parapagimet dhe të hyrat tjera akruale, aksionet e letrat me vlerë dhe asetet teknike shënuan rënie. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 57.6 përqind të gjithsej aseteve (figura 104). Pjesa tjetër përfaqësohet nga asetet fikse, paraja e gatshme, asetet teknike, etj.

Në kuadër të detyrimeve, rezervat teknike kryesojnë me 55.8 përqind, ndërsa në pjesën e mbetur hyjnë detyrimet tjera dhe kreditë (figura 105). Kapitali vetanak në qershor 2014 shënoi rritje vjetore prej 8.0 përqind, duke arritur vlerën prej 48.0 milionë euro. Në rritjen e kapitalit vetanak, kontributin më të lartë e kishin rezervat e përgjithshme dhe speciale, pasuar nga kapitali aksionar dhe fitimi i realizuar deri në qershor 2014. Në anën tjetër, niveli i kapitalit të kompanive të sigurimit u ndikua negativisht nga tërheqja e një pjese të profitit të mbajtur gjatë viteve të kaluara.


Deri në qershor 2014, vlera e bruto primeve të shkruara, e cila paraqet madhësinë e tregut të sigurimeve arriti në 40.3 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 0.5 përqind (tabela 15). Në kuadër të tyre, vlera e bruto primeve të shkruara të sigurimit 'jo-jetë' arriti në 39.0 milionë euro dhe shënoi rënie vjetore prej 1.5 përqind. Primet e pranuar nga sigurimi i 'përgjegjësishë ndaj palës së tretë' arritën vlerën prej 22.1 milionë euro deri në qershor 2014, që paraqet një rënie vjetore prej 10.3 përqind. Kjo rënie erdhi si rezultat i rënies së numrit të policave të shitura në 168.6 mijë krahasuar me 172.0 mijë deri në qershor 2013. Kurse, primet e pranuar nga 'polisat kufitare' dhe 'jo-përgjegjësitetë ndaj palës së tretë' shënuan rritje vjetore prej 16.8 përkatësisht 15.3 përqind deri në qershor 2014. Vlera e primeve të shkruara në kuadër të sigurimit 'jetë' shënoi një rritje vjetore prej 38.7 përqind, duke arritur vlerën prej 1.3 milionë euro në qershor 2014.

Figura 104. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit, qershor 2014



Burimi: BQK (2014)

Figura 105. Detyrimet dhe ekuiteti i kompanive të sigurimit, qershor 2014



Burimi: BQK (2014)

Tabela 15. Bruto primet e arkëtuara, në milionë euro

Përshkrimi	Qershor 2013	Qershor 2014
Prime bruto 'jo jetë'	39.6	39.0
Prime bruto 'jetë'	0.9	1.3

Burimi: BQK (2014)

Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) deri në qershor 2014 arriti në 17.1 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 19.3 përqind, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të dëmeve të paguara ndaj sigurimit 'jo jetë' (tabela 15). Në kuadër të sigurimit 'jo jetë', rënia u shkaktua kryesisht nga zvogëlimi i dëmeve të paguara për 'përgjegjësitë ndaj palës së tretë' të cilat shënuan vlerën 9.7 milionë euro që paraqet një rënie vjetore prej 8.9 përqind. Kjo rënie u shkaktua kryesisht nga zvogëlimi i numrit të policave të shitura gjatë kësaj periudhe. Dëmet e paguara nga sigurimi 'jetë' deri në qershor 2014 arritën në 0.1 milionë euro, kurse dëmet e paguara nga BKS-ja, deri në qershor 2014 shënuan vlerën 1.9 milionë euro (2.5 milionë euro në qershor 2013).

Tabela 16. Dëmet e paguara, në milionë euro

Përshkrimi	Qershor 2013	Qershor 2014
Dëmet 'jo jete'	18.6	15.1
Dëmet 'jete'	0.1	0.1
Dëmet BKS	2.5	1.9

Burimi: BQK (2014)

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara tregon përmirësim të performancës së sektorit krahasuar me vitin paraprak. Ky raport në qershor 2014 u zvogëlua në 42.4 përqind krahasuar me 52.3 përqind në qershor 2013, si rezultat i zvogëlimit të dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit (figura 106).


8.2. Performanca e Sektorit të Sigurimeve

Sektori i sigurimeve në qershor 2014

shënoi përmirësim në indikatorët kyç të performancës dhe stabilitetit. Deri në qershor 2014, sektori i sigurimeve regjistroi fitim neto prej 113.2 mijë euro, që tregon për përmirësim krahasuar me humbjet prej 1.4 milionë euro të shënuara deri në qershor të vitit 2013. Sigurimi 'jo-jetë' vazhdon të karakterizohet me humbje për dallim nga sigurimi 'jetë' i cili vazhdon të operojë me fitim. Humbjet e sigurimit 'jo-jetë' u zvogëluan për 82.1 përqind, kurse sigurimi 'jetë' shënoi rritje të profitit për 32.7 përqind deri në qershor 2014 krahasuar me qershor 2013. Përmirësimi i pozicionit financiar ishte kryesisht rezultat i menaxhimit më të mirë të shpenzimeve.

Kthimi Mesatar në Asete (*angl. Return of Average Assets: ROAA*) në qershor 2014 ishte 0.2 përqind krahasuar me -0.3 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Ndërsa, Kthimi Mesatar në Kapital

Figure 106. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

(*angl. Return on Average Equity: ROAE*) u përmirësua në 0.5 përqind nga -0.7 përqind sa ishte në dhjetor 2013.


Sektori i sigurimeve mbetet mirë i kapitalizuar, me normë prej 35.4 përqind, që do të thotë se tregu është në gjendje të mirë për t'u ballafaquar me tronditjet e mundshme. Kapaciteti i sektorit për përballimin e humbjeve të mundshme matet edhe përmes raportit të kapitalit vetanak ndaj rezervave teknike, i cili në qershor 2014 arriti në 63.5 përqind nga 62.5 përqind sa ishte në qershor 2013. Po ashtu, kompanitë e sigurimeve gjatë kësaj periudhe përmirësuan nivelin e likuiditetit. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në raport me rezervat teknike qëndroi në 119.1 përqind në qershor 2014 (114.1 përqind në qershor 2013), kurse në raport me gjithsej detyrimet qëndroi në 102.8 përqind (94.8 përqind në qershor 2013).

9. Sektori i Institucioneve Mikrofinanciare dhe Ndhmësve Financiar

Struktura e sektorit të institucioneve mikrofinanciare vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 92.1 përqind të gjithsej aseteve të sektorit.

Shkalla e koncentrimit të tregut, me gjithë se është rritur, mbetet më e ulët se ajo e sektorit bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) për asetet e institucioneve mikrofinanciare ka arritur në 1,155 pikë nga 1,136 pikë sa ishte në qershor 2013. Asetet e tri IMF-ve më të mëdha deri në qershor 2014 rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej asetet e sektorit në 46.4 përqind nga 45.1 përqind në qershor të vitit paraprak (figura 107). Vlen të theksohet se shkalla e koncentrimit të tregut në kredi është më e lartë se ajo në asete.

Figura 107. HHI për asetet dhe kreditë e IMF-ve



Burimi: BQK (2014)


9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2014, sektori mikrofinanciar ka shënuar rritje të aktivitetit, duke ndërprerë kështu trendin e tkurrjes së aktivitetit të ndjekur gjatë viteve të fundit. Vlera e aseteve të sektorit mikrofinanciar deri në qershor 2014 ishte 113.1 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 0.2 përqind (-6.1 përqind në qershor 2013) (figura 108).

Kreditë, si kategoria kryesore në kuadër të gjithsej aseteve të IMF-ve (pjesëmarrje prej 67.0%), janë karakterizuar me rritje vjetore prej 2.0 përqind. Në kuadër të gjithsej kredive, ato të destinuar për biznese shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare, të cilat dominojnë strukturën e kredive të IMF-ve, u karakterizuan me rritje vjetore prej 1.2 përqind. Rrjedhimisht, rritja e kredidhënies për bizneset paraqet kontribuuesin kryesor në zgjerimin e aktivitetit kreditues të institucioneve mikrofinanciare (figura 109).


Struktura e kredive, sipas sektorëve ekonomik, mbetet e ngjashme me vitin paraprak. Kreditë për shërbime kryesojnë strukturën e kredive sipas sektorëve ekonomik me

Figura 108. Asetet e institucioneve mikrofinanciare, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 109. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve



Burimi: BQK (2014)

pjesëmarrje prej 45.9 përqind. Për dallim nga sektori bankar, ku bujqësia paraqet sektorin me qasjen më të ulët në kreditim, sektori i institucioneve financiare vërehet të ketë bujqësinë njërin ndër sektorët më të favorizuar për kreditim. Në qershor 2014, kreditë e lëshuara për sektorin e bujqësisë kishin pjesëmarrje prej 27.8 përqind në gjithsej kreditë e lëshuara për sektorët ekonomik. Pjesa tjetër e kredive është destinuar për ndërtimtari dhe industri e energjetikë (figura 110).

Sipas maturitetit, struktura e kredive mbetet e ngjashme me vitin paraprak, duke u dominuar kryesisht nga kreditë afatmesme me afat maturimi ‘prej 1 deri 5 vite’ të cilat përfaqësojnë 83.2 përqind të gjithsej kredive. Kreditë afatshkurta ‘deri në 1 vit’ përbëjnë 16.4 përqind të kredive, dhe pjesa e mbetur përfaqësohet nga kreditë afatgjata (figura 111).

Pjesëmarrja relativisht e ulët e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e IMF-ve tregon se cilësia e kredive të këtij sektori vazhdon të mbetet e mirë. Në qershor 2014, raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive ishte 5.9 përqind (5.3 përqind në qershor 2013), që paraqet nivel më të ulët se sa në sektorin bankar. Poashtu, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizione për humbje nga kreditë me një normë të mbulueshmërisë prej 106.9 përqind në qershor 2014. Megjithatë, vërehet një rënie normës së mbulueshmërisë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (115.2 përqind në qershor 2013). Pritjet për përmirësim të portofolit kreditor si rezultati zgjerimit të aktivitetit kreditues që është shënuar deri në qershor 2014, mund të kenë ndikuar në rënie të mbulueshmërisë. Gjithashtu, rënia e të hyrave, deri në qershor 2014, mund të ketë zvogëluar potencialin e institucioneve mikrofinanciare për të ndarë provizione për humbje nga kreditë.

Lizingu përfaqëson kategorinë e dytë më të rëndësishme të aseteve të IMF-ve me pjesëmarrje prej 19.9 përqind në gjithsej asetet. Deri në qershor 2014, lizingu arriti vlerën 22.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.3 përqind. Vlen të ceket që ky aktivitet ushtrohet vetëm nga dy institucione të cilat janë licencuar në fund

Figura 110. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Figura 111. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, qershor 2014, në përqindje





Figura 112. Struktura e lizingut të IMF-ve sipas sektorëve, në përqindje




të vitit 2008; rrjedhimisht, pjesëmarrja e lartë në gjithsej asetet e sektorit tregon për zhvillimin e shpejtë të shërbimeve të lizingut në këto dy institucione. Struktura e lizingut dominohet nga lizingu i destinuar për ndërmarrje, i cili përbën 67.9 përqind të gjithsej aktivitetit. Lizingu për ndërmarrje shënoi rënie vjetore prej 6.9 përqind, duke u bërë kështu kontribuues kryesor në ngadalësimin e rritjes së këtij aktiviteti. Në anën tjetër, që nga viti paraprak, vërehet rritje e peshës së lizingut të destinuar për ekonomitë familjare, i cili deri në qershor 2014 shënoi rritje vjetore prej 39.9 përqind (figura 112).

Meqenëse IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të financohen nga depozitat e klientëve, pjesa kryesore e detyrimeve të këtyre institucioneve përbëhet nga linjat kreditore të jashtme. Prandaj, ekspozimi i sektorit mikrofinanciar në kuadër të detyrimeve është më i lartë në krahasim me ekspozimin në kuadër të aseteve. Deri në qershor 2014, raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të IMF-ve arriti në 54.9 përqind (54.8 përqind në qershor 2013).

Normat mesatare të interesit për kreditë e IMF-ve vazhdojnë të jenë dukshëm më të larta krahasuar me normat e aplikuara nga sektori bankar. Norma mesatare e interesit në kreditë e IMF-ve, në qershor 2014, ishte 25.2 përqind (24.8 përqind në qershor 2013) (figura 113). Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare arriti në 25.3 përqind nga 25.6 përqind sa ishte në qershor 2013. Ndërsa, norma e interesit në kredi për korporatat jo financiare u rrit në 24.6 përqind nga 20.8 sa ishte në qershor 2013. Sipas veprimtarive ekonomike, norma e interesit për bujqësi u zvogëluar në 25.6 përqind në qershor 2014. Për dallim, sektorët e industrisë dhe shërbimeve kanë shënuar rritje të normave të interesit të cilat në qershor 2014 ishin 22.4 përqind, përkatësisht 26.1 përqind.

Figura 113. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve



Burimi: BQK (2014)

9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar

Sektori i institucioneve mikrofinanciare, deri në qershor 2014, realizoi profit prej 13.6 mijë euro, që paraqet një përmirësim të pozicionit financiar krahasuar me humbjen prej 572.5 mijë euro të shënuar deri në qershor 2013. Gjenerimi i profitit ishte kryesisht rezultat i rënies më të theksuar të shpenzimeve krahas rënies së të hyrave.

Të hyrat e sektorit, deri në qershor të vitit 2014, arritën vlerën në 9.3 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 4.8 përqind. Struktura e të hyrave dominohet nga të hyrat e interesit me pjesëmarrje prej 82.2 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rënie prej 10.2 përqind, në kuadër të cilave kontribuues kryesor ishin shpenzimet operative (rënie prej 34.7 përqind) dhe shpenzimet nga jo interesi që u zvogëluar për 5.1 përqind. Treguesi i përgjithshëm i efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, është përmirësuar në 99.9 përqind nga 105.8 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Përmirësimi i performancës financiare u pasqyrua edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit. Deri në qershor 2014⁴³, kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) arriti në 0.02 përqind nga -0.3 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Gjithashtu, kthimi

⁴³ Profiti për llogaritjen e ROAA dhe ROAE për qershor 2014 është përvitësuar.

mesatar në kapital (ang. Return on Average Equity: ROAE) arriti në 0.1 përqind nga -1.1 përqind sa ishte në dhjetor 2013.

Treguesit e kapacitetit të sektorit, të paraqitur në tabelën 17, sugjerojnë përdorim shfrytëzim më të lartë të kapacitetit deri në qershor 2014. Numri i të punësuarve në sektorin mikrofinanciar, në qershor 2014, zbriti në 799 nga 803 në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Raporti i aseteve ndaj numrit të punëtorëve paraqet rritje krahasuar me vitin paraprak. Rritja e aseteve, si dhe zvogëlimi i numrit të punëtorëve deri në qershor 2014, ka ndikuar që vlera e aseteve të menaxhuara nga një punëtor të jetë më e lartë krahasuar me periudhat e kaluara. Gjithashtu, si rezultat i profitit të realizuar gjatë kësaj periudhe dhe zvogëlimit të numrit të punëtorëve, raporti i profitit të gjeneruar për punëtor ka shënuar rritje. Në anën tjetër, raporti i kredive për numër të punëtorëve është zvogëluar, duke lënë të kuptojmë se numri i kredive të menaxhuara nga një punëtor është më i vogël. Për më tepër, edhe raporti i shpenzimeve të personelit ndaj numrit të punëtorëve ka shënuar rënie, duke bërë që kostoja mesatare për punëtorë të jetë më e ulët.

Tabela 17. Tregues shtesë të efikasitetit të sektorit

Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014
Asetet/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	131.0	140.7	141.6
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	-2.9	-0.7	0.02
Numri i kredive/nr. i punëtorve	44.3	48.8	45.5
Shpenzimet e personelit/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	6.4	7.0	6.6

Burimi: BQK (2014)

9.3 Ndhmësit Financiar

Struktura e ndihmësve financiar përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Ndhmësit financiar përbëjnë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhojnë pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.2 përqind deri në qershor 2014). Vlera e aseteve të ndihmësve financiar deri në qershor 2014 ishte 8.9 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 7.3 përqind.

Deri në qershor 2014, të hyrat e ndihmësve financiar arritën vlerën 3.2 milionë euro, duke paraqitur rritje prej 17.4 përqind krahasuar me në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga kategoria e të hyrave nga transferet, me pjesëmarrje prej 73.8 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 1.6 milion euro, duke paraqitur rritje vjetore prej 45.4 përqind. Rrjedhimisht, të hyrat neto të ndihmësve financiar shënuan vlerën 1.6 milionë euro, e cila është e ngjashme me vitin paraprak.

10. Shtojca Statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Qershor 2011	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	17.2	17.2	15.0	17.4
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.4	14.4	12.2	13.5
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	5.7	5.2	7.3	5.9
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	5.9	6.5	7.8	8.2
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.4	1.0	1.0	1.1
	Korporatat publike jofinanciare	0.02	0.08	0.02	0.01
	Korporatat tjera jofinanciare	69.9	68.1	67.0	66.4
	Ekonomitë familjare	29.7	30.7	30.8	31.5
	OJSHEF	0.03	0.05	0.04	0.04
	Jo-rezidente	0.0	0.0	1.1	1.0
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (ROA)*	1.7	0.8	1.0	2.0
	Kthimi në kapital (ROE)*	17.4	8.6	10.6	21.1
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	75.9	75.4	74.0	74.5
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	79.9	86.6	82.0	68.8
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	24.3	22.6	21.9	23.0
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	29.8	28.9	29.3	32.4
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	31.1	28.3	27.9	29.2
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	38.1	36.2	37.3	41.2
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	1.3	-2.4	0.3	2.4
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj asetëve	10.2	10.3	10.5	10.1
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	82.7	80.9	79.0	89.6
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointeresi	39.8	38.4	39.2	38.5
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	10.6	9.9	8.5	10.0
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	114.2	112.2	116.3	124.4
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	5.2	4.6	4.6	4.7

*Anualizuar për Qershor 2014, janë konsideruar të hyrat neto para taksës.
Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)

Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, qershor 2014, në milionë euro

Procredit Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	102.61	Bilanci nga bankat tjera	0.60
Bilanci me bankat komerciale	40.77	Depozitat	638.90
Letrat me vlerë	177.0	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	454.16	Detyrimet tjera	58.67
Asetet fikse	16.84	Borxhi i ndërvarur	24.55
Asetet tjera	10.37	Mjetet vetanake	78.99
GJITHSEJ ASETET	801.7	GJITHSEJ DETYRIMET	801.7

Burimi: BQK (2014)

Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	72.6	Bilanci nga bankat tjera	2.2
Bilanci me bankat komerciale	66.8	Depozitat	577.3
Letrat me vlerë	99.6	Huamarrjet tjera	1.8
Kreditë	504.5	Detyrimet tjera	71.1
Asetet fikse	6.6	Borxhi i ndërvarur	19.0
Asetet tjera	6.4	Mjetet vetanake	85.1
GJITHSEJ ASETET	756.5	GJITHSEJ DETYRIMET	756.5

Burimi: BQK (2014)

Banka për Biznes

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	18.0	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	5.8	Depozitat	96.5
Letrat me vlerë	7.7	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	79.0	Detyrimet tjera	7.3
Asetet fikse	1.0	Borxhi i ndërvarur	1.8
Asetet tjera	2.4	Mjetet vetanake	8.2
GJITHSEJ ASETET	113.8	GJITHSEJ DETYRIMET	113.8

Burimi: BQK (2014)

Banka Ekonomike

(Në milionë euro)

